

**NASE JANI**

BIBLIOTEKA


85H-31

g 25

**ÇMENDINA**

**ÇWEKË**

**ROMAN**



8 SH-31  
725

NASE JANI

*ÇMENDINA*

roman

7327

**D**

Botimet Dritëro

Ia kushtoj poetit  
**LASGUSH PORADECI**  
që e dua gjer tek fjala .....

Autori

\*\*\*\*\*

**FALENDEROJ MIQTE E MI:**

*Alush Kurti  
Vasil Xhaferri  
e Odisea Meçi,  
që mundësuan financiarisht  
botimin e këtij libri.*

**O njerëz,ka akoma NJEREZ !**

Autori 📖

\*\*\*\*\*

## ***Një roman për nerva të forta***

***“Jetojmë në një botë të çmendur, të çmendur!” është titulli i një filmi të Hollivudit, që bëri shumë bujë në vitet '60-të. Shprehjen “u prish dynjaja!”, e kemi dëgjuar nga gjyshet tona me mijëra herë e po aq e kemi thenë vetë. Në të vërtetë konstatimi ynë është një formulë ndjese, së pari ndaj vetes, pse prishja e “dynjasë”, marrëzia dhe çmendja, e kanë shoqëruar botën tonë qysh në lindjen e saj, e ne thjeshtë, jemi pajtuar me të si në një doli të detyruar të dasmave labe.***

***Në këtë botë të çmendur, ashtu si në sistemin e vlerësimit të hoteleve, çdo çmendinë ka edhe numërin e vetë të yjeve që shprehin kategorinë . “Çmendina ” e Nase Janit është pa tjetër me 5 yje. Nuk i mungon asgjë!***

***Absurdi dhe arsyeja, realja dhe magjikja, janë të ndërthurrura aq mjeshtërisht ,në ngrehinën që na ofron Nase Jani e, që si çdo çmendinë, ka mbi krye një Xherah! Lexuesi shqiptar do ta krijojë për një herë aludimin, por Xherahu i Çmendinës personifikon diçka shumë më të rëndësishme: pamundësinë e njeriut për ta sjellë në binarë botën ku jeton . Kështu, në vend që të recitojë orë e çast vargjet shekspirjane: “...O botë e çmendur, o marrëzi, o dreq! Unë paskam lindur të të ndreq!” ,robi bën mirë që të ndreqë së pari vetë-veten . Hotelieri, bie fjala, është një nga këta njerëz, po ndërkaq i dështuar në përpjekjen e vetë për të ndrequr të tjerët aq sa shtratin e tij të vërtetë të prehjes ka varrin; një lloj bote normale brenda zallahisë mbytëse të Çmendinës . Eshtë e njëjta gjendje që përjetonte orë e çast Lasgushi i Madh ,të cilin na e sjell ndër mend Hotelieri; është njeriu që në 24 orët e ditës, përjeton sistematikisht: lindjen, jetën, vdekjen e vetë, me një rregullsi matematike . Eshtë në kohën tonë dhe njëkohësisht në vitet që shkuan e ata që do të vijjnë, (“poeti vdes në lotin e fluturës” ...thotë në një poezi të vetën Nase jani); tek e fundit është ai sahati me rërë i Çmendinës, ku rëra s'mbaron***

asnjëherë,po këshu dhe përçartja: e egra,e brishta,e bukura,e shëmtuara,epshorja,sterilja,përçartje e kësaj Çmendine imagjinare e po aq konkrete.

Që nga rreshti i parë i romanit e gjer në fund kam patur vazhdimisht përshtypjen se po lexoja romanin " Murtaja " të Alber Kamysë . Në të vërtetë,të dy romanet s'kanë asgjë të ngjashme mes tyre dhe unë s'kam aspak ndër mend t'i vesh Nase Janit petkun e Kamysë shqiptar,por e përbashkëta,ajo që më " instaloi " në trurin e në trupin tim " Murtajën",ishte situata e agonisë së pa ndërprerë,një vërshim i përkohshëm djerse,një zjarrmi gripale ;ishte një situatë e ngjashme me një endërr të makthshme,ku pasi zgjohesh,vështron për disa çaste për rreth me hutim e pastaj flet i çliruar : " Zot shyqyr,isha në endërr ! "...

Eshtë e natyrshme që jeta brenda Çmendinës të mos i bejë gjithkujt përshtypje dhe,ndofta,Nase Jani mos ta kishte shkrojtur këtë roman po të jetonte brenda saj . Mirpo,ashtu siç është e nevojshme për verifikimin e një dashurie ndarja e përkohëshme,edhe për shkrimtarin është e nevojshme ndarja nga " gurra " e tij. Nase Jani sot ndodhet i mërguar,në një Çmendinë tjetër. Dhe një nga ngushëllimet e pakta(në mos i vetmi) është nëpërmëndja e Çmendinës së tij. Ashtu si pleqtë,që te kujtimet e rinisë shohin një vegëz për të varur lavjerësin e tyre të ngadalsuar.

Libri që mbani në dorë kërkon nerva të forta për ta lexuar e stomak edhe më të fortë për ta honepsur . Autori nuk e ndjen të nevojshme t'i hyjë procedurës së limimit e finaturës,ndryshe në Çmendinë vetëm hekurat e dritareve janë të limuara nga prekja e duarve të paarsyeshme e të plotfuqishme...

Mendoj se s'më mbetet tjetër. veçse,si plaka Nicë te "Gjenerali..." i Kadaresë,t'ju "flak" këtë libër e t'ju them:"Merrni Çmendinën tuaj!" e t'u le rradhë kritikëve dhe kritizerëve,që sidomos në emigracion nuk mungojnë .

**Robert Goro, Athinë, janar 2000**

*“...Në vendin tim e në vendin tënd,  
një kokë e çmendur një vend e çmend...”*

**Dritëro Agolli**



*Çmendina ngrihej, në një vend të bukur, mes malesh e përballë detit. Dielli e shihte qysh kur lindëte e deri sa perëndonte dhe deti i afrohej e i largohej, duke i matur temperaturën, në çdo çast të vitit. Nuk i dihej saktë, as thellësia, as gjerësia, as lartësia. Gjithmonë diç fshihte, brenda vetes, bile edhe moshën edhe emërin. Por ka berë jetë, këtu, mes malesh e përballë detit, qysh kur është krijuar bota...*

*Nëpër shekuj i ka ndryshuar disa herë përmasat. Herë, zgjerohej me kështjella e oborre të gjelbër e herë ngushtohej e ngushtohej, duke zgjatur rrënjët në tokë e krahët në qiell. Dhe gjithmonë mbetej, mes malesh e përballë detit, për të bërë jetë deri në ditët e sotme...*

*Emërin e vërtetë nuk e ka patur Çmendinë. Është folur me emëra të bukur, që ngjasonin me malet, me qiellin e me detin, por herë-herë, shfaqej befasishëm, me këtë emër të çuditshëm e të frikshëm...*



## *Pjesa e parë*

Eshtë thënë se ,qysh kur u krijua bota,të parin e këtij vendi,e thirri në dashuri *Perëndesha e Dashurisë*.E priste netëve në pallatin e kaltër. Ai i trokiste në dritare me fishkëllima bilbili e ajo lëshonte gërshetat e gjatë...

Ai ngjitej pas gërshetave, në dhomën e saj, e flisnin fjalë dashurie e benin punë dashurie...Por një natë u diktua nga rojat e *Babait të Perëndive*,i cili e prangoi,këmbë e duar,pas një shkëmbi,për ta shqyer zhgabat e për ta helmuar gjarprinjtë...Netëve ndodhte çudia.Shkëmbi bëhej kalë dhe kalorësi i dashurisë,ngjitej e ngitej pas gërshetave,tek *Perëndeshae* zemrës së tij...Dhe thoshnin fjalë dashurie...Dhe bënin punë dashurie...Kur morri vesh Babai i Perëndive u bë si i çmendur." I çmenduri...i çmenduri..."- ulërinte duke shkukur mjekrën e bardhë,me duart që i dridheshin... Nuk ishte dëgjuar ndonjë herë ajo fjalë:"...*I çmenduri*."

Të gjithë e ngulën në tru,atë fjalë të tmerrshme,por askush nuk guxonte ta përdorte...Për herë të parë,atë fjalë,e kish ulëritur *Babai i Perëndive*...

*Thuhet*,se dikur,në këtë vend,mbretëronte një i çmendur, që e flisnin Xherahu.I çmendur deri në çmenduri...Por nuk pranonte të vizitohej e nuk mernte dietë mënçurie.Vetëm ulërinte,sa gjuha i trashej e dhembët i përtypte e i përtypte,duke i gëlltitur.

Xherahu bridhte me kalin e bardhë,që e kish grabitur një natë pranvere dhe ulërinte e ulërinte...

Kush i dëgjonte ulërimat e tij,ujkëzohej pak e nga pak e bridhte mbas kalit,duke i shoqëruar ulërimën...

Thuhet, se Xherahu kish zbuluar një ilaç të ri,që të zgjatëte jetën.Provën e parë e kish berë te kali i tij dhe kali e kish shtuar vrapin pa u djersitur.Edhe hingëllimën e kish berë më të fortë e më hingëlluese. Edhe gjumë nuk flinte më,as në këmbë siç flejnë gjithë raca e kuajve e as në ecje,siç kish ndodhur gjatë ekspeditave pafund të Xherahut.

Disa thonë se kali kish berë një kërcim, të befasishëm,gati fluturues,menjëherë,sa kish pirë ilaçin e çuditshëm,por Xherahu edhe pse qe shkëputur nga shala,kish mbetur mbi zverkun e kalit,i mbërthyer fort,pas jeleve të gjata e veshëve të shkurtër.Ky heroizëm u komentua gjatë,brenda e jashtë Çmendinës, nga të çmendur e të berë të çmendur.Disa flisinin e flisnin me ulërimë e disa tundnin kokat,duke gëlltitur heshtjen e tyre...

Ilaçi i ri u shpërnda falas,në çdo kryqudhe,ku u ngritën me mijëra kioska.Xherahu bridhte me kalë,nga një vend tek tjetri,ngjitej nëpër male e zbriste buzë detit,hynte nëpër porta e kapërcente gardhe kopshtesh,duke gdhendur damka patkonjsh e duke zgjatur ulërimën...

Ditët e para kishte shumë njerës para kioskave.Njerëzit shtyheshin e shaheshin,griseshin e gjakoseshin,në rradhët e gjata,për të rrëmbyer ilaçin e çuditshëm.Në këto shumëduelë fitimtarë dilnin të rinjtë e më të fuqishmit,që rrëmbenin nga 10-20pako,ndërsa pleqtë e gratë me fëmijë të vegjël,mbeteshin në pritje...

Shtësit e kioskave,kur panë këtë dyndje,nisën dhënien nën dorë.

Disa,që kishin mbaruar“*shkollën e ulërimës*”,bashkëpunuan me pronarët e kioskave dhe paketat me ilaçin e çuditshëm i shisnin shtrenjtë e më shtrenjtë.

Por shumica,edhe pse me zor e gjenin këtë ilaç,nuk guxonin ta përdornin.

Thuhej se e kishte përdorur një grup të rinjsh dhe qysh nga ajo



ditë,kishin humbur,pa nam e pa nishan.I kërkonin familjet,por nuk i gjenin kund.Lloj-lloj hamendjesh kishte për fatin e tyre.

Disa thoshnin se ,me të pirë ilaçin,kishin marrë udhët nëpër botë,të pangrenë e të pafjetur... Një bari dhish tregonte se në një luginë,mes malesh,kish parë një grup të rinjsh,katër djem e tre vajza,që luanin në një lojë të çuditshme,krejt të lakuriqtë,me shkopinj në duar.Qëllonin njëri-tjetrin me gurë e shkopinj duke lëshuar tinguj ulërime.

Pastaj qeshnin,me të qeshur të madhe sa edhe zogjtë e pemëve linin foletë të trembur...

Dikush thoshte se, në atë luginë mes malesh,netëve,bariu kish dëgjuar hingëllimën dhe trokun e një kali,që s'ishte tamam,as trok e as hingëllimë,pastaj kish ndjerë përsëri ato të qeshurat,në formë hingëllime,si të disa ditëve më parë...

Por e thëna më e përfolur,ishte për një plak shtatëdhjetë vjeçar,i ngjuar në një shtëpi pleqsh.Në vend të sheqerit,plaku i gJORë,ikish hedhur kafes nga pluhuri i bardhë,që e ruante në një vazo qelqi.

Sa e kish pirë kafënë,qe hedhur nga shtrati e nuk e mbante më dhoma.Kokën nuk e ndjente më mbi supe.I dukej sikur koka e tij e rëndë,i vinte vërdallë, nën tavan, e ai nuk mund ta zinte dot më...Por edhe pjesët e tjera të trupit nisën t'i lëviznin e t'i hidheshin,në një marrëzi të plotë...Kapërceu murin plaku e bëri e ç'nuk bëri,matanë,nëpër dhomat e plakave... Pas kësaj ngjarje,sheqerin e zëvendësoi pluhuri çudibërës.E gjithë azilja u kthye në një çmendinë të vërtetë.Pleqtë nuk donin më të hanin ushqim,vetëm hidheshin e përdridheshin,këndonin në kor e qanin në kor dhe bënin të pa bërat e të pa thënat ...

### Atë pasdite qershori...

Zbarkimi u bë gati i menjëhershëm. Jo vetëm nga vendet fqinje, por edhe andej nga nuk perëndon dielli. U ngritën avionët katërmotorësh, turigjatë e turishkurtër, lëkurëbardhë, lëkurëverdhe e lëkurëzinj, me nga dy sy të vegjël përpara, apo me nga një sy të vetëm, të dalë si sy ciklopi... Pa zhurmë u ul edhe një avion fare i pasy, me dy brirë si të kërmillit, që i lëshonte e i mblihte sa herë ndryshonte lartësinë.

Në atë zbarkim të menjëhershëm, që zgjati vetëm tre orë, pati edhe ndodhira. Dy avionë lëkurëzinj u përplasën midis tyre, se morrën të njëjtin kursulje, pa i hapur udhë njëri-tjetrit, në pistën e portit ajëror.

Grindja kish filluar qysh në ajër, kur lëshonin sinjale me të shara bashtingëlloresh, si thyerje kockash të vjetra.

Lëkurëziu turigjatë: ...krrr...grrr...kjo udhëqielli është imja, vetë Xherahu m'a ka dhenë, hap udhë!...

I pangjyri me sy ciklopi: ...hmmm...bmmm...Xherahu? Hmmm, faktotumm...teleftesën nga Xherahu e kam marrë vetë...Mos u ul para meje se të piu e zeza!...

Lëkurëziu turigjatë: ...grrr...krrr...lëre teleftesën...Unë e kam marrë para shpikjes së ilaçit...krr...grrr...zvogëlo shpejtësinë!...I pari do të zbres unë...mutatis, mutandis.

I pangjyri me sy ciklopi: Unëidi të gjitha...hmbm...Historinë e kalit, historinë e ilaçit dhe historinë e Xherahut... Unë...Unë...ad..absurdum...

Avioni i pasy, me dy brirë si të kërmillit, kontrollonte sinjalet e atyre që grindeshin dhe qeshte me grindjen e tyre, teksa bëhej gati të lëshonte parashutën e padukshme të uljes. Grindja ajrore, përfundoi në tokë me nga një krah të thyer që, për çudi, pas përplasjes, i dhanë dorën njëri-tjetrit e u

përqaftuan miqësisht. Më keq e pësoi avioni me antena kërmilli.Një zhurmues i fuqishëm,nisur s'dihet nga,i kish bllokuar aparatet e drejtimit dhe brirët e kërmillit nuk mund të shihnin më.Avioni ,i pa orientuar,u përplas me një tufë lopësh,që kullosnin,aty pranë pistës,dhe u dëmtua rëndë.

Atë pasdite qershori obori i Çmendenës u mbush me të zbriturit e huaj,që mbanin nëpër duar,nga një çantë. Kostumet e zinj mbanin nëpër duar çanta të zeza....

### *Çantat e zeza.*

Çantat e zeza,të ardhura nga përtejqsiejt,nuk u çelën atë mbremje.Gjithë të ardhurit ishin ngujuar tek hoteli,në periferi të Çmendenës dhe as për ushqim nuk kishin dalë nga dhomat e fjetjes...Gjithkush mund të mendonte se ,me të zbritur në tokë nga avionët e orgjinës,të ardhurit,nuk do e mbanin dot durimin e do të kursenin edhe minutat,duke sakrifikuar edhe gjumin,për të njoftuar rezultatet e punës së tyre...

Por, sa zbritën nga avionët dhe bënë regjistrimet e nevojshme zyrtare,sikur kureshtja e mospritja u kthye në indiferencë e moskokëçarje...

Xherahu kishte kohë që përgatitej për pritjen e miqve të nderuar.Ishte hera e parë që ai priste kaq shumë miq.Edhe herë të tjera kish dërguar ftesa,në gjithë anët e globit,por as fqinjët nuk kishin marrë mundimin ta vizitonin. Para disa vjetësh,organizoi edhe një konkurs bukurie e një festival këngësh,ku ftoi artistë e gjinifemra nga e gjithë bota.Befasia do të ishte pjesmarrja e vetë Xherahut dhe e Zonjës në ato veprimtari,ku të ardhurit do të shihnin e ç'do të shihnin e do të dëgjonin e ç'do të dëgjonin ! Me orë të tëra,në gjithë orët e ditës e me ditë të tëra,në gjithë ditët e muajit,Xherahu provonte

zërin, si këngë, pa ia zbritur kalit. Por zeri niste e mbaronte “..ooouuu “,-deri sa iu zu fyti ,si të kishte mish të huaj në grykë.

Edhe Zonja me Sy të Kuq ose Madama Hi-Fi, (që të dy emrat i pëlqente) mbeti vishu e zhvishu para pasqyrave, ndro fustanë e ç’përmbante fisi i fustanëve, leu e ngjeu me bojëra, deri sa dhe asaj i ndodhi gjëma. Sa herë dilte para pasqyrave (që edhe në gjumë nuk u shpëtonte dot) , shihte e tmerruar se fytyra po i mbushej me disa njolla të kuqe dhe flokët po i binin vatra-vatra. Zënia e fytit të Xherahut dhe prishja e bukurisë së Zonjës, beri që të vinte nga larg një ekip mjekësh, që për çudi ose aspak çudi, kryesohej nga një hoxhë i dëgjuar. Por hoxha me ç’i vinin nga prapa, si erdhën ashtu edhe ikën. As Xherahu e as Zonja, nuk i pranuan këshillat e tyre....

### *H o t e l i e r i*

*H*otelieri Plak ishte një jetë të tërë në atë hotel. I mençur e i pafjalë. Gjithë jetën kishte mbetur mbi libra. Lexonte në të gjitha gjuhët e librave të shkruara. Familje nuk kishte. Kish mbetur peng i një dashurie të hershme në një aeroport, përtej deteve. E priti dhe e priste dashurinë e tij t’i zbriste nga qiejt e të trokiste në hotelin e vjetër. Gjithmonë ishte në pritje me pritjen i vetmuar...

Qysh në ato vite ngriti këtë hotel, pranë aeroportit, duke pritur e përcjellë udhëtarët e qiellit. Tek çdo aeroplan, që ulej ai kishte diçka nga vetja e tij.” *Shpresa është e fundit që vdes*”i thoshte ai vetes.... Dhe priste e priste...

Zbarkimi i menjëhershëm i gjithë atyre aeroplanëve e habiti,por prapë përgatiti dhomat për të ardhurit e shumtë.Këta njerëz ishin më të pazakontët, që kish pritur në gjithë jetën hoteli i tij.Edhe në lëvizje e komunikim ata ishin ndryshe.Por çantat ,që mbanin në duar, ishin enigma më e madhe.

Nuk qe e vështirë për hotelierin që të zbulonte edhe atë enigmë.Si gërmues profesionist, nëpër faqe librash e shpirtra njerëzish,ai hynte lehtas në çdo të fshehtë .Edhe kur e fshehta, fshihej e nuk paraqitej si e tillë,ai e zbulonte çelësin e fshehjes së dyfishtë dhe e hapte kur të donte portën e së vërtetës. Kështu ndodhi edhe me çantat e zeza,por zbulimi ishte tronditës:Çantat mbanin brenda nga një dorë.Nga një dorë me gjithë cilësitë e duarve të zakonshme. Me gishta,me mollzagsishti e thonj,me pore-lëkure e me qime.Dhe mbi shuplakat e duarve zgjateshin e kryqëzoheshin vijat e fatit...Duart ishin me mish e me gjak si të prera nga trupa lëvizës apo të harruara,aty në çanta,nga binjakja,dora tjetër.Por çudia nuk mbaronte këtu.Në çdo çantë ishte e njeja dorë,vetëm dora e majtë.” Po pse të gjitha duar të majta ?”- pyeste veten Hotelieri,- “dhe kjo do të ketë të fshehtën e saj...” Njëqind pyetje e godisnin në tru e as njërës nuk i jipte dotë përgjigje që të bindëte veten...

Ato duar,brenda çantave të zeza,i dukeshin si bomba me sahat. Sikur,nga çasti në çast,hotel i tij do të hidhej në erë,apo gjemë tjetër do të ndodhte e ngjashme me shpërthimin e eksplozivit...Çfar të bente ? Të tregonte? E kujt t'i tregonte?! E,kush do ta besonte ?! Si ishte e mundur që nëpër çantat e njerëzve publikë,siç u paraqitën ata,të ndodheshin d u a r ?! “ Do të më marrin për të çmendur. Edhe në këtë vend ta ngjisin shpejt nofken “ i çmenduri “. Dhe mua do të më venë një “ ç “ përpara e do mbetem një plak i çmendur...Tek ne ka vetëm të mençur e të çmendur,nuk ka budallenj...” -i ra për herë të parë ky përcaktim në tru.

“ Ç’do ndodhë me këto duar ? Këta njerëz i kanë dy duart e tyre,nuk janë sakatë,po këtë dorën në çantë pse e mbajnë ?! Hë,ç’mu desh që i zbulova?!...Gjithë jetën nuk kam ndenjur rehat,kam dashur të shoh të paparën,dhe ja se ç’më gjeti...

Do të dalin ndonjëherë nga çantat ?

Do të bejnë siç bejnë gjithë duart e njerëzve ?

Do të kryejnë vepra duarsh ?

Do të punojnë ?

Do të marrin ?

Do të japin ?

Do të vjedhin ?

O Zot !

Kështu,duken të qeta si të pajeta,sikur s’kanë berë e nuk do të bejnë kurrë veprim duarsh...He,djallpunë ç’mu desh mua që i pashë ?!...Po tashti që i pashë,do t’i shoh gjer në fund...”.

Dhe Hotelieri vëzhgonte natë e ditë se mos ndonjë dorë bënte këmbë e ikte?... Apo ndonjëra hidhej nga njëra çantë, tek tjetra për të shuar vetminë ?...Apo ndonjëra kishte fluturuar duke marrë edhe çantën me vete ?...

Imagjinatën e shtynte edhe më tej, në veprime më të ndërlikuara e rrallë të bëra,në mos të pa ndodhura fare as nëpër faqe librash...

Por ditët kalonin dhe e pandodhura nuk po ndodhte. Gdhieheshin edhe netët,që janë fole misteri dhe duart ishin harruar në fundçantat e heshtura...

\*\*\*

**Dhomat e hotelit ishin që të gjitha të zëna.Kaq shumë të ardhur nuk kish pritur askurrë ai hotel. Dhe prapë dukej se nuk merrte frymë. Jetonte në qetësi varri.**

“ Mos janë hije dhe unë i shoh si njerëz ?”- dyshonte tek vetja plaku. “-...por sa herë hyjnë e dalin nga hoteli më

përrshëndesin, secili në gjuhën e vetë dhe unë në gjuhën e tyre ua kthej përrshëndetjen...Flasin hijet ?!...

Po njeriu e dëgjon zërin e hijeve ?!...Apo edhe unë nuk jam më njeri ?....Jo,jo,unë jam ai që kam qenë edhe këta njerëz duhet të jenë...Pse,duhet të ulërijnë që të jenë njerëz ?!...Bota e jashtme kështu i ka njerëzit të pafjalë e të qetë...Por edhe ne, që flasim e bërtasim, njerëz jemi...Ne të gjitha i përdorim me të tepërt...Të gjitha ç'kemi brenda trupit e jashtë trupit...Të gjitha...Të gjitha...

Një ulërimë ia këputi gjykimin Hotelierit Plak.

“Tpuu ! Si e harrova këtë ulërimë ?!....

Tpuu!...”.....

### *Sëmundja e kalit.*

Kishte kohë që kali ndjente një gërryerje mbi patkonj. Mbi patkonj e nën thundra diç lëvizte me një gërr-gërre të krimbtë. Dhe thundrat e forta,ku ishin mbërthyer patkonjtë,shkoqeshin e këputeshin copa-copa...Në fillim, këtë gërryerje, e kish ndjerë si kruarje kënaqësie e shlodhëse, pas bredhjeve të papushimta, nën frerin e Xherahut...Edhe më vonë nuk gjente kohë as ditëve,as netëve, për t'u marrë me gërr-gërren e krimbtë...Vetëm kur Xherahu u mbyll në pallat e diç bënte i vetëm,në pritje të miqve të huaj,u diktua sëmundja e kalit. Të katër patkonjtë i kishin renë e thundrat i ishin thërrmuar deri në kockë. Nga dy këmbët e para i rridhte një

lengqelbi ngjyrë blu në të verdhë, si ngjyrë zhapiku, ndërsa këmbët e prapme ishin tharë e holluar, sikur do të këputeshin.

Sëmundja e kalit u mbajt tepër e fshehtë. Asnjë oborrtar, brenda oborrit, e asnjë qytetar i Çmëdinës nuk duhej ta merrte vesh atë sëmundje. Shërbëtorët e brendshëm vetëm shërbenin dhe siguronin të drejtën të jetonin deri në marrje fryme, pa lëshuar zë e pa i ngritur sytë tek njëri-tjetri. Takimin me familjet e kishin të ndaluar dhe askush nuk e parashihte sa do të zgjaste kjo situatë....

Edhe vetë kali nuk dinte për sëmundjen e tij. Ilaçi i Xherahut e kishte berë punën e vetë... Por në gjithë këtë fshehtësi të përgatitur, patkonjtë e kalit kishin mbetur jashtë e të pafshehur...

Ku kishin mbetur patkonjtë e kalit ?...

\*\*\*

Në bredhjet e pafund të Xherahut mbi kalin e bardhë fëmijët ishin më kureshtarët. Lëshoheshin pas trokut duke e shoqëruar me urra e fishkëllima, deri sa kali me Xherahun mbi kurriz u humbnin nga sytë... Dhe dy nga patkonjtë ishin berë pronë e dy fëmijëve të një qyteze malore... I gjetën anës udhës së gurtë, pranë njëri-tjetrit sikur dikush t'i kish venë me dorë. Dy vëllezërit binjakë, që akoma nuk kishin kapërcyer vitet e fëmijërisë, i fshehën patkonjtë në një vend të sigurtë. Patkonjtë ishin të ngrenë e të holluar sa gati të këputeshin në copa, por dukeshin të rendë e të mëdhenj sa herë binjakët i kontrollonin se mos i kish marrë kush.

Njëri nga patkonjtë kish mbetur edhe me një gozhdë e një copë thundërkali dhe ishte më me vlerë. Këtë patkua donte ta merrte binjaku që hiqej si më i madhi, por me "çift a tek" e kish fituar binjaku më i vogël. Pas shumë argumentash e



thëniesh dy binjakët vendosën që patkonjtë t'i mbanin sekret sa të vinte koha që t'i shisin e të bëheshin të pasur.

Fshehtësia e patkonjve të kalit duhej mbajtur edhe gjatë kërkimit të tyre." Të gjenden pa i gjetur kush ! "-,kish ulëritur Xherahu dhe kish venë shpërblime të majme për gjetësin.

Në gjithë udhët nga kish bredhur kali u nisën një grup kërkuesish, "symprehtë e të pagojë",por bredhjet e kalit ishin aq të shumta sa duheshin vëzhgues e gjetës,që të bridhnin gjithë Çmendenin. Kjo e vështirësonte punën. Ku të gjendeshin gjithë ata gjetës dhe jo dokudo,por të kualifikuar e të pagojë ?!...

Një mendje ishte që të thirreshin gjetës nga jashtë,por kjo rrezikonte mbajtjen e të fshehtës.Bile,ndonjë gjetës i huaj mund edhe t'i publikonte e t'i shiste në ndonjë nga muzeumet e Botës. Ky variant,i paraqitur nga këshilltari i tij nuk u pranua nga Xherahu.

Një mendje tjetër ishte që me gjetësit vendas të bëhej kërkimi pjesë pjesë,duke ruajtur fshehtësinë e kërkimit. Kjo ishte mendja më e pranueshme,por vononte gjetjen e patkonjve. U dhanë edhe shumë variante të tjera,si ai i qenve apo i magjistarrëve,por të gjithë u hodhën poshtë nga Xherahu. Ai vetëm ulërinte duke përtypur dhembët proteza : " Të gjenden pa i gjetur kuush !...".

Së fundi,kërkuesit symprehtë e të pagojë u pajisën me nga një çantë e u nisën për kryerjen e detyrës, tepër sekrete,gjoja si shpërndarës të ilaçit të bardhë.

Nga një qytezë tek tjetra,nga malësia në fushë e në bregdet;nëpër oborre shtëpish e stalla bagëtish,kudo ku kish shkelur e qe hedhur kali me Xherahun mbi shalë...

U shpërndanë kërkuesit me torbat me ilaç në krahë...

U mendua se kjo mënyrë kërkimi ishte më e sukseshmja dhe pa probleme,por qysh në ditët e para nisën vështirësitë.

- Po sikur patkonjtë t'i ketë gjetur kush e t'i ketë fshehur ?

- Po sikur dikushi t'i ketë hedhur në ndonjë kosh plehrash si mbeturina pa vlerë ?

- Po sikur, ai që mund ta ketë gjetur patkuan, pa e ditur se i kujt kali është, ta ketë mbërthyer për fat mbi ndonjë portë stalle bagëtish, që bagëtitë të mos ia shqyente ujku ?...

Dhe shumë pyetje të tilla e benin më të vështirë, në mos të pa mundur, gjetjen e patkonjve të kalit të bardhë...

### *Hakmarrja*

Zbarkimi i të huajve me avionët e orgjencës e gjeti Xherahun në kulmin e tërbimit. Fitoria aq e pritur i qe kthyer në ankth frike. Herë-herë i dukej se në derë po i trokiste skandali. Kishte ditë që nuk dilte nga dera dhe, i mbyllur në dhomën e tij, thoshte disa fjalë të pa kuptimta, që kishin si refren një ulërimë të frikshme...

Në dhomën e Xherahut askush nuk mund të hynte. Edhe Zonja me sy të Kuq ose Madam Hi-Fi nuk mund të hynte. Vetëm sekretarja e tij mund ta zbuste e t'i gjente çelsin e qejfit...

Mbas prishjes së bukurisë Madama Hi-Fi kërkonte hakmarrje. Hakmarrje ndaj të gjithëve e ndaj çdo gjëje. Dhe nuk ngopej së dënuari shërbëtoret e së thyeri qelqe... Ç'i shkrepj në kokë e nuk e bënte ?! E bënte dhe nuk ngopej. Së fundi i kish kërcyer në tru që të hakmerrej edhe ndaj Xherahut. Ai ishte burimi i gjithë fatkeqësive të saj, që po i merrnin frymën. Edhe njollat e kuqe në fytyrë ai ia solli... Edhe flokët vatra-vatra ai ia shkuli...

Edhe ngjitja pas kalit të bardhë kishte nisur ta tërbonte... Po atë sekretaren esmere ?! Obobobo, tërbim dhe në ëndërr e kishte!...

...Ajo, Madama Hi-Fi, ose Zonja me sy të Kuq, më e bukura e më e respektuara, po i humbiste të gjitha...  
Po forcën e hakmarrjes e kish humbur ?!...

\* \* \*

Xherahu ishte qejfli i madh i pasqyrave. Qysh kur ishte i vogël shihej mbi pellgje uji, zbukurohej e shëmtohej, për t'u berë ndryshe nga ç' ishte.

Edhe pallati ishte ndërtuar në funksion të pasqyrave, që Xherahu i kish grumbulluar nga gjithë tregjet e botës. I gjithë pallati ish veshur me pasqyra të përmasave e zmadhimeve të ndryshme. Pasqyrat me zmadhim më të madh Xherahu i kish venë në dhomat e tij të punës dhe në dhomat e tualetit ose në WC. Ato zmadhonin nga 0,5 deri në 50 herë. Kurse në dhomat e Zonjës, pasqyrat ishin me zmadhim deri në dy herë.

Edhe sipërfaqet e pasqyrave ishin nga më të ndryshmet.

Qysh nga ato, që i mbante Xherahu në xhepin e brendshëm të kostumit apo pasqyrat, që i mbante Zonja në çantë e deri në pasqyrat e tavaneve, të dyerve, të mureve.... Sa herë Xherahu hynte në pallat, ashtu i hypur mbi kalë, pasqyrat e hidhnin dhe e prisnin në një lojë pa mbarim... Ai ndjehej i kënaqur nga kjo lojë pasqyrash, kur shihte se çdo lëvizje e tij pasqyrohej njëherësh, në 10-20 pasqyra, në madhësi e pozicione të ndryshme... Ato pamje ishin marramendse e të frikshme për sytë e një normalie, por Xherahu zbavitej kur e shihte veten me njëzetë kokë e i hipur në njëzetë kuaj... Qeshte me zë sa i skuqeshin sytë dhe njëherësh, qeshnin me të muret, dyert, tavanet... Pastaj ai hapte gojën për të përdorur fjalët e reja, që do të mbante nëpër fjalime dhe e gjithë dhoma mbushej me gojë e tij të shqyera.... Gojë të zmadhoheshin, aq shumë, sa nuk

mund t'i nxinin dot pasqyrat dhe pasqyroheshin copagoje,që nuk mund t'i bashkoje dot kurrë në një gojë të rregullt njeriu.Brenda këtyre gojëve të stermëdha,,fjalët e Xherahut ndjeheshin të vogla e të pa fuqishme edhe pse brenda ishin mbushur me ulërimë.Fjalët, që lëshonte fyti i tij, shuheshin pa arritur tek veshët e papasqyruar.Dhe Xherahu rriste fuqinë ulëritëse ,deri në dridhje tavani,por pasqyrat qeshnin e talleshin me stërmundimin e tij dhe, si për inat, e shqyenin më tepër gojën në shtrembërim të frikshëm...

Xherahu,larjen nuk e kishte edhe aq qejf.Që kur ia kish hipur kalit ndodhte që të lahej një herë në muaj,apo edhe çdo dyzetë ditë.Ky ishte një shkak më shumë për Zonjën që të mos flinte me të dhe ta përdornin krevatin dykokësh rrallë e më rrallë.Zonja e mbyllte derën e dhomës dhe ai kot priste pasdere, i fryrë gati në shpërthim.Kur i humbte shpresat e shtrirjes mbi Madamë Hi-Finë,lëshonte një ulërimë si të luanit dhe mbyllej i djersitur në dhomën e tij.Aty,bënte-çbënte me kalin e tij sa jargëzohej...Por një mëngjes ndodhi ajo që nuk kish ndodhur deri atëhere...

Atë mëngjes, trupi i Xherahut sa nuk shpërthente nga padurimi mashkullor.Kish dalë nga dhoma dhe po priste, aty në koridor,prapa derës së Zonjës.Priste momentin kur ajo do të dilte nga dhoma e fjetjes për në banjë.(Zonja asnjëherë nuk i kryente nevojat trupore në banjën brenda dhomës së fjetjes,zakon ky i fëmijërisë.)

Sa ndjeu erën e parfumit të saj,ai iu hodh befas,si luani sorkadhes.E mbërtheu,ashtu siç ishte me këmishën e natës dhe krejt e mishtë,se Zonja qysh nga fëmijëria në atë vendin e saj të largët,ose më mirë në moshën e pas fëmijërisë,nuk vishte më nga ato që i" marrin frymën pjesës më të bukur të trupit ",siç i thosh ajo shoqes së shkollës së mesme,kur diskutonin për ato gjera...E mbërtheu ai,aty para derës së banjës dhe e gozhdoi me mashkullorin e tij agresiv...Madama Hi-Fi,bëri të kundër-

shtonte,por e kënaqur nga kjo befasi,nuk grerëzoi,siç bente zakonisht mbi krevatin dykokësh,ngjyrë-floriri...Ajo u lëshua si e vilanosur në gjymtyrët e tij të fuqishme...Një nga shërbëtoret po e ndiqte ,nga diku ,gjithë skenën.Ishte shërbëtorja e re e pallatit,ajo esmerka syjeshile, që vetë Zonja e kishte zgjedhur. *Syjeshiles*,sa hyri në pallat,sikur i kish fryrë djalli në vesh,vëzhgonte ethshëm,ditët e netët e Xherahut e të Hi-Fisë. Dhe kish zbuluar se ata nuk flinin bashkë,të paktën atë javë që ish ajo në vëzhgim.Nuk e zinte gjumi shërbëtoren e re,me racë qejfi dhe ç'nuk i thoshte truri!

Me imagjinatën e saj të ndezur ajo herë hynte në dhomën e Zonjës e herë në krevatin e Xherahut...

Dhe shërbëtorja e re nuk hynte më një herë në javë në dhomën e Xherahut ...

Dhe Xherahu nuk i zuri më pritë Hi-Fisë ...

### *Patkonjtë*

Afati i gjetjes së patkonjve po mbaronte. Dhe ende asnjë rezultat.Grupet e kërkimit nuk kishin lenë udhë e sokak,gropë plehrash e kalldrëme.Ku nuk ishin futur e nga nuk kishin dalë?! Kishin mbledhur me qindra patkonj,më shumë patkonj gome-rësh e mushkash,që dukeshin si copa petullash metalike,por edhe disa nga ata në formë gjysmëharku, që kishin renë nga thundrat e kuajve e të pelave...Ditën e nënte të kërkimit u shtruan këmbëkryq mbi një lëndinë të fshehtë,ku vetëm gjarprinjtë mund t'i shihnin nga të çarat e shkëmbinjve. Në atë kuvend patkonjsh kërkuesit e shquar,ose kryekërkuesit e

grupeve argumentuan mbi patkonjtë e gjetur. Më shumë u grindën se u morrën vesh.

-Këta duhet të jenë patkonjtë e kalit të bardhë-foli një mustaqeverdhë,duke rrotulluar nëpër duar disa copa hekuri,të dukur si patkonj.

-Patkonjtë e vërtetë të kalit të vërtetë të Xherahut,pa diskutim,janë këta që po paraqes unë. Këta patkonj kanë marrë hijen e kalit dhe hijen e Xherahut të lavdishëm,që nuk lodhet kurrë e s'ka për t'u lodhur për të mirën e Çmendinës – nuk mbaroi së foluri një mesonjeri me nishan në hundë.

- Boll se na çave bythën! Me ata patkonjtë e tu të vete në hale koka,ti edhe neve bashkë-e ndërpreu një djalë leshgjatë me një bishtkali pas koke.

Gjithë kërkuesit donin të ishin gjetur patkonjtë e vërtetë për të mos u ikur koka,por kush do të merrte shpërblimin nga Xherahu ?! Kush do të ishte fitimtari i këtij aksioni sekret ?! Do të kish fitimtarë apo të humbur ?!...Lakmia e fitimit dhe e lavdisë ndeshej me frikën .Të gjithë e dinin se inati i Xherahut ishte i egër e vrasës.Pranimi i patkonjve si të vërtetë ishte gjëja më e rrallë, që mund të ndodhte. Gjatë atyre nënte ditëve kishin ngjarë ngjarje tronditëse,që e benin edhe më të pamundur përballjen me Xherahun kalorës.Shtatë nga kërkuesit kishin kapërcyer kufirin në arrati ,ndërsa njëri u gjet i varur nën harkun e një ure. Ishte një djalosh,që në atë fundjavë do të bente dasmën e vetes.Këto ngjarje tronditëse ishin komentuar më tepër nga buza në buzë,gati në heshtje. Ata patkonj të mallkuar kishin nisur të hapnin varre...Dhe ata burra të ulur këmbëkryq mbi atë luginë të fshehtë,më tepër grindeshin dhe mallkonin fatin e tyre,se sa diskutonin për të përcaktuar patkonjtë e vërtetë...

-Të pyesim një herë nallbanin,ai që ka mbathur kalin i njeh mirë dhe patkonjtë e vërtetë – u hodh një mendim, që u erdhi mirë të gjithëve kur e dëgjuan.Por si t'ia kërkonin

ndihmën nallbanit pa i treguar sekretin e detyrës së tyre ? U diskutua gjatë edhe për këtë deri sa u vendos : T'i tregohej halli nallbanit e t'i kërkohej ndihmë.Kushtet për të mos treguar ishin shumë të rrepta,sa nallbani do të preferonte të priste gjuhën se sa të tregonte sekretin.

Por me nallbanin kish ndodhur ajo që duhej të ndodhte.

Ai,si të ishte jashtë kësaj bote,hapte sytë pa ngjyrë dhe vetëm heshtëte e heshtëte gjuhëprerë...

### *Qorrimi*

Arsyreja e vërtetë pse Zonja i theu gjithë pasqyrat nuk dihet. Në pallat kishin ndodhur aq shumë të pandodhura sa njëra i dilte para tjetrës dhe bëhej shkaku kryesor i asaj thyerje.Në vend të parë dilte shëmtimi i Zonjës. Një shëmtëri e menjëhershme,e pa pritur. Fytyra e saj e mermertë u mbush me njolla të kuqe e flokët po i binin vatra-vatra.Mori një pamje të frikshme e mëshiruese,por këtë kënaqësi ajo nuk jua dha syve të botës.Askush nuk mund ta shihte shëmtërinë e saj veç pasqyrave të kudondodhura.

“ Nga më erdhi kjo e keqe ?!” fliste ajo me vete dhe për herë të parë iu njomën sytë me lëngtërbimi . Me atë inat të tërbuar u lëshua nga njëra dhomë tek tjetra,nëpër koridore,banja e sallone...Gjithë pasqyrat u thyen deri në shkoqje.Ato pasqyra nuk do të bënin më siç kishin bërë.Shëmtërimin e Zonjës me Sy të Kuq nuk kish kush ta pasqyronte me zmadhim shëmtërie.Edhe vetja nuk do e shihte më atë fytyrë. Kjo ishte hakmarrje ndaj vetes apo e nisur nga vetja ajo hakmarrje do të përplasej diku ?...

\* \* \*

Shërbëtorja e re e shihte me mospërfillje Zonjën që kur Xherahu e kish zgjedhur sekretare të punëve e përgjegjëse të qejfeve.Ndjehej krenare që Xherahu shlodhej mbi trupin e saj dhe e kish harruar Madamë Hi-Finë. Ajo krenari po kthehej në fyerje e poshtërim harrese për Zonjën edhe pse krevati i saj dykokësh nuk kish mbetur asnjëherë bosh.Madama Hi-Fi e kërkonte harresën e shëmtërisë së saj nga kujtesa e pasqyrave,por nuk e duronte dot harresën e të qenit në atë pallat.Ai pallat do të ish i gjithi i harruar pa qenien e saj. Harresa poshtëruese për të ishter hakmarrje...Dhe hakmarrja qe ngritur prej kohësh në këmbë. Ajo kish marrë pamjen e kait e të pluhurit të bardhë. Qe futur në enigmën e hingëllimës së kalit e ulërimës së Xherahut ...

Një shkretëtirë e vërtetë ose një ngrehinë e qorruar.  
 Pallati i pasqyrave gjigande ndjehej i pajetë.Një vrasje të tillë kush e kish menduar ?!...  
 Në atë pallat veç pasqyrave nuk kish asgjë tjetër që të merrte frymë. Nuk kishte dhe nuk kish patur.  
 As libra...  
 As lule...  
 As piktura e skulptura ...  
 As shandanë dritash nuk kishte ...  
 Në atë pallat mungonin edhe dritaret, nga ku mund të hynte drita. Arkitektura e tij niste nga pasqyrat gjigande,vendosur në portat e rënda të hyrjes,që thithnin dritën qiellore e ia përplasnin njëra-tjetrës nëpër koridore,dhoma e sallone,në një lojë tallëse me mashtrim të shumëfishtë.Në atë pallat drita qiellore thyhej e s' dihej nga kish ardhur dhe qielli përmbysesj,



coptohej e shkoqej sa harrohej ç'kish, qënë qysh në orgjinë...

Me thyerjen e pasqyrave kish ndodhur qorrimi i plotë i krejt pallatit.

Brenda pallatit qorr lëviznin ata lakuriqnate me trajta njerëzish në çmendinë e jetës së tyre...

\* \* \*

Sa perënduan yjet në qiell, binjakët morrën udhën për tek hoteli i vjetër. Patkonjtë i mbanin të fshehur, ngjitur me trupin e i kishin maskuar për mrekulli, sa kur e shihnin njëri-tjetrin, qeshnin me mburrje. Rast më të mirë për t'i shitur e për t'u pasuruar nuk do të gjenin. Ata avionët e çuditshëm e ata njerëzit me çanta të zeza sikur kishin ardhur me porosi për të blerë patkonjtë e tyre. Po si do t'i takonin turistët? E hodhën dhe e pritën këtë mendim dhe më së fundi e gjetën shtegun. Hotelieri plak ku pushonin turistët. Vetëm ai ua dinte gjuhën e huqet të jashtëmve. Vetëm ai mund t'i ndihmonte.

Po si t'ja tregonin?

Po sikur?

Nuk kishte rrugë tjetër. Do t'ja tregonin gjithë historinë e patkonjve e do t'i kërkonin ndihmë. Me këtë vendim ata hynë në hotelin e vjetër.

Hotelieri plak, i lodhur nga nata, ishte përhumbur në një gjysmëfjetje. Ai, njëherësh, ishte në endërr dhe e ndjente se ato ngjarje, që shihte ishin jashtë realitetit syhapur...

I ndodhte shpesh që të ndjehej dhe i zgjuar dhe në gjumë. Ndoshta të qenit hotelier për shumë vite, ndoshta fundosja deri në raskapitje nëpër faqelibrash, apo ndoshta një jetë në pritje të dashurisë së humbur, e kishin gjysmuar gjumin e tij dhe ai e jetonte jetën midis realitetit e endrës?!... Atij i vinte mirë që i zotëronte të dyja njëherësh: edhe gjumin edhe

zgjimin. E mes tyre shtrihej ëndrra. Gjithmonë gjumi i tij kishte endrren brenda.

“ Po të mos shtrihem mbi çarçafin e endrres, s’e kuptoj që kam fjetur dhe po të mos ndjehem zgjuar nuk e quaj të vërtetë endrren...”, -kish lexuar ai në një roman.

“ Sikur të ketë fotografuar trurin tim...” , -mendonte Hotelieri Plak duke i ditur mirë sekretet e krijimtarisë letrare. Pastaj mendonte se e kishte thenë kot atë mendim. Nuk i pëlqeu që i zbriti në tru ai autori i huaj për të rreshtuar fjalët e romanit si gjetje të gjysmëgjumit e gjysmëendrës së tij.

Kur në hotel hynë vëllezërit binjakë ai rrinte i fundosur në kolltuk e nuk kishte dalë akoma nga endrra e kontrolluar.

-Shshst se po fle – pëshpëriti binjaku i vogël dhe e mbajti nga krahu të vëllanë.

-E, le të zgjohet se për atë kemi ardhur !.

### *H e s h t j e.*

Gjithë përgatitjet për ceremoninë e pritjes së miqve shkuan kot. Xherahu e kish thenë mbi njëmijë herë, para pasqyrave, fjalimin e tij. Edhe pas qorrimit të pallatit ai ulërinte në errësirë fjalimin e tij ceremonial. Disa fjalë, që në dëgjim ishin vetëm zgjatje tingujsh, i përsëriste me shtyrje buzësh e copa pështyme.

Errësimi i plotë i pallatit e befasoi një çast Xherahun, por ai kish veti që t’i përshtatej menjëherë çdo situatë, bile i pëlqenin e i nxiste vetë ekstremet. Si drita verbuese dhe errësira qorruese frymëzonin gjithë qelizat e gjalla në trupin e Xherahut kalorës...

Edhe pse nuk u zhvillua ceremonia e pritjes miqtë e qiellit hynin e dilnin në pallat, të pa pritur e të pa përcjellë, me çantat e zeza në duar, që dukeshin sikur transportonin heshtjen...

Ulërimat e Xherahut sikur kishin vdekur ose ishin berë të pa dëgjua për banorët e jashtëpallatit.

- O Perëndi ndonjë e keqe do të na vijë nga kjo heshtje..
- Ulërima është më e tmerrshme kur nuk dëgjohet....
- Ç'po ndodh në pallat ?...
- O Perëndi,ndonjë të keqe do të na sjellë kjo heshtje...

Përplasnin buzët në lutje banorët e jashtëpallatit duke ecur të frikësuar mbi mendimet e tyre...

### *Mbjellja e duarve.*

*Diçka misterioze po ndodhte.*Brenda një nate,duart lanë çantat e zeza dhe u mbollën në copa toke.Askush më parë nuk kish venë re kazmimin e tokës mbi Shtegun e Djallit dhe përgatitjen e saj për mbjellje.

Në atë dhé të kuq mes shkëmbinjve,nuk mund të mbillej e të rritej agjë,veç ferrave e barit çponjës,që mbini e thaheshin për qejf të erës,diellit e shiut.

Zbrazja e çantave të zeza, në atë dhé të kuq, ishte mbjellja më e pandodhur...

Mbjellja e duarve !...

Ishte e frikshme ta hidhje nëpër mend e jo të ndodhte në të vërtetë...Për gati një muaj,brenda çantave të zeza,ato duar dukeshin se benin gjumin e vdekjes. Hotelieri Plak u mësua me qenien e tyre të paveprimtë dhe netët nisnin e mbaronin pa misterin brenda.

Por,në atë pasmesnatë,kur ai bente gjysmëgjumin e zakonshëm, ndodhi e pazakonshmja. Pronarët,ose më saktë,prurësit e duarve zbritën heshtas shkallët e hotelit dhe nisën udhën,njëri pas tjetrit,për tek Dhéu i Kuq.Udhën ua hiqte nallbani gjuhëprerë.Ecnin në heshtje si të pafrymë.Çdonjëri

në dorën e djathtë mbante çantën e zezë dhe çanta mbante nga një dorë të majtë brenda...

Në atë copëtokë ishin hapur disa gropa dhe asgjë më. Ato gropa, që ngjanin më tepër me disa vrime të zeza, mund t'i gjente vetëm nallbani gjuhëprerë. Gropat ishin ndarë në grupe e ishin përcaktuar mënyrat e mbjelljes, sasia e duarve dhe të dhena të tjera për procesin e parambjelljes e të pasmbjelljes... Më e rëndësishme ishte fqinjësia e duarve të mbjella. Por të gjitha këto masa paraprake nuk i shmangën mosmarrveshjet e vonesat e panevojshme gjatë procesit të mbjelljes së duarve.

Kreu i parcelës u takoi grupeve kryesorë të duarve: Duart "*merr-merr, vidh-vidh, e vra-vra*", por kish dhe grupe të tjerë jo më pak të rëndësishëm si: "*ha-ha, tpu-tpu, ëh-ëh*"... e të tjerë.

**Hëna** akoma nuk dukej. Dhe pa ndritur hëna do të mbilleshin jo pak po 99 fidanëduarsh. Gjithë të ardhurit e qiellit aty ishin. Edhe të dëmtuarit e avionit, që u përplas me tufën e lopëve, kishin dalë nga spitali e ishin gati të mbillnin duart e tyre.

Ta mendoje nuk që e vështirë që dy duar të mbillnin një dorë të vetme, aq më tepër që gropat ishin përgatitur qysh më parë. Do të futej dora në gropë, do të ngjeshej mirë pas baltës së kuqe dhe mbjellja merrte fund. Por s'ishte kaq e thjeshtë. Edhe pse duart ishin të gjitha të majta e gati të njëlljoita, në mbjellje kishin të veçantat e tyre. Thellësia e futjes në gropë dhe përballja me njëra-tjetrën ishte e ndryshme. Duart e tipit "*merr-merr*", për shëmbull, duhej të mbilleshin më larg se të tjerat, apo duart e tipit "*vrit-vrit*", nuk duhej të përballeshin, por të mbilleshin në krah e gishtat e mëdhenj të shihnin njëri-tjetrin.

Rregulla të ndryshme kishte edhe për tipduart e tjera. Më e veçanta ishte mbjellja e duarve të tipit "*ëh-ëh*". Ato duhej të mbilleshin çift dhe në një gropë me duart "*tpu-tpu*".

Gjithë këto kushte bëheshin më të vështira në atë natë pa henë. Edhe pse me rregulla të shtrenguara e me kujdes të detyruar, ndodhi që të ngatërroheshin gropat e të mbilleshin pranë e pranë duart “*vidh-vidh*” e “*ha-ha*”.

Sa i futën në gropë ato tipduar nisi lëvizja nervoze e gishtave duke u hedhur e mpleksur mes tyre...

Së fundi, mbjellja e 99 fidanëduarve mbaroi, kur hëna akoma s’e kishte nxjerrë syrin nga mbimali. Dhe 99 duar mbjellësit, me çantat bosh, zbritën në heshtje nga Shtegu i Djallit... Dhe në heshtje ngjitën shkallët e hotelit pa e shqetësuar Hotelierin Plak.

### *Djaloshi i dashuruar.*

**K**ur vetëm ujet prushëronin qiellin dhe çantat e zeza kishin marrë udhën e ngjitjes për tek Balta e Kuqe një djalë, që s’i kish mbushur akoma të njëzetat, kish marrë udhën e zakonshme, për tek ajo që e priste.

Netëve me dritëhëne, apo krejt në errësirë, ai ngjitej në dhomën e saj. Ajo, sa e shihte nga dritarja, lëshonte gërshetat e gjatë e ai ngjitej pas tyre, me një frymë, pa pyetur syrin magjik të ashensorit...

Edhe atë natë, kur çantat e zeza lëviznin pas njëra-tjetrës, në dalje të qytetit, ai sa ishte ngjitur pas gërshetit tek dritarja perderëndë, ku e priste ajo. Së bashku me “*Syzezë e Vetullapë*”, siç e këndonte ai emrin e saj, rrinin në humbjedashurie, kur tek Shtegu i Djallit u shfaqën hijet-njerëz. Sytë e të dashuruarve shohin edhe në errësirë. Dhe ata nisën të numëronin duke u mbytur në buzët e njëri-tjetrit.

- Sa ishin ?-pyeti ajo me buzët që i digjinin.
- 99 -iu përgjigj ai, pa i venë rëndësi pyetjes së saj.
- Edhe unë aq numërova.

- Çfar numërove ?
- Ato hijet, që kaluan tek shtegu.
- Po ç' të jenë ato hije, njerëz apo bisha ?
- Mbase janë jashtëtokësorë nga ata të piramidave...

Nuk folën më. Hijet i lanë në punën e tyre dhe ata bënë punën e tyre....

Hoteliereri Plak ishte i vetmi, që e njihte dashurinë e Djaloshit të Dashuruar. Dhe këtij dashnori të çmendur ai i kish treguar historinë e zemrës së tij.

Sa ndjeu praninë e Djaloshit, Hoteliereri u ngrit nga karrikja-kolltuk e i doli para.

- Heee, kush na erdhi !-lëshoi zërin plaku dhe rregulloi fjalët e një kënge: "Syzezë e vetulla për / do vij sonte natën"

- "Ta di që të vritemë / me plumb të goditemë / me hanxhar të pritëmë..." -vazhdoi Djaloshi dhe përqafoi Plakun.

- Po ç' të solli pa zbardhur drita ? Ndonjë hall i madh pa tjetër! Ke berë ndonjë marrëzi të re ?-e mbyti me pyetje Hoteliereri.

-Jo ore jo, s'e kam bërë akoma atë që s'dihet-ia ktheu Djaloshi duke përdorur shprehjen e zakonshme të Hotelierit : "S'e kam thenë akoma atë që s'dihet", -duke i dhenë më tepër veprim fjalës "s'dihet" dhe vazhdoi me zë të përmbledhur: "Sot jam i njëqindi, i njëqindi që hyj në këtë portë".

Plaku e kuptoi domethënien e fjalëve që Djaloshi kish ndjekur të 99-tët e tij misteriozë. E tërhoqi mikun e tij në dhomën e vogël, në të djathtë të hyrjes, për të vazhduar bisedën.

- Ata turistët e huaj më duken njerëz misteriozë-foli Djaloshi.

- Pa hë ?

- Ja, sonte natën u ngjitën lart tek Shtegu i Djallit e pas disa orësh zbritën siç u ngjitën. Ishin plot 99 me nga një çantë në dorë. Udhën ua hiqte ai gjuhëpreri, nallbani i atij të çmendurit...

- Pa hë ?- bëri përsëri Hoteliereri.

- Kur zbritën, pas tre orësh, vuvi i pagojë nuk ishte më. Do të ketë pirë ilaçin e Xherahut dhe ai e do të ketë zbritur tek të shumtët-u mbush një herë me frymë e në nxjerrje të frymës tha-gjynah!

- Po ti nga i pe ?

- Nga Kalaja e Dashurisë, nga t'i shihja tjetër?-qeshi

- Pa hë ?

- Pastaj i ndoqa pas e larg, pas e larg e më sollën këtu.

- Çfarë flisnin udhës?-pyeti kot Hotelieri edhe pse e dinte se mysafirët e qiellit nuk do t'i kishin lëvizur buzët për asnjë fjalë.

- Sa fole ti që ishe këtu aq folën dhe ata, që ishin atje. Dukeshin si hije e jo si njerëz. U rëndonte më shumë koka se çanta, që mbanin në dorë...Djali e di se ç'kishin fshehur aty brenda?

- Hëëë – lëshoi disa zanore kënaqësie Plaku.

- Po edhe ti diçka do të dish...Se mos është më i zgjuar Djalli nga ti!-mbaroi së foluri djaloshi në pritje të Plakut të mençur. Hotelieri drodhi një cigare duke zgjatur heshtjen e rrotulloi disa herë nëpër buzët e holla e të rreshkura, pastaj e ndezi me një çakmak të bardhë në formë dreri, që e ruante qysh nga djalëria. Foli: "Bëre mirë që erdhe, kam aq shumë gjera sa...Eh! Çuditë e këtij muaji nuk i kam gjetur gjithë jetën...As njerëz e as hije janë...Zbritën si të ardhur nga planete që s'dihen e u mbyllën këtu...Sikur janë në gjak me gjithë Botën e i fshihen gjakmarrjes...Çdonjëri solli edhe nga një çantë të zezë. Epo, paisjet e nevojshme mendova, siç bëjnë të gjithë kur marrin udhë, pastaj edhe ndonjë libër për të lexuar, se pa lexuar nuk lëvizin ditët"...

- Po ç'kishin në ato çanta ?-nuk iu durua Djaloshtit.

-Asgjë nuk kishin. As libra e as mjete tualeti. Vetëm nga një dorë e asgjë tjetër.

-Si vetëm nga një dorë?Sakatë na qenkan këta qiellorët?!

- Jo vetëm që nuk janë sakatë ,por kanë nga tre duar.
- Nga tre duar ?
- Po nga tre duar kishin – foli prerë Plaku.
- Si me tre ? Ç'benin me tre duar?!
- Me dy duar mbanin dorën e tretë.
- Si ?
- E,kështu. Çdo çantë e kish nga një dorë brenda.
- Po flet endrra më duket,apo më tregon ndonjë përrallë librash ?
- Edhe mua kështu m'u duk në fillim,sa dyshova tek sytë e tek truri im,por e vërteta kështu është.Në ato çanta kishte nga një dorë të mishtë,ja si këto-dhe me duart e reshkura i mbërtheu duart Djaloshit.

- Po tregon çmendurira...

-Nuk janë çmendurira jo,por akoma nuk i dimë të gjitha,ç'u bë me ato duar sonte ?

Djaloshi mbeti disa çaste i hutuar para fytyrës së qetë të plakut,pastaj e mblodhi veten e tha:

- Diç kanë berë tek *Balta e Kuqe*.Aty u ngjitën e andej zbritën. Unë do t'i zbuloj. Të hypësh në *Kalin e Dashurisë* sheh se ç'bëhet në gjithë botën e jo matanë *Shtegut të Djallit*-foli Djaloshi me sigurinë që i jipte mosha.

-Nuk është aq e lehtë,për të ardhur gjer tek ajo natë,u desh gati një muaj heshtje-foli Plaku dhe i shtypi kokën cigares së ndezur.

### *Ç'ndodhi me duart ?*

*Qysh në ditët e para,kur duart nuk kishin lëshuar akoma rrënjët e rritjes,pati ndodhira: Një ujk i uritur,sa i pa nga maja e malit,u vërsul e pa e ndalur dot rojat,që ishin vendosur nëçdo cep të parcelës,rrëmbeu një nga duart e llojit “ merr-merr”andej*



nga kreu dhe, në vrap e sipër, e kollofiti...

Edhe një zhgabë, pendërenë, u lëshua mbi kokat e rojave dhe vari në çengelët e kthetrave e të sqepit edhe tre duar të tjera, nga ato të llojeve “*ëh-ëh*” e “*tpu-tpu*” që ishin mbjellë në të njëjtën gropë.

-Ç’po ndodh andej nga Balta e Kuqe?-pyesnin njerëzit,plot ankth,kur dëgjonin krisma armësh.U përhapën lloj-lloj zërash.Njerëzit flisnin brenda shtëpive e në kafene,më tepër duke u përtypur mbi tavolina,apo duke rrufisur kafen e nxehtë...Edhe pse flisnin, secili për vete,të gjithë e dinin se tek Balta e Kuqe ishte mbjellë një farë e çuditshme: *farëduarsh*.

-Përse duhen ata fidanë ?

- Pse i mbollën tek Balta e Kuqe ?

-Kush i mbolli ?

-Thuhet se i hedhin ilaç nga ai i Xherahut dhe ato bëjnë përpjetë si plepi në mut.

-Se ç’do kenë ato duar se ai ujku,që hëngri njëren prej tyre ka ngordhur.

-Kush të tha ty?

- E kish gjetur në një shpellë çobani i dhive.

-Po për doracin e more vesh? Shkuli një dorë i varfëri,fshehur në mes të natës,që t’ia ngjiste krahut të tij të prerë,por të nesërmen e gjetën të mbytur brenda në shtëpinë e tij. Se kush e mbyti nuk dihet?

-Dora, që vodhi e mbyti,kush tjetër !

-Disa thonë se e ka mbytur dora e tij.

- Ja njëra ja tjetra,ose të dyja bashkë.

- E,pse ta mbysnin ?!

- Se Perëndia e la me një dorë,ai donte prapë dy...

Kështu diskutonin njerëzit, çdo ditë, mbi tavolinat e bukës apo kur rrufisnin kafen e nxehtë.E, çdo ditë e më tepër, shtoheshin hamendjet dhe misteri.U shtuan edhe spiunët,që përgjonin në çdo shtëpi,furrëbuke a kafene...U shtuan edhe rojat tek Balta e

Kuqe,ku rrethuan çdo pëllëmbë të parcelës me tre rrathë,sipas llojeve të armëve që përdornin.Se nga kishin ardhur rojat nuk dihej? Flisnin një gjuhë të pafolur në Çmendingë dhe fytyrat sikur i kishin ndryshe nga banorët vendas.

Njerëzit me çantat e zeza hynin të heshtur,u hidhnin në rrenjë dozën e nevojshme të ilaçit të bardhë e iknin me kokat ulur e me çantat në duar.

Edhe një ditë...

Edhe një ditë...

Edhe një ditë...

Dy herë në javë ata bënin të njëjtin veprim me ilaçin e bardhë.Vetëm ujë nuk u hidhnin.Çuditërisht ato rriteshin e shumoheshin,sa ajo copëtokë u mbulua nga një pyllduarsh i vërtetë.

Një rritje e frikshme.Disa nga rojat,të tmerruar,kishin braktisur shërbimin e kishin ikur në drejtim të panjohur.

Edhe pse u rritën pagat për rojat e u forcuan dënimet për dezertorët,rojat rralloheshin e rralloheshin çdo natë.

Dhe rojat e rinj nuk pranonin të ruanin atë pyll të frikshëm duarsh.

Nga ky tmerr në rritje dhe të pa priturat që priteshin,çmendinasit u ngritën me të shara kundër pallatit e të ardhurve misteriozë...

Revolta po rritej çdo ditë e s'dihej se ç'mund të sillte e nesërmja,po të mos vinin ndodhi të reja ....

### *K o l e r a .*

Patkonjtë, që kishin sjellë binjakët tek hoteli i vjetër, nuk kishin ngjallur interes tek të huajt.Edhe dy vajza, që i kishin parë më gjatë,kishin lëvizur buzët në një qeshje të këputur e s'i kishin ngritur duart për t'i prekur.

Hotelieri Plak donte të mos ua prishte binjakëve .Pasi u dëgjoi historinë e patkonjve,i përkëdheli e u premtoi ndihmë.Në fillim atij i qe dukur interesante edhe pse e fryrë nga fantazia e vogëlushëve.Patkonjtë e një kali të rrallë,siç ishte kali i Xherahut,nuk ishin fare pa vlerë dhe aq më tepër kur bëmat e tij, që po çmendnin gjithë Çmendenën,kishin marrë dhënë.Por indiferenca e të huajve ishte tallëse e bezdisëse.Qëndrimi i tyre Plakut i dukej sikur fliste:"Po ky i çmendur ç'na i ka sjellë këtu në ballë të sportelit,sikur të ishin të florinjte"?!...

Binjakët erdhën edhe disa herë, për të ndjekur fatin e patkonjve,por plaku edhe pse nuk kishte berë gjë,u tha që t'i linin edhe ca se nuk i dihej:" me të tekur e kanë të huajt"...ndofta në ditën e ikjes i tekej ndonjërit e i blinte, por një lajm i tmerrshëm,brenda ditës, pushtoi gjithë Çmendenën.

-Kolera....Kolera...sëmundja e vdekjes...

-Në pallat ka renë kolera...ka zenë Xherahun...

- Pse vetëm Xherahun ?! Të gjithë...Të gjithë...

-Kali ka ngordhur nga kolera...

- E groposën ?

Njerëzit të tmerruar nuk dini ç'thoshnin e s'dinin se ç'të benin

Thuhej se jo vetëm kali kish ngordhur,por edhe Xherahu:" Unë nuk i zbres kalit,këtu le të vdes!"-sikur kish thenë Xherahu dhe bashkë me kalin kish dhënë shpirt.

Thuhej gjithashtu se Zonja me Sy të Kuq e dinte që kolera do të binte në pallat dhe nëntë ditë para kish ikur me një fluturues.Disa thonin se u largua me një karrocë me katër kuaj,së bashku me Komandantin e Rojave të pallatit. Disa të tjerë flisnin se madamë Hi-Fi kishte ikur me një nënujore...

Thuhej edhe se trupat kolcerëzënë duheshin djegur,por oborrtarët kishin frikë se bashkë me flakët do të ngriheshin edhe grimcakolere...Në gjithë Çmendenën, në mos edhe

matanëkufijve,do të përhapej sëmundja e tmerrshme...  
Thuhej edhe se kalin edhe kalorësin do t'i hidhnin në një  
 gropë me gëlqere të pashuar,por akoma s'qe berë gati gropa,që  
 duhej me përmasa gjigande 55x55x55m si dhe duheshin djegur  
 10 furra me gëlqere...

Njerëzit të tmerruar nuk dinin ç'të thoshin e nuk dinin ç'të  
 bënin...

### *Pylli i duarve*

**B**alta e Kuqe e pluhuri i bardhë bënë që duart të lëshonin  
 rrënjë e të merrnin zhvillim të menjëhershëm. Sa nisnin të  
 përpjetën në rritje,po aq lëshoheshin e zgjateshin nën tokë  
 rrënjët e damarta e kockëpërdredhura.Ato hynë nëpër  
 rrënjëferrash e rrënjëdrizash dhe ferrat e drizat u thanë.Hynë  
 ato rrënjëduarsh nëpër rrënjëshkëmbi e shkëmbi nisi të çahet,të  
 shkoqej e të thërmohej në shtuf...Nëntoka e atij dhëu të kuq  
 tjetërsohej duke përtypur veten e duke u përtypur nga ato rrënjë  
 të damarta e kockëpërdredhura....

Mbitoka dukej më e qetë e indiferente me të fshehtat e saj  
 nëntokësore.Mbitoka e nëntoka,në atë parcelë duarsh,sikur i  
 kishin prerë mardhëniet ose s'donin të dinin më për njëra-  
 tjetrën...

Heshtja është e vërteta dhe tradhëtia e së vërtetës. Mbitoka  
 heshtete për ndodhitë e nëntokës duke e kapakosur me atë  
 heshtjen e gënjeshtërt.Më tepër mbitoka nuk i tregonte  
 ndodhitë e nëntokës,për të mosthenë edhe ndodhitë e saj të  
 mbrapshta...

Ato duar ,që ngriheshin mbi tokë 10-13cm kur u mbollën,  
 bënë përpjetë më shumë se mesatarja e një trupinjeriu të këtyre  
 anëve,pas dhjetë ditësh nga hedhja e pluhurit të bardhë.Më  
 tepër morri zgjatje nëndora,por edhe shuplaka e gishtat

muarrën përmasa gjigandeske. Në javën e dytë e të tretë të rritjes, aty ku mbaronte nëndora ose parakrahu, ngjitur me shuplakën egzistuese, mbinë e morrën formë edhe dy-tre shuplaka të tjera, me gishta, me mollëzagishtash e thonj... Si një çelje gjembgomari mbi atë parakrah të stërzgatur, 15-20 gishta ngjasonin me të pangjarën deri atëherë...

Ato 4-5 shuplaka, të rritura pranë njëra-tjetrës, benin disa lëvizje gishtash si heroglifë pa përkthim; zgjatëshin, shtyhëshin e tërhiqëshin, deri në këputje thonjsh e gjakosje, me një leng të verdhë, që mpiksej menjëherë e nxihej...

Çudia ishte se në këtë pyllduarsh nuk afrohëshin jo zogjtë, por as mizat. Syri mund të të shihte dy-tre lëkurë gjarpëri, që shtrihëshin të pajeta, herë-herë të ngatëruara me rrënjëferrash të thara.

Ndoshta kish ardhur koha që të behej diçka me ato duar?!  
 Të shkuleshin?  
 Të pritëshin ?  
 Apo të lidhëshin?  
 Të benin diçka...  
 Apo të mos benin asgjë ....

### *Qielli i habitur*

*Dhe qielli shihte i habitur...*

Mbi atë copë tokë, ai rrinte i heshtur dhe provonte lashtësinë e kujtesës. Kujtonte gjithë historinë e jetës njerëzore me dashuri e urrejtje, me dasma, lindje e vdekje... me luftra e luftra... me vrasje e vrasje...

Shihte i heshtur qielli dhe pyeste veten: "Këta njerëz mbajnë më tepër dashuri apo urrejtje?! Jetën dashuria e ka lindur. Dhe në këtë copëvend me këtë emër, njerëzit dashurojnë

si të çmendur...Në fillimet e jetës,i pari i këtij vendi ra në dashuri me vetë Perëndinë e Dashurisë...Nën dritën e hënës e të yjeve ,ngjitej pas gërshetave të saj në shtëpinë e Perëndisë.

Edhe Perëndisë ai ia mësoi dashurinë...I mësoi dashurinë tokësore,dashurinë e njeriut, që bëhej ndryshe...Dashuria e atij njeriu pushtoi edhe zemrën e Perëndisë së Dashurisë..E.ku ka ndodhur kjo në tjetër vend ?!

Ç'zemër kanë këta njerëz ,që magjepsin edhe Perëndinë?!... Me dashurinë e tyre asnjë nuk mund të matet.Ata i ka çmendur dashuria dhe e kanë çmendur dashurinë...

Më tepër dashuri kanë këta njerëz?!

Po urrejtje?

Urrejtja e tyre është e habitshme.Edhe urrejtjen të çmendur e kanë. Dhe dashurinë e tyre e urrejnë...

Po këto duar kush i shpiku?! Nuk mund të mbillen duar e të rriten duar ! Miliona yjet e mij nuk kanë parë të mbillen duar... Vetëm në këtë vend mbillen e rriten duar njerëzish..."

Habitej qielli dhe pyeste veten me pëshpërima yjesh...

### ***E gjithë jeta e Hotelierit ishte ëndërr...***

***E*** gjithë jeta e Hotelierit ishte si një ëndërr... Kur ishte akoma djalë i ri,bëri të pamundurën për të vazhduar studimet e larta.Në vitet e rinisë së tij shkolla e lartë ishte jo vetëm pasion e talent,por edhe guxim e marrëzi.

Të mësuarit nuk e ndante dot nga të kënduarit e shpirtit.

Pasi mbaroi shkollën e pesëmbëdhjetë vjeçarëve iu ngjit një të afërmi të familjes,që bënte kurbet dhe fitoi të drejtën e studimeve në një Shkollë Arti.Punonte e mësonte dhe në gjithë studentët dallohej.Mbaroi universitetin,mbrojti dhe Doktoratën duke fituar medalje ari...

Mësimi i gjuhëve të huaja iu bë pasion. Gati, gjithë gjuhët e folura e të shkruara u benë pronë e trurit të tij.

Trurin e mbushi me dije e zemrën me dashuri. Gjithë dashurinë e shpirtit ia fali një vajzë, që siç thoshte një miku i tij: "e dashuronte në gjithë gjuhët e botës dhe askush nuk mund ta donte si ai." ... Por atë vullkan dashurie nuk mund ta përballonte dot shoqja e klasës me sytë prej qielli. Atij i ndizej gjaku edhe në gjumë. Ajo lexonte libra dhe dashuronte. Bënte më shumë dashurilibrash se dashurishpirti... Ai i mbushte librat me shpirtin e tij. Ajo i thante faqet e librave, për të dashuruar. Po të shkëputej nga romanet e poezitë shpirti i saj zverdhej e vyshkej.

*"Se s' dashuronja as unë as ti,*

*Po dashuronte dashuria:*

*Një dashuri-Një fshehtësi*

*Më e fshehur se sa fshehtësia..."* i këndonte ai këngë nga shpirti i tij, por kënga do shpirtkënge që të dëgjohej.

Ai mbeti i dashuruar në gjithë jetën e tij endërr...

Dhe kur çantat e zeza zbrisnin e ngjisnin shkallët e hotelit ai shihte endërr:

*"...ecte mbi një ujë të paanë. Nuk lundronte as me anije e as me varkë... Ecte mbi dallgë. I zbatthur... I veshur me kostum e i zbatthur... As nuk lagej, as nuk mbytej... Ecte, si të ishte në një udhë, ku dhe gurët i njihnin çapat e tij.*

*Nuk ishin të gurta, por të ujta ato pllaka të bardha, që i rrëshqisnin nënë këmbë... Ishin shkumëdallge si të liqerit të tij... Dhe ai ecte lirshëm me kënaqësinë e një vallzimi të mezipritur...*

*He! Para syve i doli një shishe e qelqtë, që dhe ajo vallzonte me rritmin e vallzimit të tij... Herë i afrohej e herë i largohej... E arriti, e mori në duar. Pse ishte bosh? Dikur e kish groposur me dy enra brenda... Si u gjend këtu, në mes të dallgëve?! Mos është mbytur mali e shishja ka dalë mbi dallgë?! Mali dhe*

dyemrat janë mbytur ?!...E flaku tej tërë inat shishen bosh.Humbi.U zhyt e humbi...Qau.Pse qau?!...

Dallgët qeshnin me qarjen e tij...

U mbyt?

Si ?

I iku fryma...

Aty ku u zhyt shishja,befas,u shfaq një kishë.Me kupola,kryqe e këmbana...Ai,doli nga ujët e u gjend brenda kishës...Nuk kishte më as ujë,as dallgë,por ikona,qirinj të ndezur e sha-nëndanë të ndritshëm...Si të gjitha kishat që ai i njëjthe...Si Shën Spiridhoni,Shëne Premtja,Shën Thanasi,Shën Mëria e Shëndëlliu në vendlindjen e tij...

O Perëndi! Në mes të sallës u shfaq AJO,vasha e tij. E veshur me rrobat e nusërisë...Afrohej drejt tij.Qeshte.Qeshte si gjithmonë.Ai nuk e shihte veten,por i dukej se qeshte dhe ai,apo i kish mbaruar e qeshura ?! Edhe ai ndoshta qeshte tek sytë e saj ?!

Ajo iu afrua.Mu tek sytë.Mu tek buzët e tij.Ai tashti do e puthte...ç'të bente? Do e puthte pa tjetër...Po t'i shtrinte buzët arrinin deri tek buzët e saj...I shtriu buzët,që i dridheshin,por...befas u dëgjua zëri i priftit me fjalëPerëndie,për t'u venë kurorë....Ç'është kjo kurorë mbi kokën e saj?! Kurorë me thurrje duarsh...Nga duart e çantave të zeza...Po prifti mos ishte nga ata?! Jo,jo,ishte i gjithi prift.. Ku e kish gjetur atë kurorëduarsh,që e vuri mbi ballin e saj ?! Ndjeu disa kërcitje këmbësh...

Endrra iu zbardh,një çast,si një copë filmi i djegur...Por përsëri truri nisi të shfaqte...Hyri në endërr:

".... Një kalë vërtitej me vrap në një lëmë...Lëmi nuk kishte as grurë,as thekër,por kocka...Kocka njerëzish. Kalit nuk i mbaronte vrap duke shkelur mbi kafka e gjokse,mbi duar e këmbë të pamishta...Kockat thyheshin me kërcitje,nën patkonjtë e kalit.Ndonjë kafë rrotullohej e shkiste për t'u



*shpëtuar patkonjve shtypës,por e shtynin kafkat e tjera dhe ajo përfundonte nën patkonj...*

*Mos ishin dhe kockat e tij në atë lëmshkockash?! Ai e kish mishin mbi kocka,apo kish mbetur kockalakuriq?!"E shtyu tutje frikën,një çast,çeli sytë për të parë të vërtetën e ëndrrës...Pastaj i mbylli përsëri se mos i dilte ëndrra nga drita e syve:*

*"... lëmin e kockave e mbuloi një muzikë e pa dëgjuar ndonjëherë,ose e harruar në dëgjimin e saj...Ishte mes dëgjimës e ulërimës me një ritëm goditës...Kali vallzonte,në shirje kockash,në ritmin e asaj kënge të pajjalë,që kish mbetur vetëm muzikë....Çuditërisht,ko - ckat bashkoheshin e formonin skelete trupash,që ngriheshin e vallëzonin nën ritmin e muzikës...Vallëzonin e vallëzonin e pastaj binin mbi njëri-tjetrin, për t'u shlodhur të shtrirë,apo për të vazhduar vallzimin siç dinin vetëm skeletet ?!..."*

Kali herë humbte e herë dukej në rrotullimet pambarim...Ai kënaqej me këto pamje ëndrre. Donte ta shihte dhe ai veten mes atyre skeleteve,në atë vallëzim të çmendur...Të vallzonte me skeletin e asaj që donte tërë jetën...Ta zhvishnin mishin nga kockat e të mbeteshin edhe ata lakuriq-skeletë...Ashtu do të ishin të lirë të benin ç'të donin në atë botë skeletesh...

*Po sikur të mbeteshin gjithë jetën ashtu,skeletë-lakuriq?! E,mirë le të mbeteshin...Edhe kështu,me mish e rroba veshur,jeta dukej e shëmtuar e pa kuptim...Ja,këta skeletë vallëzojnë e gëzojnë edhe në këtë lëmëvdekjeje...Donte dhe ai ta shihte veten në atë vallëzim,por vetja i mungonte,siç i kish nunguar gjithë jetën dhe dashuria e tij e vetëhumbur..."*

Doli nga ëndrra vetëm kur ndjeu zërin e Djaloshit të Dashuruar.Pa u dukur akoma tek porta e hotelit vinte kënga e tij e zakonshme:

*"...Syzezë e vetulla për,*

*do vij sonte natënë..."*

Apo ajo kënga e re që ia kish kënduar herën e fundit:

*"...Të desha moj qëne,  
më deshe ç'më bëre!  
Dhe palcën ma trete,  
tërë natën,gjithë netëve...  
Të desha moj qëne,"...*

Këto vargje,sa i kish dëgjuar Plaku i këndonte me vete dhe vetja i dukej ndryshe,sikur fluturonte me *Yllin e Zembrës...*

"Dashuria i marros të mençurit e mënçuron të marrët"-i tha vetes dhe s'i erdhi mirë që i erdhën ato fjalë...

Djaloshi i Dashuruar ishte trim e i bukur.Ai e bënte të bukur edhe këngën kur e këndonte,edhe fjalën kur e fliste,edhe dashurinë kur e dashuronte...

Hotelieri Plak e donte dhe e respektonte.Ai sikur ishte gjysma e tij,që i mungonte.Dhe atë gjysmëvete ai mezi e priste....

Por kësaj here zëri i Djaloshit i erdhi pa këngë. Kjo nuk kishte ndodhur kurrë.Edhe kur Djaloshi ishte i mërzitur apo me inat përsëri me këngë e shkelte pragun e hotelit.

Si mund t'i dilje para atij plaku të mirë pa këngë?!

Po atë mëngjes ku e kish këngën?! Pse nuk e këndonte?!...

-Shkulu se do të ikim!-dhe Djaloshi e mbërtheu nga krahu si pë t'i dhenë më tepër veprim fjalëve të tij.

-Ç'është?...Ç'ke kështu?...Të ka ndodhur gjë?-pyeti Plaku i hutuar...

-S'më ka ndodhur gjë jo,por kam hallin tënd.

-E ç'hall?! Unë jam mirë e bukur-foli Plaku duke mos i menduar fjalët e thëna. "*Mirë e bukur*" i kish mbetur në mend nga një lexim i kohës së djalërisë dhe truri e nxirrte nga arshiva edhe kur ai nuk e kërkonte...

-Ta tregova historinë e duarve të mbjella atë mëngjes?

-E,ma tregove.

-Ato duar do të të mbysin ty....

Do të të venë gishtat në fyt,kështu dhe s'ka më "syzezë e vetulla për" pastaj...

- Ha,ha,ha – qeshi Plaku-ç'më duan mua?! Nuk bëhet dasmë me mish kau...

-Epo je më i mençuri i Çmëdinës dhe truri ja grabitet,ja vritet...

Plaku heshti.Djaloshi nuk i lëshonte kot fjalët.Ato e kihin gjykimin brenda,prandaj duheshin vlerësuar.Ato puqeshin edhe me gjykimin e tij,por fjalët " *shkulu se do të ikim*" i dukeshin si pa kokë.

-Ku do të vemi?-pyeti Plaku si për të dalë nga vetja.

-Ku të na shpien këmbët,vetëm të ikim nga ky vend i mallkuar,nuk e shikon se ç'po bëhet?! Këtu çdo gjë u bë e çmendur,e frikshme...

Xherahu....

Uërima....

Ilaçi i bardhë....

Çantat e zeza....

Duarte mbjella....

Kolera....

Shejtani pa brirë...

Të gjitha këtu janë mbledhur...Nuk ka më dashuri e këngë,ka vetëm urrejtje...Urrejtje që të përpin si flaka.

-Të ka hyrë frika në palcë.Unë të njoh për trim.Ikja është për frikacakët.

-Trimërinë ta bësh për jetën e jo për vdekjen,ti vetë më ke thënë-ia ktheu Djaloshi dhe vazhdoi-do e shpie trimërinë aty ku do të hyjë në punë,tashti do rrëmbej"Syzezën" e do iki.Edhe ti do të vish me ne.Kjo është e vendosur.

Plaku u vonua ca në përgjigje duke përtypur nëpër mend atë thënie jo të rastit:"*do e shpie trimërinë aty ku do të hyjë në punë*"...Kush e di se ç'i ka shkrepur?Nuk them kot unë që është trim e i zgjuar!-mendoi plaku i kënaqur dhe pastaj foli:

- Unë këtu do e sos jetën.Nuk ndahem nga hoteli,as nga Çmendina nuk ndahem dot.Te ky hotel kam pritur e përcjellë shumë njerëz,me zemër e pa zemër...dhe kolera të vijë unë do e pres e prapë do e përcjell...E unë këtu do të jem,kështu siç jam,-u kapërcye e iu zbardh balli.,pastaj vazhdoi me më shumë dritë në sy- edhe ti me “*Syzezën*”tënde,këtu do të më gjeni kur të ktheheni.Do të shkulet e keqja e ju prapë do të vini e mua këtu do të më gjeni, te kjo dhomë e vogël.Do t’ju pres.Nuk vdes.

Hotelierit iu njomën faqet nga lotët...

Edhe Djaloshi u përlot në krahët e Plakut.

Thanë edhe disa fjalëmalli dhe u ndanë...

“*Syzezë e vetulla pëz..*”ia morri këngës Plaku me zërin që i dridhej...

“*Nga muri do ngjitem,/ta di që të vritemë...*” vazhdoi Djaloshi dhe e përshëndeti me dorë në ikje...

### ***Kryekomandanti***

Si u rrokullisën ngjarjet,historia e patkonjëve mbeti në harresë dhe kërkuesit“*symprehtë e të pagojë*”,i shpëtuan marrëzisë së Xherahut.Kur kryetarët e grupeve do të paraqiteshin në pallat me patkonjtë e kalit,pallati ishte qorruar igjithi.Errësira kish pllakosur sytë e shërbëtorëve,rojave, sekretarëve e magjistarëve

Të gjithë nuk dinin nga të venin e ç’të bënin?...

Rojat e portës kryesore,nuk ishin në gjendje të kontrollonin kush hynte e kush dilte nga pallati.Shumica e nëpunësve të

pallatit, rrëmbyen ç'mund të rrëmbejnë dhe ikën pas këmbëve, tutje ku s'dihet, apo në shtëpitë e tyre...

I pari që e la pallatin ishte Kryekomandanti i Rojave. Ai, që hiqej si më besniku i Xherahut dhe, në bredhjet e detyrës, e shoqëronte kudo që shkelnin patkonjtë e kalit...

Kryekomandanti ishte i pafamilje e i panjeri. Thuhej se që lindur pranë shtëpisë ku që lindur Xherahu e që rritur me bukën e tyre. Shkollë nuk kishte bërë, por kish zgjarsinë e gjarpërit, që e mbante fshehur nën pllakat e trurit...

Kur ishin të vegjël ai e rrihte Xherahun. Edhe shpatullën e majtë ai ia kish nxjerrë nga vendi, sa e la me cen gjithë jetën. Kurrizi gjysmë i dalë dhe ecja e shtrembër i kishin hapur telashe në vitet e moshmartesës. I ishin prishur dy krushqi për qejf të asaj shpatulle, sa që kur u martua me Zonjushën me Sy të Kuq, e ardhur nga përtej kufijtë, të gjithë u çuditën. Ajo ishte trupsorkadhe dhe nga derë mbretërisë. E fshehta e asaj martese kurrë nuk u mësua... Kur Xherahu hypi në kalë e u bë Xherah, shokun e fëmijërisë nuk e harroi. U fol për shpirtmirësinë e Xherahut, siç u fol edhe për Zonjën me Sy të Kuq, sikur ajo e kish sjellë në pallat Kryekomandantin... Dhe në gjithë vitet e shërbimit, ai ia shpërbleu Zonjës mirësinë me gjithë fuqitë e tij trupore...

Ikja e Kryekomandantit nuk e tërboi Xherahun, siç pritej. Ai që ulërinte për hijgje, kur mori vesh dezertimin, foli pa ulërimë: "Tepër vonë, tepër vonë..." dhe, për çudi, nuk i mblodhi rojat e nuk caktoi komandant tjetër. Edhe për madamën Hi-Fi nuk u interesua se ç'bëhej në atë errësirë. Ishte aty, në dhomën e saj, apo kishte ikur dhe ajo me Kryekomandantin?

Askush nuk guxonte të fliste për Zonjën, por ata, që kishin mbetur në pallat, e dinin se ajo kishte ikur me njëherë pas thyerjeve të pasqyrave të fundit... Edhe portat e pallatit ajo i

kish hapur që kush të mundëte të ikte pa pllakosur të këqiat e tjera...Ajo i dinte të gjitha të vërtetat e atyre,që ndodhën dhe atyre,që do të ndodhnin...

### *Të ikurit e natës.*

**Q**ielli ishte i trazuar e pa yje....Retë,herë i hapnin udhë njëra-tjetrës e herë përplaseshin me njëra-tjetrën,si të mos shihnin udhën në atë qiell pa hënë e pa yje...

Nuk binte shi,por ndonjë vetëtimë e griste qiellin me shpejtësi,sa toka e përgjumur nuk mund ta shihte...Vetëm ndonjë gjëmimë e thellë dëgjohej s'dihej se nga? Era ,që luante me qiellin e me tokën,luante dhe me atë gjëmimë...

Ishte pasmesnatë apo paramesnatë?

Edhe këndezët, edhe qentë,edhe njerëzit heshtënin në gjumë,ose nuk ndihej fryma e jetës së tyre...Nga shtëpitë, rreth pallatit, vetëm macet e maçokët dilnin në vendtakimet e dashurisë duke ngatërruar stinët e muajt..

Udhët,që të shpinin për në pallat,nuk dukeshinAs porta e madhe e as kullat e rojave...Ato ishin e s'ishin njëherësh.Vetëm toka e ndjente peshën e tyre...

Në këtë natë,gati të shuar,një karocë me katër rrota e hiqnin zvarrë katër kuaj...Në ngarkesë ishin katër njerëz dhe katër baule të mëdha,të kyçura e të lidhura mirë me katër zinxhirë... Sikur i vidhte nata ato gjallesa dhe i fshihte diku...Për këtë vjedhjenate duheshin berë shumë gjera.Duheshin shuar dhe yjet...

Dhe era,që vinte vërdallë,nuk tregonte për ato gjallesa në ikje, me ato baule të rënda..

Edhe macet shtatë shpirtërat e tyre i mjaullinin për maçokët e as donin t'ia dinin për të ikurit e natës...

### *Trutredhurit*

Jeta kish venë maskën e kolerës dhe ish veshur me rrobat e vdekjes...Por njerëzit më tepër e mendonin vdekjen dhe kolerën se e jetonin.Po ta shihje ditën, brenda mureve të shtëpisë ose brenda oborrit,dukej një ditë e zakonshme.Edhe nata po ashtu.Veç po të dilje nga porta e shtëpisë e të merrje udhët e qytetit dita kthehej në fantazëm me veshjen e vdekjes dhe emërin e kolerës...Ç'të benin të shkretët njerëz?! Si të jetonin?! Me jetën në burg apo me vdekjen të lirë?!...

\* \* \*

Të gjithë flisnin për Xherahun e për kolerën e asnjë nuk guxonte t'i afrohej pallatit e të shihte se ç'bëhej? Edhe të ikurit si: shërbyesit,rojat,qejfdhënësit e qejfdhënëset,gjellëbërësit e therësit e bagëtive,nuk tregonin asgjë për pallatin.Heshtja e tyre ishte aq vuve sa kishte bllokuar edhe gjumin ku ,zakonisht,ata që flasin në gjumë,tregonin të vërtetën,që nuk mund ta flisnin ditën e të zgjuar.Ata e kontrollonin të folurit edhe në gjumë e jo kur ishin të zgjuar,që e mbanin gjuhën të mbërthyer prapa dhëmbëve.

Ishnjerëzit e pallatit dukeshin si të patru,ose trurin e kishin të kthyer nga ana tjetër,siç kthehen çorapet a brekët,që nga shpejtësia i veshin sëprapthi...Kjo sëprapthje truri i bënte ata,në pamje,të qetë e të zakonshëm,si gjithë njerëzit e tjerë të jashtëpallatit,bileedhemë normalë e më të zakonshëm...

Askush nuk mund ta shpjegonte këtë vuvëri...Jo vetëm nuk tregonin, për ato vitepallati,por hutoheshin të habitur,kur dëgjonin për bëmat e Xherahut me kalë apo të Zonjës me Kryekomandantin,apo,apo...

Një burrë u tërbua aq shumë me gruan e tij,që rrtinte si shushkë,kur ai e pyeste,sa e mbyti me duart e saj dhe pastaj vrau dhe veten,pa iu shuar inati...

-I ka lenë mëndja...

-E kanë nga ilaçi i Xherahut...

-Pse të tjerat i dijnë?Vetëm për pallatin janë çme ndur?!

-U kanë tredhur trutë dhe pikë.Nuk janë të çmendur!Pse kështu janë të çmendurit?!Kështu janë trutredhurit!...

Hidhnin lloj lloj mendime njerëzit,por secili e dinte se ajo që thoshte goja e tij nuk ishte e vërteta...

Fjala"trutredhur" u përhap në gjithë Çmendinën.Secili e përdorte si fjalë të re,të shpikur nga vetja.

Portat e pallatit kishin mbetur të shqyera.Rojet nuk dukeshin më,ku ishin parë për vite e sa vite me rradhë...Edhe njerëz, që të hynin e të dilnin, nuk dukeshin....Edhe raca e maceve,që lëpinin e lëpiheshin, ishin zhdukur a fshehur diku,brenda atyre mureve...

Vetëm tufa minjsh fluturues dilnin e hynin, në atë qorrllëk gjigand,duke përplasur zhapat e krahëve me një pllajq-plluqe të ftohtë e me llapat e veshëve në thithje tingujsh,si të ardhur nga një botë tjetër...Ata lakuriqnate ishin të vetmit gjallesa,që kërkonin të lidhnin akoma dybotët;atë që nuk dukej e nuk dihej me atë,që dukej e dihej dhe kërkonte të nesërmen...Por ato turma lakuriqe mbeteshin brenda portës së shqyer,duke e shtuar edhe më tepër enigmën e pallatit.Flisnin vetëm gjuhën e minjëve me "cng-cng e zng-zng",pa arritur dot në gjuhën e zogjve të qiellit...



### *E fshehta*

**B**injakët, kishin ditë që i vinin vërdallë pallatit.Ngjiteshin mbi kodrën përballë,nga ku dukej oborri e porta dhe kur nuk mundnin të shihnin mirë,ato që donin ata,hypni te kulla e rojave dhe prisnin me orë të tëra...Në atë pritje të vazhdueshme i thoshnin njëri-tjetrit me zë të ulët:

-Kush do ta zbulojë i pari ka të drejtën t'i verë emërin këlyshit,që do të pjellë Verdha-vuri kushtin binjaku i vogël.

-Babai tha se do t'i hedhim të gjithë këlyshët,se s'kemi me se t'i ushqejmë-foli binjaku i madh.

-Njërin do e mbajmë,atë më të bukurin,dhe emërin do ja ve unë...

-Po sikur të mos dojë babai?

-Le të mos dojë unë do e fsheh njërin.

-Nuk e sheh se ç'po bëhet?!Hallin e këlyshit kemi...

-Ooo,gjithë hallet e botës ty të kanë mbuluar,ç'na thënke?

-E,po këtu pse erdhëm,ë?!

- Të zbulojmë se ç'bën Xherahu .

-Mos na del dhe ai si patkonjtë?

-Ç'thua more?!Xherahu është i rëndësishëm,nuk është si patkonjtë...

-Edhe patkonjtë të Xherahut ishin e ata të huajt nuk ua varën fare...Do të bëheshim të pasur ne, me patkonj...

-Do ShënMëria të zbulojmë që nuk është ashtu si thuhet e të shikosh pastaj ti...Pastaj, ti mba qenin unë Xherahun.

-Përralla,përralla,kemi kaq ditë këtu,na u skuqën sytë nga vapa e nuk dimë se ç'do zbulojmë.

-Si?Pse nuk e di ti?

- Jo,pse ti e di?  
 -Do zbulojmë se nuk është ashtu si thuhet.  
 -Po si është?  
 -Atë do të zbulojmë...Pa hapi sytë andej nga porta e prapme se lëviz një...shshshht...  
 -Tpu! Qeni i Mëhallës së Përtejme.  
 -Pa shiko se ç'ka në gojë?  
 -Ta qëlluj me gur që ta lëshojë?!  
 -Mos bej asgjë pa urdhërin tim!  
 -Kush je ti,që na jep urdhër?! Apo do ndonjë të fortë e të t'i bëj dhëmbët përshesh?!-dhe e zuri vëllanë nga gjoksi.  
 -Unë jam më i madhi e unë komandoj.  
 -Avash ore se mos na biesh nga kulla...Unë vetë të lashë që të dilje i pari,ç'më duhej mua të lodhesha,kur gjeta një budalla dhe e vura përpara...  
 -Oo,ç'na bëre! Na iku qeni...  
 -Le të iki,ne e dimë ku do vejë,në Mëhallën e Përtejme..  
 Pse për qenin erdhëm këtu?!-vazhdoi binjaku i vogël pas një pauze.  
 -Po përse?Sikur ti e di.  
 -Si s'e di,do zbulojmë që nuk është ashtu si thuhet...  
 -Cila thuhet ?  
 -Thuhet se kali ka ngordhur.  
 -Ooo,unë kam dëgjuar për Xherahun...  
 -Ne do të zbulojmë se ja kali, ja Xherahu nuk ka ngordhur.  
 -E pastaj?  
 -Pastaj zbulimin do e shesim e do të bëhemi të pasur...  
 -E ke dëgjuar kako Xhafon si thotë?"Nuk ha kolera mur".  
 -Po gropa kot hapet,hë?...  
 -Që të gënjehen njerëzit e të tremben...  
 -E,pse të gënjehen e të tremben?!  
 -Se ashtu duhet.Nuk i di të gjitha ti.  
 -Ç'më çan kokën...Unë di më shumë se ti...

-Që kolera është gënjeshtër ti nuk e di.

-Se mos e di ti,kot shet mend.

-Edhe e di edhe do e zbulojmë...

-Do e zbuloj unë i pari dhe do t' i ve emrin këlyshit.

Binjaku i madh nuk foli.

Qeni i mëhallës së Përtejme u duk papë në oborr.

Gjuhën e mbante midid dy dhëmbëve shpues dhe bishtin e tërhiqte zvarrë...Pas ndonjë gjahu të majmë ai rëndohej e mezi ecte,siç po bënte tani në oborrrin e pallatit...Por në vend të shtrihej në ndonjë hije e t'ja këpuste gjumit,qeni erdhi një herë rrotull oborrrit sikur diç kërkonte dhe hyri në portën kryesore.

Binjakët sikur ta kishin vendosur qysh më parë,pa folur asnjë fjalë,zbritën nga kulla e u vunë pas bishtit të qenit...Lakuriqtë e natës fluturonin mbi kokat e tyre duke folur jo në gjuhën e zogjve,por në gjuhën e minjve:cng...cng...zng...zng...

Krrcc...krrcc...ckkrrr...kërcisnin copat e pasqyrave të thyera,nën këmbët e binjakëve...

Binjakët ishin aty tek të dhjetë vjetët e jetës dhe nuk e kishin mësuar akoma frikën e errësirës...Qysh të vegjël ishin futur nëpër shpella e guva mbas babait,në gjueti dhelprash e iriqësh. Sa më tutje ecnin,aq më e thellë bëhej errësira...Korridorët e dhomat e pallatit vetëm heshtënin...Nën këmbë u kërcisnin pasqyrat e thyera e mbi kokat e tyre fluturonin lakuriqtë e errësirës.Asgjë tjetër.

Gati të gjitha dhomat ishin derëshqyera.Ata,kudo që hynin,ia jepnin një vërshëllime::fiiuu...fiiuuu.

Sa e kishin mësuar vërshëllimën pa gishta,duke shtypur gjuhën nën dhëmbët e poshtëm.Binjaku i vogël e mësoi më shpejt,ndërsa i madhi nuk i bashkonte dot mirë:gjuhën,dhëmbët e buzën e poshtëme.I kishte buzët të trasha e nuk i bëhej zëri-zëvërshëllime. Tashti,gjithë qejf për jehonën,

që lëshonte vërshëllima e tyre në dhomat e pajeta,nuk pushonin së zhurmuari...

Djathtas u përplasën në një derë të mbyllur.Trokitën dhe vetëm trokitja u dëgjua.

-E gjetëm-fole binjaku i madh.

-Po qeni ku është?-pyeti binjaku i vogël.

Qeni u fërkua te këmbët si për t'u thenë:" ja ku jam".

Dybinjakët dhe qeni rrinin të heshtur përballë derës së mbyllur dhe donin të mendonin në heshtje:

"...Ç'far fshihej aty brenda? Xherahu,kali apo kolera?

Ish thenë se Xherahun dhe kalin i kish ngrënë kolera...

Pastaj kolera pse ishte mbyllur aty brenda?!Kolera që s'ka mëshirë për askënd,kë mëshironte?! Si? Vdekja djersinte, aty brenda,nga pamundësia e të ushqyerit?!

Në Çmendinë vetëm emëri i kolerës vinte vërdallë për gati një muaj...

Ç'benta Xherahu e kolera fshehur në atë pasdere?! Ishin të dy apo kishin ngrënë njeri-tjetrin ?!..."

Këto pyetje enigmë nuk i shkonin dot nëpër tru as binjakët as qeni. Ata vetëm heshtënin, aty pas derës së mbyllur,si të mbërthyer nga pamundësia...

### *Valixhja e rinisë*

*Ikja e Djaloshit të Dashuruar ishte e rëndë për Hotelierin Plak.Në misterin e asaj jete ai kishte mbetur krejt i vetëm.Me kë të këmbente dy fjalë? Hoteli i tij rrinte i shurdhër ose edhe më i shurdhër se ç'kishte qënë.Edhe dy vëllezërit e vegjël nuk ishin dukur më.Patkonjtë,që sollën për t'i shitur mbetën mbi sportel,të harruar edhe ata,të paparë e të pakërkuar nga askush... Si t'i shtynte ditët e netët?! I kish mbetur vetëm gjysma e vetes,ajo e plakura dhe e rrënuara nga vitet...*

Djaloshi,që i kujtonte rininë me ato vrulleshpirti tashti ishte larg...Vetëm kënga i kish mbetur brendaturit e nëpër buzë: "...syzezë e vetulla për,di vi sonte natënë".... E thoshte këngën dhe prapë mbetej vetëm.Edhe kënga sikur i ikte ,nga truri e nga buzët,pas udhës së Djaloshit...Edhe kënga e linte vetëm me gjysmën e tij të plakur..." njeriu ka moshën astronomike dhe atë shpirtërore"- mendoi.Po ai cilën jetonte? Vetëm moshën astronomike po jetonte! Po shpirti?Jetën e shpirtit ku e kishte?!

Iu kujtua valixhja e rinisë.

Atë valixhe dërrase e kish futur në fund të dollapit të rrobave dhe një jetë e kish lenë të mbyllur e të harruar...

Kish ardhur nga udhëtimi i tij i fundit ajo valixhe,kur bridhte nëpër aerodrome,në kërkim të dashurisë së humbur...

Ajo valixhe mbante brenda gjithë vitet jetëhumbur....

Po,ç'ju kujtua valixhja sonte?!

Hapja e saj do i ngjante çeljes së arkivolit të njeriut më të dashur...Dhe brenda atij arkivoli nuk do të gjente më atë fytyrë të gjumur e atë trup të lastartë,por një grumbull me kocka të frikshme...

Po ç'i ndriti në mendje sonte,që ta hapte atë valixhe të harruar mbi një gjysmëshekul?!...

E nxorri, me kujdes, nga dollapi dhe e vendosi mbi tavolinë. Duart i dridheshin e në gjoks diç i lëvizte drejt fytit...Kapaku i valixhes kërciti si një gojë fëmije i vdekur. (Si i erdhi ndër mend kjo përjasje,që asnjëherë nuk e kish përdorur brenda trurit të tij?!) U ngrit, me një herë,sikur një forcë e padukshme e shtyti nga brenda...Ai mbeti disa çaste symbyllur e i pafrymë,si në pritje të një shpërthimi...Fytyra e shuplakat e duarve iu bulëzuan nga djersa e ftohtë edhe pse buzët e brendasytë i digjinin...Ndjente sikur truri i rrotullohej me shpejtësi,sa nuk i shfaqte asnjë pamje të dukshme,vetëm i merreshin mendtë,si atëhere kur beri fluturimin e parë...E kish harruar atë rrotullim truri...

U mbajt nga gjunjët e tij me të dyja duart deri sa truri e mbaroi rrotullimin. Kur ngriti kapakët e syve, pa kapakun e valixhes së hapur dhe brenda saj, disa sende të rrëmuja, që nuk mund t'i përcaktonte me të parët e parë... Pasi e mbloodhi disi veten nisi të lëvizë sendet brenda valixhes... I kaloi rrëmbimthi nëpër duar me një mospritje, të çuditshme për karakterin e tij njëjetëpritës.

Fletore e blloqe fletëzverdhur... dy libra me poezi... një stilograf bojëtharë e një çantë dore zinxhirmbyllur... Me gishtat, që i dridheshin shfletoi bllokun. Blloku ish mbushur me vjersha të shkruara me stilograf. Nisi të lexojë:

*"...Syri i bukur që t'u mvrenjt,  
Syri yt që më lëndon,  
Do më lerë a von a shpejt?!  
Do më lerë a shpejt a von?!"*

Shfleton përsëri:

*"Një çast me ty dhe lumturohem,  
Një çast pa ty dhe s'jam një vit.  
Tek syri yt kur nuk shikohem,  
Vjen dallgë e shpirtit dhe më mbyt..."*

Dhe në një fletë tjetër:

*"...E do mbetem përnjëmënd,  
Varfanjak si mbret pa fron.  
Mbretëresha që më çmënd,  
Do më lerë a shpejt a von...."*

E ,kështu shfletonte e shfletonte duke lexuar me zë nga dy-tre vargje në çdo faqe të shkruar.

Dhe në fund të bllokut lexoi:

*"Pritja për ty është varr i hapur,  
Aty unë jam, më nxirr një çast,  
Ose mbulomë njëherë e mirë,  
Mbyll derën e zemrës, më ler jashtë..."*

Nëpër ato vargje i shfaqej e i zhdukej Ajo.Ajo,që e kish vrarë gjer në pritje, gjer në mos-harrim...Ai brodhi në aerodromet e dashurisë,duke kërkuar e kërkuar e së fundi u kthye në Çmendinën e tij,i lodhur e i gjysmuar...

*Ylli i zemrës*, vallëzonte në vargjet e tij ,si në një *valle yjesh*,që nuk shuhej kurrë e gjithmonë mbetej larg...

*"Vallja e yjeve"* kish shkruar në cepin e bllokut dhe e kish futur në një kornizë të zezë me stilografin,që tashti heshtëte bojëtharë...

Pse e kish kornizuar ashtu?Edhe yjet i kish futur në një kornizë vdekjeje?!

I lexoi edhe një herë,edhe një herë tjetër vjershat dhe brenda gjoksit ndjeu lëvizje,hedhje,shtytje,shqyerje...

Ndjehej, në atë gjendja frymëzimi, si në vitet e djalërisë.

Sikur nuk po i lexonte,por i shkruante, atë çast, me frymëzim të pa përmbajtur...

*" Ah,në hov të zemrës sime,*

*më s'të pata parë.*

*Të thërrita në mërgime,*

*Vetëm duke qarë...*

*" E dashur moj,ma mbaj ti zemrën,*

*dhe trurin e ndezur veç për ty,*

*Mos ma lër jetën të bëhet dhimbje..."*

I erdhën ndër mend këto vargje,që nuk i kishte shkruar akoma nëpër fletët e bllokut...Mori stilografin, për t'i shkruar,por ai ishte bojëtharë...

Po shpirti i tij?

Si?

Akoma këndonte shpirti i tij?

U tremb nga ky frymëzim i fshehur,diku i harruar.

Çudi,si shpërthyen nga burgu i gjoksit ato vargje?!

Çfarë po ndodhte?!...

Çantën e vogël,që ishte brenda valixhes,nuk e hapi.Nuk donte të prishte atë q i e l l p o e t i k, që mbante brenda gjoksit...Edhe trurin e tij nuk e pranoi të hynte në atë qiellshpirti.

### O i i.....

*Të tërhequr nga dashuria e të shtyrë nga urejtja,Djaloshi i Dashuruar e Syzezë e Vetullapë,si mijëra e mijëra të tjerë,ikën nga Çmendina,nga toka e nga deti...  
Ikën...*

Një anije e vogël,që më tepër i ngjasonte një varke me motor,ishte mbushur plot e përplot me ikës të moshave të ndryshme...Nëna me fëmijë në gji,pleq e gra,vajza e djam,me nga një trastë në krahë,apo pa trastë fare,kishin marrë udhën e ikjes...Të thoshje 100 ishin pak.Numrin e vërtetë mund ta dinte vetëm një mjekërosh,që mblidhte paratë në çdo udhëdeti,për në brigjet e atij vendi fqinj,që për njëmilion jetë,është gjendur përballë Çmëdinës...Banorët e të dy vendeve jepnin e merrnin.Bënin tregëti e bënin luftra .Njerëzit më shumë janë vrarë mes tyre për qejf të të parëve.Inatoseshin mbretërit e vriteshin njerëzit...Kur mbretërit e pushonin inatin e hajdutërinë,fqinjët e dy brigjeve nisnin udhën e detit për të rritur jetën e tyre...

Njerëzit janë vrarë më shumë për qejf të të parëve.Dhe qejfi i mbretërve është gjithmonë i çmendur...

Deti ishte i trazuar....

Dielli u zhyt në fund të detit,si për të ndriçuar të mbyturit e gjithëshekujve e për të shpëtuar për disa orë nga çmenditë e mbitokës...Era frynte nga të gjitha anët.Dallgët ngriheshin e uleshin e ngriheshin prapë...Errësira kish mbuluar edhe detin,edhe anijen,edhe të ikurit...



Nga bashi në qiç,në gjithë gjatësinë e anijes,njerëzit rrinin më shumë në këmbë se ulur.Vetëm ndonjë ishte ulur mbi motor,apo rrinte i mbështetur në pjesët e brendshme të bordit...Dallgët ngriheshin e përplaseshin mbi koka njerëzish e ngriheshin prapë...Era nuk kishte drejtim...Anija bënte udhë, andej, nga deti ishte më i thellë e më i nxirrosur,me një heshtje të frikshme...

Në fillim u dëgjuan disa klithma nënash,sharje e qarje foshnjash,pastaj s'pipëtiu më zë njeriu.Ato qenie të gjalla i kishin harruar edhe lutjet,edhemallkimet,edhesharjet... Dëgjohej vetëm era frymëzënëse dhe dallgët goditëse...

Djaloshi e Syzeza ishin ulur,diku andej nga fundi,mbi gjunjë të njëri-tjetrit.Të lagur gjer nën lëkurë e të goditur nga era ndjenin

sikur deti u kish hyrë brenda trupit e i përplaste s'dihej ku?...

Timonieri bënte sikur e drejtonte timonin,por m'ç tepër kërkonte të mbahej pas asaj rrote me brirë...

U dëgjua një zë:"Të kthehemi se do të mbytemi të gjithë!..."

" Ku të kthehemi...tek ne ka veshur çizme dhe gjarpëri,na helmon dhe në ëndërr...", - u dëgjua një zë.Të tjerët nuk folën,por e mendonin, pranueshëm, thirrjen e atij zëri:"...ku të kthehemi...tek ne ka veshur çizme dhe gjarpëri...".Këto fjalë rëndonin më shumë se të gjitha vjedhjet,vrasjet,djegiet, poshtëritë,kurvëritë,pabesitë...Dhe ata fatin e jetës ia linin Zotit,që diku ishte mbi atë qiell të pistë...Djaloshi hodhi nëpër mend Hotelierin.Të thënat e tij gjendeshin kudo,edhe në këtë anije-lodër,te këta njerëz të pafatë..." Më mirë që nuk erdhi në këtë lojë me vdekjen",por nuk e mbaroi dot mendimin.Një goditje e fuqishme dhe gjithçka u përmbys.

Anija,njerëzit dhe qielli i pistë..."ooouuuu na vranë...ooiiiiii na mbytën....".Copa fjalësh...Klithma...Dy-tre zanore ulëritëse...Dhe asgjë më.Anija,në 50-60 rrahjezemëre,u zhyt nën ujë bashkë me jetën e njerëzve...

Djaloshi bënte të kapte gërshetat e Syzezës, por ato gjarpëronin pas trupit të saj, në mbyetje të përbashkët... Dhe ai po mbytej pas saj... E mbloodhi veten dhe lëvizi duar e këmbë andej nga dukej një qiridrite... Trupi i tij i fuqishëm, në atë përmbysje dallgësh, i ngjante një delfini... Notoi e notoi deri sa deti i mbloodhi dallgët brenda gjoksit... E arriti atë dritëqiriu akoma pa u shuar...

Ndodhi mbytja e madhe. Sa e kishin arritur atë dritëqiriu?! Dielli akoma nuk po e ndriste mbitokën... Mos i ndriste vdekjes, që të numëronte të mbyturit?!... Po edhe vdekja ishte e çuditur: "Kush i mbyti gjithë këta njerëz?"... " Ç'të bëj me gjithë këta të mbytur?!..." - pyeste veten vdekja.

Funddeti mori një pamje rembrandeske..... Anija, si e shqyer nga tufaduarsh të padukshme 1000-gishtrinjshe, e kish humbur pamjen e qënies mbi dallgë.

Ishin të paformë: bashi, kiçi, gabina, motorri, timoni dhe aparatet e tjerë të drejtimit...

Thyerje, shqyerje, këputje, ndarje, çdo gjë e pa fytyrë. Një pamje e pa parë... Por njerëzit e bënin edhe më të paparë atë pamje funddeti... Edhe peshqit, të trembur e të hutuar, nuk guxonin të afroheshin... Dy trupa, gjysmë të lakuriqtë, ishin mpleksur me njëri-tjetrin, në një zhveshje të detyruar...

Një fëmijë, i mbërthyer pas gjoksit të nënës, thithte jetë a vdekje nga ata gjinj?... Një plak i plakur, kishte mbetur i shtrirë mbi shpinë, me dorën e majtë nën kokë e me gjuhën e zgjatur nën mustaqe, si i dehur nga qejfi, të tallej me botën e sipërdetit...

Kishte trupa të përmbysur mbi gjunjë si në një falje të përtej jetës... Apo trupa të harkuar si në valle të pasosur...

Vetëm Syzezë e Vetullapë nuk dukej kund... Ajo i mungonte asaj tabloje rrëqethëse. Mos vallë edhe në botën e iëndetit, ndonjë i çmendur e kish grabitur bukurinë e aj?!... Apo e kish rrëmbyer dielli dhe e kishte fshehur, për ta narrë me vete, në lindjen e nesërme?!... Apo e Bukura e

Detit,e marruar nga bukuria e Syzezës,e kish mbyllur në Burgun e Bukurive, për të mos u parë më kurrë?!...  
.....?

### *Kurorat e vdekjes*

**Kush** nuk e kishte venë kurorëne vdekjes mbi portë?!...  
Të humbur me jetë e me vdekje.Më shumë pa varre se me varre...Të parët ishin grupi i të rinjve,katër djem e tre vajza.I arratisi gjer në humbje ilaçi i bardhë...I kërkuan baballarët e nuk i gjetën dot...I qanë nënat,po ku t'i mbillnin lotët e shpirtit?! Varret ishin pa emër...

Dhe lulet i vinin mbi portat e shtëpive.Një traditë e re e dhimbjes së njerëzve...

Pastaj të ikur të tjerë...

Të humbur të tjerë...

Të vdekur të tjerë...

Por mbigjëma ishte anija e mbytur...

Sa njerëz u hutuan nga dhimbja dhe mosshpjegimi i mbigjëmës?!

Kush i mbyti?!

Qysh kur ishte shpikur ky vend,kurrëherë,deti nuk kishte gëlltitur,në një gojë,kaq jetë njerëzish!...

As kur tregëtohej.

As kur vidhej....

As kur luftohej....

Kush i mbyti?!...

Kjo pyetje ishte gozhdë në trurin e sejcilit.Pyesnin njerëzit e nuk e gjenin dot përgjigjen.Ata akuzonin,shanin,pështynin,kafshonin buzën e poshtme,kërcisnin gishtrinjtë,pinin duhan të fortë,e harronin lotin,që u rrokullisej nga syri,...dhe prapë pyesnin:nga erdhi kjo e keqe?!...

Pastaj: Xherahu, ... ilaçi i bardhë, ... ulërima e hingëllima, ... pleqtë e aziles, ... pallati i qorruar, ... patkonjtë, ... doraci i mbytur, ... çantat e zeza, ... duarte e mbjella, ... ujku i ngordhur, ... karroca me katër kuaj, ... katër baulet e mëdha e të lidhura me katër zinxhirë, ... kolera, ... madamë Hi-Fi... Dhe prapë pyesnin njerëzit: Nga na erdhi kjo e keqe?!...

Kush na ka mallkuar?!...

\* ! \*

## FJALE GAZETASH...

Gazetat e mëngjesit e të mbremjes hidhnin e prisnin të ndodhurat e të pandodhurat dhe njerëzit i lexonin si të babëzitur...

Një gazetë: “...Asnjë njeri nuk ka të drejtë t'i shfrytëzoi kafshët për tu zbavitur apo për synime të tjera,që bien ndesh me të drejtat e kafshëve...”.

Një gazetë tjetër: “...Tiran dinak.Kontakti me të është si ai i një gjarpëri të ndotur...Ai ta ben borxh për çdo minutë që duhet ose të shahesh ose të rrihesh ose të vritesh me të...Eshhtë njeri pa din e pa iman dhe për hir të ambicjes së tij,është i zoti të kalojë edhe përmbi trupin e njerëzve të tij të shtrenjtë...”.

Një gazetë tjetër: “...Njerëzit e fortë,mbinjerëzit fitojnë ndërgje – gjen e një kafshe grabitqare.Këta përbindështa të mbushur me gëzim,mund të kthehen nga një orgji e frikshme vrasësish,djegiesh,çnderimesh e torturash,me të njëjtin gëzim,sikur të ishin kënaqur në një potere studentësh...”.

Një gazetë tjetër: “...Revoltë në begdet:Taksa mbi kripën. Dy gjera janë të sigurta për njeriun: Taksa dhe vdekja...”.

Edhe një gazetë: “...Bota ka 2869 milion meshkuj dhe 2823 milion femra...Nga SIDA kanë vdekur 16 milion njerëz...Nga e kanë orgjinën fjalët:Grabit,sundim,llahtarë?”

Në një vend të dukshëm,nën portretin e saj:

*“... Në moshën 36 vjeçare,u vra aksidentalisht:  
Bashkëshortja pa dashuri.....Ylli i modës....Ambasadorja  
vullnetare e dhimbjes njerëzore....*

**“... Ti ishe shekulli që vbinte,  
Të vrau shekulli që shkoi....”.**

Shkruanin e shkruanin gazetat e mëngjesit e të mbremjes....



## *Pjesa e dytë*

### *Baulet e rënda*

Shiu binte për qejf të vet...Dielli më shumë digjte se ndriste...Stinët ngatërroheshin me njëra-tjetrën,në një vrap të çmendur,duke u shtyrë e zhvatur,duke ndërhyrë brutalisht deri në shpërfytyrim moti...

*"Natyra i çmendi njerëzit apo njerëzit e çmendën natyrën?...Po çantat misterioze e ata njerëzitë e heshtur ku humbën?Në qiell nuk u dukën më aeroplanët e tyre. Ose qielli nuk i beri më të dukur për sytë e veshët e njerëzve...Ose njerëzit nuk kanë më sy e veshë për të ndërë ikjen e tyre...Natyra i çmendi njerëzit apo njerëzit e çmendën natyrën?!...Duket sikur asgjë nuk krijohet,vetëm prishet...Edhe dita nuk e krijon më ditën,as nata nuk e krijon më natën...Duket sikur çdo gjë është lidhur me zinxhirët e vdekjes ...E gjithë Çmendina i ngjet një anije të mbytur.Eshtë mbytur edhe nderi...Edhe dashuria...Edhe shpresa...Njerëzit marrin frymë si të mbetur prapa jetës ...Mbahen mbas varreve e mbas gurit të portës ... Nuk di i ziu njeri ç'të bëjë me jetën e vet....Eeh!*

*Po ata që erdhën nga qielli,si re karkalecash, nga ikën? He,dreqi i mori,aty më mbeti mendja...Por edhe dreqi nuk mund të zhduket kështu...Pastaj,ata ishin të bukur,tamam njerëz ,si të gjithë njerëzit...*

*Le që edhe shejtanët tashti nuk janë më me brirë.Edhe djalli ka marrë fytyrë njeriu,ose kjo ka qenë fytyra e vërtetë e djallit,por ne i benim me brirë e të shëmtuar...Nuk di i ziu njeri kë ka përballë,njeriun apo djallin?!...*

*Po Xherahu,njeri i shejtanosur është,apo shejtan i njerëzuar?E,ku i dihet? Të zestë njerëz kanë një vit që po hapin atë gropën...Thonë se do e bëjnë 50 metër të thellë dhe të gjerë po aq...E,ç'do fusin brenda?!Ku janë Xherahu me kalin?!...Po kolera?U rropatën të zestë njerëz...Eeh!...Po sikur të mbetet, ashtu gojë hapur gjithë jetën, ajo gropë?!Apo nuk është mu në mes të vendit?!...Eh,të shkretët njerëz,s'dijnë ç'të mendojnë e ç'të bejnë me mendjen e tyre?!...Po Zonja?Humbi pa nam e pa nishan...Edhe ikja e saj është mister...Në mes të errësirës,kur vetëm kuajt mund ta shihnin udhën,por nuk i shpëton gjë këtij njeriu.Edhe kur s'e sheh,do e shohë pa tjetër! Edhe kur nuk e dëgjon,do e dëgjojë pa tjetër! Këtu,është thenë e është berë aq shumë,sa nuk i kam kënduar në gjithë librat e në gjithë jetën...Po ato katër baulet?!Të gjithë e dijnë e prapë pyesin:ç'kishin ato baule brenda?!...Edhe unë e di e prapë pyes.Këtu,njerëzit pyesin më shumë për ato që dijnë...Këtu sitet si mielli, mënçuria dhe marrëzia...Në gjithë botën nuk gjen si ne.Na thonë të çmendur.E,si mund të na thonë ndryshe? Po sikur të na flisnin budallikë?...Jo,jo,budallikët janë të pamend...Atyre s'u është mbushur kupa e mendjes kurrë,kurse të çmendurve,ju është mbushur e u është derdhur...Hehehe...Po qesh vetëm si i marrë...Po dhe të marrët e mbjellin nga një lule.E ujin,e rrisin...Po Xherahu?Nuk ka qenë i çmendur se nuk ka mbjellë asnjë lule...Në gjithë atë pallat,një vazo me lule nuk kishte...Vetëm pasqyra,pasqyra,pasqyra...Ai lulet i shkulte e i vriste...Jo!Xherahu nuk ka qenë i çmendur.Nuk e meriton të jetë i endur,se nuk ka mbjellë,të paktën,asnjë lule...Po në cilin grup mendjesh hyn Xherahu?Nuk është as budalla e as i*



dhe çmendur...Xherahu ngjason vetëm me veten...Dhe ndaj vetes ai është i tepërt....Njeri i tepërt!

Çma tha mendja këtë?!Njeri i tepërt ndaj vetes?...

Çdo gjë që është berë në këtë botë,është dashur ndaj është berë...Edhe dielli.Edhe deti.Edhe era.Edhe pylli.

Edhe ujku.Edhe miu...Po njeriu?...Edhe njeriu i është dashur kësaj bote.Njeriu u bë që të jetë zot i botës,por...

Po unë?Unë kujt i jam dashur?!Pse jam unë në këtë botë?!Ç'kam berë?!Edhe dy libra,që i shkrova,i kyça në valixhen e harresës...Desha si i marrë dhe mbeta i harruar edhe në dashuri...

“Duke të pritur ty e sosa jetën,

Pritja i humbi sytë,mbeti e verbër...”

E,o Perëndi! Akoma më pjell truri vjersha? E kujt i duhen vjershat e mia,kur s'më duhen mua?!Ja,që dhe unë,në këtë botë,edhe unë jam i tepërt...Edhe mendja.Edhe zemra.Çdo gjë e tepërt është...Xherahu i tepërt dhe unë i tepërt...Po Djaloshi i Dashuruar e Syzezë e Vetullapë?Jo,ata nuk janë të tepër...Ata duhen.Si mund të jenë të tepërt njerëzit që duhen?! Çdo gjë që duhet nuk është e tepërt në këtë botë...

Ikën e s'jua di fatin.Do Perëndia s'kanë qenë në atë anijen,që u mbyt!Jo,jo nuk kanë qenë në atë anije!Si mund të mbyten dy njerëz që duhen?!...Thuhen gjera të tmerrshme për atë mbytje...Qajnë e të gjithë i mban shpresa...Të zestë njerëz s'dijnë ç'të bejnë me jetën e tyre...Eeh!

Po,në këtë palobotë vdekja gjithmonë ka zgjedhur.Njerëzit e tepërt nuik i ka qejf as vdekja... Po Xherahu pse të jetë njeri i tepërt?!Dikujt i duhej tërbimi i tij mbi kalë...Edhe ilaçi i bardhë...Edhe çantat e zeza...Edhe duarte mbjella...Edhe pasqyrat e thyera...Edhe kolera...Edhe katër baulet e rënda...Të gjitha ...të gjitha...Kështu është gallatisur kjo botë...

Është bota e tepërt...Bota!...Oh,u lodha"!...

### *Prapa derës së mbyllur...*

**Binjakët dhe Qeni i Mëhallës,** jepnin e merrnin prapa derës së Xherahut. Ajo derë ishte e mbyllur sikur të mos qe hapur kurrë. Ishte një derë e rëndë. Nga përpara një drrasë pishe, kurse nga e prapma, një pllakë hekuri, çeliku a plumbi, që askush nuk e dinte. Goditjet e binjakëve dera as i dëgjonte, apo i dëgjonte e i shtynte me mospërfillje, pa lëshuar jehonë qarëse, siç ndodh zakonisht me dyert e brendshme, në ndërtesat tip tuneli.

**Me qysqi e levahekuri,** me çekiç e sqeparë, aq sa mundëte moshja e tyre, u munduan një javë të tërë, pa mundur ta hapnin.

-Të shkojmë tek Hotelieri. Ai i di të gjitha, edhe si hapet dera e Xherahut-hodhi mendimin binjaku i vogël.

-Ai s'na shiti dot patkonjtë e kalit, do na hapi derën e Xherahut-u hodh i madhi.

-E hap ai e hap...

-E, si duke kënduar libra? Ai vetëm libra di të këndojë...

-Pse si të duken ty librat?! Librat kanë brenda gjithë gjerat e botës... Pastaj, ai i ka libra të mençura. Njerëzit e mençur vetëm libra të mençura lexojnë...

-Pse ka dhe libra budallenj?-pyeti i madhi.

-Ka si s'ka. Më shumë budallenj ka se të mençur. Kam dëgjuar babanë unë, pastaj, unë lexoj vetë libra të mençur nuk jam si ti, që dhe librat e shkollës mezi i hap.

Binjaku i madh heshti ca, si i zenë ngushtë, pastaj pyeti:

-Po libra të çmendur ka?

-Ka, si s'ka, por ato s'i di njeri... Vetëm plaku i hotelit mund t'i dijë..

-Po këto kush t'i ka treguar?-pyeti binjaku i madh.

-Askush, i di nga vetja. Truri im mi thotë-u mburr binjaku i vogël. Pasi nuk e hapën dot derën, binjakët u nisën për tek Hotelieri Plak.

*Hoteli* i vjetër, ishte ngritur në anën tjetër të qytetit, mbi një kodër të veshur me ullinj, jo shumë larg detit. Aty pranë shtriej fusha e aeroplanëve me moshë jo më të re se e hotelit... Rreth kodrës ngriheshin një varg i madh shtëpish, me një bardhësi verbuese, si të lyera me diell... Pranë shtëpive, në ballkone, dritare e anës udhëve, lulëzonin të gjitha llojet e luleve e të pemëve, që ka pjellë toka. Në gjithë stinët e vitit, njerëzit sikur deheshin nga lulet e frutat e pjekura... Kush nuk mbillte lule, a pemë mbetej i turpëruar... Dhe pa nuse mund të mbetej... Banorët e Çmëdinës lulet i donin si fëmijët... Edhe jeta e luleve kishte dashuri e dhimbje brenda...

Kurbetllinjte, sa herë merrnin udhën e kthimit, nga përtejdetet a përtejmalet, nuk i harronin lulet e rralla... Sillnin farëlulesh, nga ato vendet e largëta e i mbillnin sipas zakonit të vendit të tyre... Edhe emrat jua vinin vetë... Çdo emër luleje e kishte një histori, apo edhe ndonjë këngë... Një lule erëmirë e flisnin *vasilikua*... Dhe lulja e vasilikoit e ka historinë e saj: Pas nëntë vitesh në kurbet, një kurbetlli i dashuruar, erdhi me mall të ndezur për vajzën që kish lenë në pritje. Vasilika e kishte emrin vajza. Ajo e priti, e priti dhe u sëmur nga pritja... Kur erdhi djaloshi, Vasilikën e gjeti të vdekur e të mbuluar me dhé... Në cepin e shamisë, që i kish dhenë ajo për kujtim, ai kish mbështjellë disa fara luleje. Të një luleje që nuk i qe ndjerë era në vendin e tij." Do t'ja çoj Vasilikës. Ajo i do shumë lulet, do e mbjellë ajo e do i ve emrin e saj..."

...Dhe ai i mbolli farat e lules mbi varrin e të dashurës së tij... E, aty mbi varr këndoi i lotuar:

*"Moj lulja Vasilikua, thuaj varrit sa të dua,*

*Desha të të marr për grua* U trete s'të pashë më dot,

*Lulet i ujis me lotë..."*

Kënga e lules me emrin e Vasilikës, që iu këndua mbi varr, nuk u harrua më... Dhe lules erëmirë i flitet "*Vasilikua*".

Edhe për pemën e bajames një histori e ngjashme është.  
Historia është harruar, por kënga ka mbetur:

*"Moj bajamja me dy zemra,  
vëthët kur do t'i vërë nëna?!"*

.....  
*Bajamja me dy thelpinj  
S'jemi pleqjemi të rinj..."*

\* \* \*

**B**injakët ecnin në udhët që i dinin vetëm ata, për të mbritur sa më parë në hotel. Po ç'të shihnin?! Hoteli ishte i shkretë... Dyert ishin të shqyera e të përplatura... Dritaret ishin me kanata të hequra... Dhomat brenda nuk kishin më as krevatë as tavolina e karige, vetëm ndonjë dollap shtrihej i përmbysur, sikur s'donte të shihte më atë dhunë tmerri...

Edhe shandanët e dritave ishin shqyer e s'u kish mbetur nishani, veç tavanëve si gojë krokodili...

I gjithë hoteli ishte i vrarë e i braktisur...

"Eheeej... fiiuuu... eehheeej..." - bërtitën e fërshëllën binjakët, duke hyrë e dalë, nga njëra dhomë tek tjetra.

Heshtje....

"Dang... dang... daaang... daaaang..." - u dëgjua një zë këmbane...

Sa vite ishte pa u dëgjuar ai zë?!... Qysh kur kishte vdekur këmbanieri, nuk ishte dëgjuar më...

Kush po i binte këmbanës së madhe?!

Pse i binte?!...

## *P a p a p u s h t i*

Kisha me emrin e Nënës së Krishtit, ishte më e madhja e më e vjetra e gjithë kishave. Me tre kube e tre këmbana. Tashti vetëm këmbanorja qëndronte në këmbë...

Për një prift, që e flisnin Papapushti tregonin: "... Merrte kryqin me vete Papapushti, dhe derë më derë e shtëpi më shtëpi, sidomos në dyert e kurbetllinjve...

Aty, ku gjente vatër të ngrohtë, nuk rrinte pa e ndezur zjarrin... Hante mish e pinte verë Papapushti e jargoste mjekrën nëpër shalët e grave... Edhe në kishë e mbante një krevat, mu në ajodhimë, në Tempullin e Perëndisë, ku vetëm ai mund të hynte...

I vinte aty një grua e papjellë, që ç' nuk kish berë e ku nuk kishte vajtur për të lindur, por në barkun e saj asnjëherë nuk mbiu fëmija.

Edhe në shtatë krojet mbushi ujë e pastaj u theu grykat, por shterpë që shterpë mbeti... Pastaj se nga e gjeti krevatin e Papapushtit në ajodhimë të kishës?!... Epo, edhe gruaja e parë e botës fjeti me djallin, e papjella pse të mos flinte me priftin?!...

Burri i të papjellës ishte punëtor e i ndershëm. Mjeshtërguri e mjeshtërduri, me duar të florinjta, por i pazoti që të bëhej baba... Ishte i paqime në faqe e i pafarrëburri... Qose, si gjithë qoset e botës...

Gruan e donte shumë, e mbante në pëllëmbë të dorës. Por ajo, si mushkat xanaxare, hidhte shkelma sa më shumë fërkohej...

Në fillim kërkonte të bëhej nënë, si të gjitha gjinifemrat e botës, por pastaj u kthye në një tekanjoze, që bënte ç' i binte në tru e ç' i donte nënlekura...

Burri pa qime në faqe, atë pasdite, u kthye më herët nga puna. E dinte, i padjallëzuari, se gruaja e tij, kur i mungonte shtëpisë, në kishë do të gjendej pa tjetër...

"Nuk vete dhe unë të ndez një qiri e ta bëj një herë kryqin?! Nuk kam shkuar kurrë në kishë, vetëm kur isha i vogël, që venim me shokët, më tepër për të luajtur... Të vete se edhe asaj i bëhet qejfi... Aty do e gjej, duke pastruar ikonat e duke u falur..." Me këto mendime e shtyu trupin e rëndë lart nga kisha. E shtyu derën e kishës dhe hyri. Kisha, sepse iu duk e ftohtë dhe e frikshme. Këtë ndjesi, nuk e kishte provuar asnjëherë... Me qiriun e ndezur në dorë, eci për nga kreu i kishës. "Nuk ka njeri këtu veç shënjtoreve të varur nëpër mure"- foli ai në heshtje. Heshtjen e prishi një rënkimë: "...oohë...oohë...ëëhë...". Ato "ohe e ëhe" dilnin nga brendatrupi i gruas së tij... Kishte dhjetë vjet i martuar dhe ia njihte mirë huqet e kënaqësisë...

Ashtu siç ishte, me qiriun e ndezur në dorë, i zgjati edhe dy herë këmbët andej nga "ëhej" gruaja... i dha një shkelm derës së qëndisur të ajodhimës dhe mbeti i pagojë, përballë dy trupave të lakuriqtë... Ishte hera e parë që ai e shihte gruan e tij të gjithë në lëkurë, me rrobat të hedhura s'dihet ku... I erdhi pështirë nga ajo pamjeturpi... "Tpu!... Tpu!..." - pështyu ai mbi trupat e lakuriqtë. Qiriu i ra nga dora, aty mbi rrobat e priftit, në të djathtë të derës.. Veladoni i zi e të përbrendshmet e bardha po tymosnin e për disa minuta, drrasat e pishës, ku rrinte në këmbë Nëna e Krishtit, u zjarruan me një flakë të zverdhur...

Dy të lakuriqtët ikën nga dera e prapme e kishës...

Burri i paqime në faqe, iku andej nga kishte ardhur...

Papapushti nuk u duk më as me mjekër e as pa mjekër... Gruaja u duk pas shumë vjetësh, së bashku me një vajzë kokërrodhe me vetulla të trasha, si të Papapushtit. Së bashku me fëmijën e saj, ajo ulej mbi gërmadhat e kishës së djegur dhe ndizte një qiri. Bënte kryqin, mermëriste disa fjalë, të pa

dëgjuara, pastaj këpuste një degë dafine e ja vendoste vajzës në gjoks... Pastaj ikte. Ikte së bashku me vajzën, andej nga kishte ardhur, për të ardhur përsëri, në ditën që e dinte vetëm ajo...

Burri pa lesh në faqe, ose "*duarflorinjt*", pas asaj që ndodhi, vente te këmbanorja e çdo ditë i binte këmbanës. Në festa fetare, në gëzime e në morte ai lëvizte zinxhirët e tre këmbanave e njerëzit bashkoheshin në të kuptuarit e jetës...

Një ditë këmbanat heshtën e nuk ranë më... Ikën vite, ashtu në heshtje, pa zërin e përbashkët të njerëzve, sa u harrua edhe kisha, edhe tre këmbanat mbi këmbanoren e gurtë...

Por sot kush po i binte këmbanës? Binjakët, në vitet e tyre të jetës, nuk e kishin dëgjuar kurrë këtë *daaang-daange* të rëndë e të harruar... Sa e dëgjuan, dolën nga shkretia e hotelit e ja dhanë vrapit për nga kisha... Por kur mbërritën tek sheshi me qiparisa nuk ishin të parët. Sheshi ishte mbushur me njerëz. Mes gjithë asaj turme qëndronte Hotelieri Plak...

### *Në varreza*

Varrezat shtriheshin midis dy udhëve, në hyrje të qytetit. Brenda portës, zgjateshin ngjer në qiell, pesë qiparisë, tre në të majtë të portës e dy në të djathtë... Porta dykanatshe harkohej nga një qemerguri i skalitur e qëndisur me merak mjeshtëri...

Brenda portës, varret ishin rreshtuar me një rregullsi simetrike, në dy krahët e qiparisëve. Ngjiteshin deri lart, si një godinë pesëkatshe, me dukje të bardhë të ndryshkur, si skeletet që mbanin brenda...

Varret ishin shkatërruar tre herë gjatë luftrave. Një herë, në të ardhur e dy herë në të ikur... Por prapë, rrënjët kishin mbetur

në kockat e të parëve e aty ishin hedhur themelet e varreve të tjerë,ku dhe krimbat,që krimbërojnë dhéun,i dinin ,mirë, emrat e të vdekurve e të fiseve të tyre...

Bota e nëndhéut gati ishte e përbashkët për të vdekurit, kurse në botën e mbidhéut,kishte dallime,që ruheshin me fanatizëm dhimbjeje...

Të gjallët,as donin të dinin se ç'bëhej me të vdekurit e nëntokës.Ata ishin pronë e tjetërkujt,pronë e përbahkët e vdekjes.Kurse mbivarret mbeteshin akoma pronë në kujtesë e në kujdesjen e njerëzve...Kujdeseshin për pllakat e mermerta,për fotografitë prej porcelani,për emërat e qëndisur e për disa shkronja të gdhendura pranë njëra-tjetrës,në formë vjershërimi...Aty,venin njerëzit,mblidhnin lule e ndiznin qirinj...Lotonin me zë,apo lëshonin zë pa lotë e,përsëri vinin e iknin grupe-grupe, e rrallë ndodhte që ndonjë shpirt-humbur,vinte e ikte i vetëm...Por vitet e fundit ishte prishur rregullsia,që mbretëronte qysh nga mosha e dhéut.Ishin hapur aq shumë varre,sa kishin dalë edhe jashtë mureve rrethues,që ishin parashikuar të nxinin të vdekurit sa të kishte jetë e sa të kishte vdekje mbi tokë..

Varret ishin ngjeshur e ishin ngjeshur aq shumë,sa lotët e të gjallëve,herë-herë,s'dinin ku të binin dhe flaka e qiriut lëpihej,sa tek njëra pllakëvarri tek tjetra...

Në ata varre të rinj,më tepër kishte emëra të humburish,ku në vend të trupave të mbetur s'dihej ku varrosej një kuti duhani,një çantë shkolle,apo një ditar dashurie,një krehër flokësh apo edhe vetëm një unazë ...Edhe mbi këta varre ngrihej pllaka e mermertë,vendoseshin fotografi e mbilleshin lule... Por çudia e pa dëgjuar dhe e pa parë ishte varri,ku mbillte lule e ndizte qirinj Hotelieri Plak...

Një varr i thjeshtë,mu në krye të varrezave,nga ana e portës së daljes.Varri nuk kishte pllaka mermeri,të shtrira e të ngritura,por vetëm një valixhe me dy kanatadruri të hapura ku



në të djathtë ishin vendosur një tufëlibrash e letrash e,në të majtë,një fotografi e rinisë së Hotelierit.Nën fotografi ishin shkruar këto vargje:

*“Pritja për ty është varr i hapur,  
Më nxirr të rroj,vetëm një çast,  
Ose mbulomë me dorën tende  
Mbyll portën e zemrës,më ler jashtë...”*

Valixhja ishte e mbështetur mbi një gur,që ngjante me një copë shkëmbi të mbirë nga dhéu.Në një kamare dhéu,ku as era e as shiu nuk hynin dotë,gjithmonë rrinte një qiri,që as sosej e as shuhej...Rreth kësaj pamjeje,që e quajtëm *varr*,kishte lule nga të gjitha llojet.Lule të lira e luleshtëpie,që nga manushaqja e trëndafilë e,deri tek luledelet e trëndelina...Këtë bashkësi lulesh,nuk mund ta gjeje në asnjë vend tjetër,e nuk kishe si ta gjeje,ashtu bashkë,se natyra bën lojën e saj dhe me lulet luan me kujdes natyre: i mbjell e i rrit aty ku duan ato...

Hotelieri Plak e dinte mirë gjuhën e luleve.U fliste fjalë dashurie e u tregonte gjithë dhimbjet e shpirtit...Dhe lulet e pranoin bashkësinë,aty,në krye të varrezave,pranë varrit të tij të çuditshëm...Ai e braktisi hotelin dhe u fut brenda vorrezave,me qenien dhe mosqenien.U shërbente luleve,ndehte qirinj dhe diç thoshte,brenda gjoksit,pa i lëvizur nervat e buzëve...Recitonte vargje dashurie nga vjershat e tij:

*“Posi një yll i perënduar,  
më pate humbur gjith’ më larg...  
Nga malli yt i thurra fjalët,  
gjithë sërë-sërë e varg e varg;  
Dhe çdo mendim e pata tretur,  
vetëm n’ërgjënd e në flori,  
O,vashë e lotit të zhuritur,  
që vetëtin në sytë e mi...”*

Ai jetonte brenda pikës së lotit,për të nderuar dashurinë edhe në vdekjen e saj,si në jetën e saj...

Ndizte qirinj,mbillte lule e këndonte vargje:

*"...Pse më ngacmon kjo lule e bukur?!*

*Buzët ka çelë e sheh nga unë...*

*Sikur ta puth me puthjevdekje?!*

*Ajo të vdesë,të tretem unë..."*



*Edhe këmbanës ai i ra pë të lajmëruar e për të nderuar dashurinë e tij të vdekur...*

### *Madama Hi-Fi*

*Madama Hi-Fi e kujtonte rrallë,atë natë pa qiell,kur doli nga-pallati me karocën me katër kuaj,por kur i kujtonte ndjente frikë...Katër rrotat e karocës i ndjente mbi trupin e saj...Edhe katër baulet e mëdha i bëheshin si katër arkivolë,ku ishin shtrirë,ata,të ikurit e asaj nate..*

*Kurse ajo e shihte veten të shtrirë në të katër baulet-arkivolë...Po,po!Vetëm ajo në katër arkivolë,ajo Zonja me Sy të Kuq,që iku,fshehur,në natën pa qiell...*

*Por,tashti,në ishullin e largët,ndjehej krejt e çliruar dhe e qetë...Viti nuk i kishte numëruar akoma ditët e fundit nga ajo natëikjeje dhe ajo po i nxirrte jashtë kujtesës,ato ngjarje të frikshme,sikur të mos ishin brenda viteve të jetës së saj...*

*Ndjehej akoma e re dhe e freskët.Tendoste muskujt e këmbëve,barkun e nënbarkun e ata i bindeshin.Edhe gjinjtë akoma nuk i ishin lëshuar dhe e ruanin rrumbullaksinë,në formën e kokërrës së shegës...Edhe majat e gjinjve ngjasonin me gojën e kokërrës së shegës,në çastin e lulëzimit...E përkëdhelte trupin dhe kënaqej me ato,që zotëronte tek vetja.*

Të gjitha ato, që i duheshin e që i donte, i kishte... Kur erdhi nga përtej kufijtë e u martua me Xherahun, mësoi vetëm gënjeshtërën dhe përqeshjen. Mësoi marrjen dhe hakmarrjen, tradhëtinë dhe pabesinë... I mësoi, apo i kishte brenda vetes dhe i nxorri para pasqyrave, në atë pallat të çmendur?! Pastaj, pasqyrat i shumonin e ia përplasnin njëra-tjetrës?!... Dhe ajo, Zonja me Sy të Kuq, gënjente e përqeshte jo vetëm njerëzit, por edhe ditët e saj... Pastaj e zinte inati, ose bënte sikur e zinte inati dhe hakmerrej me të gjithë... Me Xherahun hakmerrej me gjithë pjesët e trupit dhe ndjehej e pangopur... Edhe ikja ishte pjesë e asaj hakmarrje...

Edhe baulet e mëdha tashti nuk ishin më arkivolët e udhëtimit. Ato baule ishin aq të mëdha e të rënda, sikur veç atyre që mbanin brenda, të mbanin dhe gënjeshtërën, pabesinë, marrjen e hakmarrjen... Dhe baulet i mbanin brenda të gjitha ato, që i donte e i duheshin... Të gjitha, ajo i kishte marrë me vete tek ai ishulli i largët...

Dhe ndjehej akoma e re dhe e freskët ....

### *Gropa e kolerës*

Gropa e kolerës, zgjerohej e thellohej e akoma s'kishte mbaruar së hapuri... Disa herë ishin ndërprerë punimet e prapë kishin nisur e rinisur, nga ata njerëz që nuk kishin marrë udhët e ikjes apo që dhe vdekjen e pranonin, por nuk e braktisnin vendin ku u kishte rënë koka... Ata, futeshin në gropën e kolerës dhe gërmonin e gërmonin që gropa të bëhej aq e thellë sa të fundoste kolerën brenda... Kur s'kishin arritur tek të 50m gropa goditi në shkëmb e në burime uji... Disa nga punëtorët u mbyllën në shtëpi me éthe e dridhje e askush nuk dinte se kush do të fitonte, jeta apo vdekja?!..

Të tjerët,ata që i kishin rrezistuar baltës,gurit e ujit,punonin natë e ditë,për të arritur fundin e gropës...

Më të lehtë e kishin ata,që thyenin gurët e gëlqeres,për mbùshjen e dhjetë furrave,që duhej për të përvëluar të keqen,kur ta hidhnin brenda...

Në pesë metrat e fundit ndodhi e pandodhura dhe e pamenduara...Aty,u shfaqën disa rrënjë të mishta,që leviznin e ngateroheshin, shtrëngoheshin e përdridheshin me lëvizje të frikshme... " Gjarpërinj!...Fole gjarpërinjsh!...O Zot!Këtu është fundi i Botës..."- ulëriti ai,që i pa i pari...Të tjerët heshtën se nuk kishin ç'të flisnin.Para atij tersllëku gjigand,edhe mendja heshtëte,e jo më fjala...Ja,që çdo fund e ka dhe një fillim.Dhe ky fundgrope shfaqti një fillimtmerrri...Ata gjarpërinj,pa kokëgjarpëri,shtrëngoheshin, përdridheshin e zgjateshin në atë fundshkëmbi...Dukej sikur e kishin ngrenë gjithë dhéun,e kishin pirë gjithë ujin,dhe nën atë shkëmb,s'dihej se ç' prisnin të bënin ?...

Njerëzit, të tmerruar,i ndaluan punimet,për të mos i vazhduar më.Dhéu kish hapur gojën e tij gjigande,gati për të gëlltitur - gjithë jetën e tyre të mbetur...

### *Mendimi i frikshëm*

**X**herahut po i harrohej emëri,ose njerëzit e mbanin kyçur në kujtesën e tyre.

" Të rojme pesë ditë pa atë ulërimë e pastaj le të vdesim..."- mendonin njerëzit.

"...Edhe udhët u lodhën nga vrapi i tërbuar i kalit;udhët,që nuk lodhen kurrë nga troku e nga të ecurit e njerëzve..."...Edhe qentë,që në fillim argëtoheshin pas

ulërimës së kalit, me ham-hame e me hum-hume, shtrëngonin dhëmbët e mbaheshin pas zinxhirit, në heshtje mërzie; qentë që nuk pushojnë kurrë së lehuri qënçe...” Të gjitha këto erdhën, aq natyrshëm, si vjen vdekja pas jetës, edhe pse bëmat e Xherahut mbi kalë dilnin jashtë atyre, që dinte truri i njeriut...

Mendim i frikshëm: E ka mbërthyer kolera mbi kalë, aty në pallat...

Mendim i frikshëm: Nuk është në pallat. Ka ikur matanë tek miqtë e tij...

Mendim i frikshëm: As ka ikur, as është në pallat. Është aty ku s’na e pret mendja...

Të gjitha mendimet, që formoheshin në trurin e njeriut, ishin të frikshëm...

Prapë mendim i frikshëm: Po të jetë i mbyllur në pallat ç’do të bëjmë me kolerëzënin?! Kolera është e tmerrshme të bjerë në kasolle e jo në pallat...

-Edhe gropa mbeti si varr i hapur...

-Ç’do të bëjmë me kolerëzënin?! Më mirë të mos i kish ndodhur kjo e keqe, se pas saj, të tjera të këqia do të na vijnë...

-Po sikur t’ja ketë mbathur matanë e të ketë futur kokën nën fustanellat e bardha të miqve të tij?!...

-Do të shpëtonte kokën, por njerëzit prapë nuk do të shpëtonin...

-Po sikur të mos jetë as në pallat, i mbërthyer nga kolera e as të ketë ikur?!...

Kjo i tmeronte më shumë njerëzit. U dukej sikur ishte fshehur, diku, në katua, nën krevat, prapa derës, tek mulliri i kafesë, apo në bri të kaut; e një ditë a një natë, do të dilte me ulërimë: "...Jam unë Xherahu juaj... Unë nuk vdiqa... Unë nuk ika... Jam këtu..." O Zot, kjo është më e tmerrshme!

Mendimi i frikshëm "...as ka ikur, as është në pallat..." - ishte më i rëndi në kokat e njerëzve. Edhe Djallit nuk i punonte mendja aty ku i punonte Xherahut...

Ngado që e hidhnin mendimin njerëzit, nuk e kapnin dotë të vërtetën. Tashti që nuk e kishin më para syve e qe kthyer në mendim të frikshëm, ishte edhe më i frikshëm.

Të paktën të shfaqej diku. Donin ta harronin, por kishin frikë edhe nga ai harrim..." *Po sikur të shfaqej befasishëm me ndonjë damblla nga prapa?! "...*

### *Kush e hëngri kolerën ?...*

Vëllezërit binjakë dhe qeni i Mëhallës së Përtejme, ishin të vetmit, që bënë marrëzinë e zbuluesit, në Pallatin e Kolerës... Ata e kërkonin Xherahun dhe do e gjenin "*sikur edhe me lëkurë gjarpëri të qe veshur...*" si thoshte binjaku i vogël, që nuk e dinte se kur e kishte dëgjuar për herë të parë këtë shprehje. Binjakët dinin shumë të fshehta nga të fshehtat e pallatit: Nga cila portë hyejsh e nga cila portë dilejsh; sa dhoma kishte, sa dyer e sa sallone; nga vinte errësira e ç'fshihej brenda errësirës?. Dinin, por nuk flisnin e nuk tregonin se dinin... Për ruajtjen e të fshehtave ishin mësuar qysh me patkonjtë e kalit e jo tashti që bëhej fjalë për gjera më të rëndësishme... Tashti ata do të zbulonin se ku fshihej Xherahu me kalin e bardhë... I kishte zenë kolera, apo ishin fjalë të gënjeshtërtat?... Ata nuk e besonin kolerën dhe nuk i frikësoheshin... Edhe kur ishin pas asaj derës së mbyllur, që diç mbante brenda, as u shkonte mendja tek kolera: "Edhe po të ishte brenda kolera do të qe ngopur me Xherahun dhe kalin e Xherahut... Të haje Xherahun s'ishte e pakët, pa lëre me gjithë kalë pastaj?!... Jo një, por njëqind kolera të kishin hyrë në pallat, nuk e bënë dot atë punën e ngrënies, vetëm po të donte vetë Xherahu që të hahej nga kolera... Por ç'është ai që kërkon ta hanë?! Njerëzit kërkojnë të hanë e jo t'i hanë... Xherahu, me një ulërimë, tremb dhe qentë e jo kolerën... Se kolera po të ishte më e fortë se

qentë,do të hante dhe qenër...Vetëm njerëz ha kolera...Po Xherahun ?! Ai e ha kolerën.Brenda në barkun e Xherahut asaj do i zihej fryma...Po Xherahu ku është ?...”

Këto mendime lodhnin trurin e binjakëve,të mbetur jashtë të fshehtës së derës së mbyllur...

Hotelierin e kërkonin e nuk po e gjenin dot...Atë ditë,te kisha,si nuk i treguan?!Vetëm ai mund t'i ndihmonte që ta hapnin derën...Më vonë e kthyen mendjen.Po t'i tregonin Hotelierit e t'i kërkonin ndihmë,zbulimi nuk do të quhej më i tyre...Ata kishin kohë që merreshin me zbulime,do ta gjenin dhe Xherahun sikur edhe “në lëkurë tëgjarpërit të fshihej...”.

### *Në atë jetë të përqeshur...*

Shtegun e Djallit nuk po e kapërxente më kush,pë t'u ngjitur tek Balta e Kuqe.Edhe gjahtarët e kishin harruar,si shtegun edhe derrat e egër.Qysh kur u mbollën ato duar të mallkuara,çdo gjë për rreth u tjetërsua deri në humbje emëri.”Toka e Kuqe “nuk flitej më me atë emër.As “Korija e Manastirit”.As” Shpella e Ujku”.Edhe as “Shtegu i Djallit”. Këta emëra ishin fshehur diku,për t'u shfaqur përsëri,ose të harroheshin përgjithmonë të fshehur...

Ngjarjet,kishin mishuar trurin e njerëzve,deri në përmbysje kujtese... Gjithçka ata e përmblihdnin tek fjala: “Të Paemërit”.Brenda këtij emëri”të paemër” ishin gjithë ato ngjarjetmerri,me duarte e mbjella e njerëzit-hije,që mbollën ato duar...“ *Të paemërit*” ishte dhe mallkin dhe urrejtje.Dhe hakmarrje...Por edhe shpresë për të rilindur ata emëra,që fshiheshin në përmbysjen e trurit...

Duart e mbjella i kishin zgjatur aq shumë rrënjët,sa i kishin gërryer e ngrënë gjithë nëndhëun me ç'kishte brenda,mbase dhe të vdekurit e nëntokës,e pastaj u shfaqën,befasisht,në

fundin e gropës,ku do të mbulohej e keqja,apo edhe në fund të detit ku u bë përmbysja...

Po fundi deri ku ishte?!...

Po sikur në çdo hapje themeli shtëpije,apo gropëvarri,të dilnin ato rrënjë të mishta ?!...

Po kur të mbillej një pemë ?...Një lule ?...Një qiparis ?

Po sikur?...

Po sikur ?...

Po sikur ?...

Njerëzit kishin harruar t'i binin edhe këmbanës.

Mallkonin Xherahun se atë e kishin të tyrin.Mallkimi nuk i ze të huajt...

Edhe veten e mallkonin,për ato ç'u kish parë syri e ç'u kish dëgjuar veshi në atë jetë të përqeshur:

Me njerëz të ikur – paudhë...

Me njerëz të humbur – pa gjetur...

Me njerëz të vdekur – pa varre...

Dhe me veten e tyre të mbetur në atë jetë të përqeshur ..

### *N u d o*

**Kryekomandanti mbeti gjithmonë në pozitën e shërbëtorit.Edhe në Ishullin e Largët,i mbetur vetëm me Madamën Hi-Fi,nuk fliste.Vetëm bënte.Bënte si i thoshte Hi-Fija e kur i thoshte Hi-Fija.Gjithë jetën më shumë kishte bërë se kishte menduar e folur.Dhe nuk i kishte dalë keq.Jetën e kishte jetuar, për mrekulli, në pallatin e Xherahut:"Rroga-rrogë e qejfi mbi rrogë".Në atë pallat nuk kishte biseda.Vetëm heshtje dhe ulërimë.**

**Dhe njerëzit prapë merreshin vesh.Rojat i bindeshin me një të parë syri.Edhe punët jashtë pallatit i bente siç dinte e siç donte Xherahu....Pastaj,bënte siç dinte e siç donte Zonja .**



Dhe flinte i qetë,për shtatë palë qeje,siç i thonë fjalës. Por te ky ishull i qetë ai ndjehej ndryshe.Meraku e frika i hante jo vetëm orët e ditës,por edhe ato të gjumit.Meraku për Zonjën dhe frika për ato katër baulet e mëdha,që kishin marrë me vete. Ishte hera e parë që e vinte trurin të punonte,por s'dilte dot në krye të udhës së mendimit...Veprimet e Zonjës i dukeshin të çuditshme.Ndoshta, nuk ishin ashtu,por gjykimi i tij deri aty mbaronte:" Zonja po vepron ndryshe". Qysh natën e parë,në atë vilën anës detit,e trembnin veprimet e saj.Ajo e thirri në dhomë e i tha:"Këtë,që do të bejmë tashti mos e harro kurrë!"...

-Çdo të bejmë?-s'kishte guxuar të pyeste ai dhe,si gjithmonë,nuk e kishte hapur gojën..

Madama Hi-Fi,nisi të zhvishej,pa nazet e zakonshme. Hoqi fustanin e gjatë,pastaj këmishën e shkurtër dhe aq mjaftonte për t'u lakuriqëzuar,se ato dy rrobat e vogla,që mbahen nën këmishë,i kishte harruar t'i vishte,qysh nga vajzëria...

-Merri!-e urdhëroi ajo,duke ia hedhur rrobat e saj,aty nën mustaqe-ku e ke çakmakun?! Ai nxorri çakmakun,duke mbajtur në njërën dorë të zhveshurat e Zonjës.

-Edhe një cigare!-urdhëroi ajo.

Ai i afroi cigaret " *Princ*",që mbante zakonisht dhe ia ndezi.Zonja e thithi ,me të dyja mushkëritë e,duke nxjerrë shtëllunga tymi,foli:" Zhvishu dhe ti!".Ai nuk qe zhveshur kurrë lakuriq.Si mund të zhvishej para Zonjës?!Para një femre të zhvishej ai lakuriq?!...Ajo,edhe kështu,dukej e bukur,me atë trup të derdhur,me të ngritura e të futura,ashtu siç duhej e aty ku duheshin;po ai si do të dukej lakuriq,ashtu, leshtor e me ato të varurat e burrit?! I vetmi lesh ,që i qe dukur ishin mustaqet,por ato e zbukuronin dhe e bënë më burrë.Tashti,para atij leshi të ngatërruar, si dotë dukeshin mustaqet e tij?!...Sikur të mos zhvishej?! Këtë nuk e kishte menduar kurrë dhe truri i tij nuk

merrte dot vendime të menjëhershme...

-Akoma?! Zgjidhi rrypat dhe lëshoi, se e mbarova cigaren-  
dëgjoi zërin urdhërues të Zonjës me Sy të Kuq. "Epo, në djall të  
vejë! Kur do ajo, ta bëj dhe unë", -donte të mendonte  
Kryekomandanti, por më shpejt kishte lëshuar pantallonat e  
brekët se sa kish kërkuar mendimin...

-Na! Merre çakmakun dhe digji. Të gjitha bashkë!

Ai, që kishte ndezur sa e sa zjarre, tashti i dridhej dora para  
flakës së një çakmaku.

-Ndize se do të ftohesh! -u tall Zonja.

Ai me çakmakun e ndezur, e drejtoi flakën nga "luluçkat e  
zonjës", si për të marrë hak ndaj këtij poshtërimi...

-Jo, jo në oxhak! Aty në mesin e dhomës, na duhet tymi të na  
mbulojë, shih si jemi, e ke parë veten? Je pa brekë- vazhdoi  
Zonja talljen, thithi dhe një herë cigaren, pastaj e hodhi mbi  
hutimin e robave. Ai donte t'i thoshte diçka Zonjës, se boll e  
poshtëroi, apo të bente diçka, që nuk e kishte berë kurrë, por ajo  
e rrëmbeu nga krahu dhe e rëndoi mbi trupin e saj. Ai u ndje i  
çliruar nga mendimet dhe të bërat e reja, që mendonte për të  
bërë... Atë, që po bënte, e kishte bërë prej vitesh dhe prapë nuk  
turpërohej...

E harroi veten që ishte lakuriq e i mbuluar nga tymi mbytës i  
brekëve të tij, që po digjeshin në mesin e dhomës...

## *B o s h*

*Qysh nga ajo natë e çuditshme, kryekomandanti kish nisur  
të mendonte.. Zonja i dukej krejt ndryshe. Në fytyrë nuk i kishte  
më ato njollat e kuqe dhe flokët i dukeshin të bukur... Çdo ditë  
e më e bukur bëhej. Sekretin e asaj bukurie ai nuk e zbulonte  
dot. Por hallin ai s'e kishte tek bukuria e Zonjës, por tek sjelljet*

e saj...Ajo,pinte wiski,tymoste cigare,hynte mes meshkujve të pa njohur e bënte siç bënëin ata,nëpër klubenate që ai kur i shihte,shfrynte mbi mustaqe e kërciste gurmazin me gllënka rakije...

Rakisë ia dinte huqet dhe bënte siç donte ai e jo siç donte rakija.Ashtu siç mendonte,ashtu e pinte dhe rakinë.E niste sot dhe nesër e mbaronte...

Por veprimet e Zonjës i ngatërruan mendjen dhe pirjen e rakisë...

Ajo,herë pas here,hynte në një dhomë,që ai s'ishte futur kurrë,me një nga ata meshkujt e rinj...Dhe ai ishte i detyruar ta priste aty,mbi gotën e rakisë,duke shfryrë mbi mustaqe...

Kur nisnin të shuheshin yjet dhe Zonja kishte mbaruar punë,ai ecte, pas saj, i hutuar e i mërzitur.Pastaj dera e Zonjës i mbyllej ,para hundës, e ai mbetej jashtë,pa kënaqësitë e të bërat e dikurshme...

Zonja po mësonte zakone të reja.

Meraku dhe frika e Kryekomandantit nuk ishte trupi i lakuriqtë i Zonjës dhe ata meshkujt e rinj,por katër baulet e mëdha,që ishin kyçur në atë dhomën sekrete,në dollapin brenda murit,dhe çelsat i mbante ajo, në një vend të paditër...Zonjës me Sy të Kuq ia kishte parë gjithë të fshehtat e trupit,vetëm çelësat e bauleve nuk i kishte parë më me sy,qysh nga nata e ikjes...

Po sikur ata meshkujt,që pinin e putheshin para syve të tij,e pastaj hynin tek ajo dhoma e fshetë,tja zbulonin.edhe çelsat e bauleve?!...

Po sikur ??...

Me këto mendime të frikshme në kokë ai mezi i gdhinte netët...Rojat e jashtme të vilës ai i kishte zgjedhur vetë,por frikën e kishte nga brenda.Nga Zonja e tij.Për Zonjën e tij....

Ajo e shihte,ashtu,të hutuar dhe qeshte me buzën e poshtme,duke menduar se Kryekomandanti përtypte xhelozinë...Herë-herë,ajo e fuste në dhomë,si një këlysh të rrahur,

jo për t'i plotësuar atij qejfin e për t'i shuar xhelozinë,por se e merrte malli për atë trup të egër burri....

Një pasmesnatë kur Zonja ,e dehur nga pijet dhe qejfet, qe mbytur me gjumë,ai bëri zbulimin e çelsave.Hapi baulet,që fshiheshin në dollapët e murosur,por ç'të shihet?!Baulet ishin *bosh*.Të gjitha ishin bosh.....Dhe ajo mbante çelsat e bauleve *bosh...Nisi të dyshonte më thellë:*" Janë ato baulet e rënda,apo janë të tjera?...Të tjera janë! Edhe Zonja është tjetër!... Mos ndodhi gjë atë natë që dogjëm brekët në mes të dhomës? Atë natë,që u gallatisëm mish më mish e me lesh lëshuar ?... Pse tha ajo :“ ..këtë mos e harro kurrë!” Kush i boshatisi ato baule të rënda?! Unë ç'po ruaj,Zonjën,që fle me ata meshkujt e rinj,apo baulet bosh?...Të dhjefsha mustaqet,të dhjefsha !Pse si unë janë komandantët ?!U duk që nga ajo natëdjalli kur dogjëm dhe brekët e bythës...

Ajo nuk e prish qejfin fare...Kur i thashë për baulet qeshi....Fshihet lepuri...Jo lepuri,por katër baulet plot... Unë i di seç kishin brenda baulet,por nuk do e them gjithë jetën...Ç'më duhet?!Rrogën njësoj e marr,si me baulet plot dhe me baulet bosh...Një,dy,tre,pesë,zha-shtë,rroga-rrogë e qejfi mbi rrogë...Ç'më duhet mua të fus mustaqet aty ku s'do Zonja?!Një herë mbeta pa brekë..." Këtë mos e harro gjithë jetën!"- më tha....Lakuriq-lqkuriq,por urdhërat i jipte të prera....Oohuu sa shumë u lodha!Unë e lodh kokën kur ajo nuk më thotë lodhe...Po bëhem budalla tani që mendoj..."

### *Vdekja e hotelierit*

*Hotelieri* Plak jetonte në botën e vdekjes...I kishte rënë këmbanës së madhe dhe kishte shpallur vdekjen... Dhe jetonte brenda varrit të çuditshëm...Qirinjtë rrinin gjithmonëtë ndezur,ose “ as soseshin e as shuheshin “.

Nuk i interesonte më asgjë.As dita.As nata.Jetonte brenda vdekjes dhe i shërbente asaj... Nga bota e të gjallëve vetëm *poezinë* kishte marrë me vete...Vargjet, herë i vinin në formë kënge dhe i këndonte e herë i godisnin gjoksin e i zinin frymën,duke e zenë prej fyti,sa i mpihej dhe gjuha në gojë...Tashti i ndjente më shumë këto shtrëngime fyti,se ç'i kish ndjerë në gjithë jetën e tij...Çuditej me veten. Ishte i varrosur dhe këndonte. Dhe frymëzimi i zinte frymën... Poezia është kënga e të gjallëve apo e të vdekurve?... Ja, që edhe të vdekurit këndojnë e jetojnë me këngën... Kur i mbaronte kënga ndjente se nuk jetonte më as si vdekur...Ngrihej nga varri e vinte vërdallë nëpër kokavarresh...Diç kërkonte...Kërkonte veten,apo atë,që i kishte ikur nga vetja ?!...Nga nënvarret ndjente një kor vajtimi...Ai këndonte në vdekjen e tij,ndërsa ata qanin...E qara,që i vinte nga nënplakat e mermerta,e turpëronte...E mundonte dhe ai veten,që të lëshonte "...ooiii...",si ata të nënvarreve,por mundimi i kthehej në këngë e kënga i shtrëngonte fytin. Vetëm kur u kthye tek varri i tij e mori vesh të vërtetën e asaj,që po ndodhte.Lulet, mbi varrin e tij ,i folën në gjuhën e luleve:"...Të vdekurit e nëntokës qajnë jetën e të gjallëve...". I dëgjoi mirë e mirë ato fjalëlulesh....Po ai pse nuk bashkohej me qarjen e të vdekurve?!...Ishte i vdekur apo shërbëtor i vdekjes ?!... Donte të fliste me dikë.E kishte marrë malli për të përdorur zërin e tij.Po kush ta dëgjonte,aty në varreza?! Gati,në gjithë jetën e tij nuk e kishte dëgjuar kush...Më mirë kuptohej me lulet se me njerëzit...E kishte mësuar gjuhën e luleve dhe lulet e dinin mirë gjuhën e tij...Edhe kur shkruante,në gjuhën e luleve shkruante...Njerëzit nuk e kuptonin,ose bënë sikur nuk e kuptonin...Dhe ai i kyçi të shkruarat në valixhen prej druri,për t'i harruar...Edhe mendimet i kyçte brenda qënies së tij të trazuar dhe heshtëte...Dikur kishte shkruar një vjershë për mendimet:

*“Mendimet më munduan shumë,  
 më vijnë e nuk i mendoj dot.  
 Mendojnë ca gjera të pamendta,  
 ca gjera që s'ndodhin në botë...  
 Mendojnë mendimet dhe unë s'flas.  
 Dhe po të flas,kush më dëgjon?!*  
*Mendimet vijnë e ikin prapë,  
 Unë rri e hesht...e prapë mendoj...”.*

Edhe këtë vjershë e kishte fshehur, diku,në valixhen e vjetër...Dhe valixhen,me të shkruarat e jetës,e kishte venë në ballin e varrit të tij.Aty ishin dhe vjershat, dhe lulet. Tek varri i tij ishin....

I ra këmbanës së madhe për vdekjen e tij,por dhe ai zë këmbane u shurdhua në veshët e njerëzve...Ai,prapë i vetëm e i pa dëgjuar... Kur ishte i gjallë,ngjitej këtej nga varrezat e fliste me të vdekurit.Edhe atë vjershën,që i vinte në mend,në varreza e kishte shkruar:

*“...Në vendin ku u linda,  
 Mbeta shurdh i heshtur.  
 Do shkoj nga varrezat,  
 Të flas me të vdekur...”.*

Dhe të vdekurit e kuptonin më mirë se të gjallët.

Po tashti, që ishte i vdekur e me varr,nuk donte të ishte me të vdekurit e si të vdekurit.Donte të nxirrte zë e të fliste me ata,që kishin mbetur të gjallë...

Ku ishin të gjallët ?! Në gjithë jetën ai kishte pritur e përcjellë njerëz në hotel,por veç me librat fliste.Si të mos ishte njeri por libër.Një libër i vjetër,që vjetërohej çdo ditë mbi libra,i heshtur e i padëgjuar...Tashti ishte i vdekur...Kishte shpallur vdekjen e Dashurisë së tij dhe i vinte asaj tek varri...I kujt ishte ai varr? I tij apo i Dashurisë së tij?

“ Njeriu dashuri është,-i thoshte ai vetes- njeriu nuk jeton dot pa dashurinë”. Të dy kishin vdekur.Ai dhe Dashuria.Ose

Dashuria dhe Ai. Dhe për të nderuar vdekjen, ai ndizte qirinj e rriste lule, mbi varrin e tyre të njëjtë...

Por gjuhën e varreve nuk mund ta duronte. Donte të fliste me të gjallët...

Ku ishin njerëzit?! Ku ishin të gjallët?!

Edhe Djaloshi i Dashuruar kishte ikur larg. Ndjente mall. I dukej sikur dëgjonte këngën e tij: "Syzezë e vetulla për /do vij sonte natënë...". I dukej, një çast, sikur jetonte dhe ai brenda dashurisë së Djaloshit... Por Djaloshi ishte i ikur dhe ai ishte i mbetur aty tek varrezat... Gjithë ditët e gjithë netët ai ishte i mbetur, aty në varreza, brenda vdekjes e jashtë varrit...

Aty, mbi kokën e varrit të tij ndjeu një zë, që i vinte nga brendagjoksi:

*"Çdo natë më vjen një ulërimë.  
Nga vjen, s'e di? Ku shuhet vallë?  
Dhëu s'tregon. Mos vjen nga qiejt?!  
Qielli hesht. Dhëu hesht prapë..."*

*Çdo natë më vjen një ulërimë...  
Mos vjen nga shpirti i shpirtit tim?!...*

E gëzoi ai zë, që i erdhi nga brendagjoksi...

### ***Revolta e të vdekurve***

Dielli akoma s'kishte perënduar. Nga varrezat diç po ndodhte... Dëgjoheshin ulërima, sharje, kërcitje kockash.....

Aq fort dëgjoheshin sa dridhej dhëu e dridhjet zbrisnin deri në breg të detit e ngjiteshin deri lart tek kisha e djegur, ku vetëm këmbana rrinte në këmbë...

Më të frikshme, zhurmat dilnin nga goja gjigande e dheut, që vetë çmendinasit e hapën, mu në mëst të Çmëdinës...

Edhe pse njerëzit ishin mësuar me llahtarat e jetës,në atë copë jete që po jetonin kjo, që po ndodhte,i kalonte skajet e mendimit dhe rrëzohej në humnerën e përtej-jetës...

Ç'po ndodhte? Rrënjët e duarve të mbjella,ishin zgjatur e zgjatur deri tek varret...Kishin ngrënë krimbat e varreve,që krimbëronin dhéun së bashku me dhéun,që kishte ngrënë,gjer në tretje,mish njeriu,pastaj u ishin drejtuar kockave lakuriqe...Një skelet fëmije i kishte ndërë i pari dhe ia dha ulërimës:" ooooo...kuçedra...kuçedra...".Aq u desh dhe të gjithë skeletet u zgjuan,shtrënguan kockat me njëra-tjetrën dhe u ngritën në këmbë,për t'u mbrojtur nga kuçedra...I gjithë dhéu lëvizti...Pllakat e mermerta u çanë e u shembën...Qiparisët dridheshin si në ethe...Muret rrethues u shembën...Qirinjtë e ndezur dogjën njëri-tjetrin...Fotografitë e porcelanta kërcitën e u shkoqën...Emërat e datat u këputën copa-copa...Shkronjat,të rradhitura në vjersha,kishin mbetur pa zanore...Zanoret ishin herë *ulërimë*...

Tre herë ishin shkatëruar ato vorreza,dhe të tre herët,nga të ardhurit e huaj.Një herë,në të ardhur e dy herë në të ikur...Shkatërrime nga barbarizmi i njerëzve të mbitokës,të armatosur me topuzë,tanke,raketa,topa e me dhëmbë të metaltë...Në ato shkatërrime,të vdekurit e nën tokës,kishin lëshuar ndonjë psherëtimë,bile disa,edhe kishin qeshur me barbarët e mbitokës sikur t'u thoshnin:"...I prishët pllakat?!...I shkulët lulet?!... I thyet kryqet?!...Por ne s'kini ç'të na bëni!...Ne jemi në mbretërinë tonë...ooohh...oh...

Hahahaaa !..." -psherëtinin e qeshnin,pa i bashkuar kockat e pa u ngritur në këmbë,si në këtë revoltë të padëgjuar...Shkatërimi vinte nga nëntoka,si një tërmet i frikshëm...Qendra e këtij tërmeti-liahtarë ishin varrezat...E keqja kishte vajtur deri në eshtra njerëzish dhe kërkonte të sundonte dhe perandorinë e vdekjes...Vetëm varret, pa trupa brenda, kishin mbetur ashtu siç ishin.Varret,që mbanin një djep fëmije,a një krehër flokësh,



një ditar dashurie,një kuti duhani,a një unazë martese,ishin akoma me pllakat e mermerta e lulet rreth varreve,që jetonin... Edhe varri i Hotelierit jetonte qirindezur,aty,në ballë të varrezave...

-Oiiiiëë, kuçedra,erdhi kuçedra- qante një skelet fëmije.

-Eeheej,ngriihuuni! Erdhën...po vijnë- jepte kushtrimin një skelet djali, nëntë pëllëmbësh...

Sharje.Sharje....

Bërtitje.Bërtitje...

Kërcitje kockash...

Tundje dhéu...

-Poshtë!Poshtë!...

-Vjedhje! Vjedhje !...

-Vrasje! Vrasje !...

-Marrje! Marrje !..

-Eheeejj ! Barbarët...Erdhën..po vijnë...

\* \* \*

**H**otelieri kishte orë që ishte larguar nga varrezat.

“ Të dal një herë se mos gjej njerëz,se m’u tha gjuha...

Ata dy çapkënët e vegjël kanë kohë që nuk më kanë ardhur...E,ku e dijnë ata se unë jam tek varri?! Do të shkoj t’i gjej...” llafosoj me vete dhe këmbët po e shpinin nga pallati...” Do të kenë bërë ndonjë marrëzi të re.Ata s’rrijë dot pa marrëzi...E bëjnë nga një marrëzi të mençur...Te kisha diç donin të më thoshnin,por unë s’dija ku isha e kush isha...I rashë këmbanës së madhe e shpalla vdekjen.Vdekjen e shpalla brenda vetes sime.Të tjerëve s’ka ç’u duhet vdekja ime,si nuk u duhej as jeta.Mua më kishte mbuluar këmbana e vdekjes dhe njerëzit më shihnin indiferentë ,ose shihnin këmbanën, që më qante mua e jo mua që i bija këmbanës...Por edhe këmbana nuk qante për mua...Duart e mia e lëviznin,por ajo qante veten.

...Edhe këmbana qan veten në këtë kohë të mallkuar...

Diç doni të më tregonin binjakët...Andej nga pallati i Xherahut do të jenë...Nuk shkel këmbë njeriu andej.As gazetarët nuk shkelin...Po unë? Unë i vdekur jam. Vdiqa kur doja e si doja vetë..

Edhe binjakët do t'i gjej se më ka marrë malli...Do t'i gjej e do të them fjalë se m'u tha gjuha në gojë..."- fliste me vete Hotelieri në udhën për nga pallati...

"O Zot,ç'po ndodh kështu?! Dhéu po lëviz deri në shtresën e shtatë...Zhurma...Sharje...Urrejtje...O Zot!

Këta zëra më duken si të njohur...Në gjuhën time flasin...Vijnë nga varrezat,të mbytur e të vvarë,por të fuqishëm e dridhës...I njoh këta zëra...Eshtë gjuha e të vdekurve...Të vdekurit e flasin gjuhën më mirë se të gjallët...Edhe zërin e kanë më të fortë...Nuk e kanë zëfryme,por zëkockash...Ç'ka ndodhur andej nga varrezat ?! Me gjithë këtë dridhje,do jenë rrëzuar e shëmbur...Të vdekurit kanë shëmbur varret e tyre...Pa tjetër,kështu do të ketë ndodhur...Po varri im? Si gjithë të tjerët dhe ai...Por unë jam këtu,jashtë varrit,kush do ta ketë shëmbur? Të vdekurit fqinjë,kush tjetër...

E, ç'duan me varrin tim të vdekurit fqinjë?! Nuk besoj ta kenë prishur...Po sikur të isha unë tek varri im do e kisha prishur? Si gjithë të tjerët...Jo! Unë s'jam si gjithë të tjerët...Unë jam i vdekuri i mbitokës...E,pse ta prishja varrin tim...Varri im është me vjersha e me lule...Si mundet ?! Si?!...Do kthehem të shoh se ç'bëhet !"...

\* \* \*

**Edhe** pse ishte në merakun e varrit, Hotelieri nuk shkeli në udhën më të shkurtër, por i ra nga kisha, ku këputi një degë dafine, pastaj bëri për nga qendra e qytetit, ku ishte hapur Gropa e Kolerës... Nuk mbante mend sa kohë kishte pa

shkelur në atë udhë... Edhe kur kishte dëgjuar për ndërprerjen e punimeve dhe për ata gjarprinjtë pa kokë,nuk qe munduar t'i shpinte këmbët deri andej. Gjithmonë shkante tek e mira e i largohej së keqes...Edhe një arsye tjetër që ai nuk dilte në qytet ishte se nuk donte të përballej me njerëz. Njerëzit i donte kur i kishte larg e i mërziteshin kur flisnin të njejtat fjalë e qaheshin për të njëjtin fat...Në gjithë jetën kishte jetuar i vetëm dhe dashuria për njerëzit kalonte mes vetmisë së tij.Vetëm kështu ajo merrte kuptimin e dashurisë njerëzore...

Kur ,nga hoteli i tij, shkante Kalorësi Ulërimë i shoqëruar nga turmat,që kishin vetëm duar e këmbë;donte javë,në mos dhe muaj që ta mblidhte veten.Shqetësohej deri në gjak.Në gjithë netët që vinin nuk shihte endrra.Dhe netët pa endrra nuk ishin netët e tij...Pastaj braktiste hotelin e shkante nga varrezat.Fliste me të vdekurit e sikur qetësohej ca...Djaloshi i Dashuruar dhe vëllezërit binjakë ishin të vetmit,që nuk e bezdisnin.Fjalët e tyre kishin shumë çelësa,bile disa herë ai ndjehej vështirë dhe i ngathët,para "zogjve fluturues të fjalëve të tyre"...

Koha kishte rrjedhur si xhind,me aq e aq bëma të këqia sa çdo gjë ishte kthyer përmbys...Edhe vetja përmbys i dukej...Ai,tashti ishte i vdekur ose një i gjallë i vdekur.Por njerëzit i donte t'i kishte afër e të fliste me ta...Heshtja dhe vetmia,që dikur ishin kënaqësi,tashti e mërzisnin dhe e lodhnin së tepërmi...Edhe kjo,një arsye që për tu kthyer në varreza,morri udhën nga ku mund të gjente njerëz e të këmbente dy fjalë. Dhe pastaj do të kthehej,pa tjetër, tek varri.

### *Zhdukja e binjakëve*

Vëllezërit binjakë nuk u kthyen atë mbremje në shtëpi...Sado vonë,por gjithmonë ishin kthyer.Bënin ç'bënin,

venin nga venin e në mbremje i mblidhte shtëpia. Për bëmat e ditës nuk tregoni,por dhe prindërit nuk i bezdisnin. Atë mbremje,prindërit i pritën e i pritën,por nuk e dëgjuan zilen e derës...

I kërkuan e ku nuk i kërkuan...Edhe në shkollën e djegur e të shkatërruar...Edhe tek hoteli i vjetër,në anën tjetër të qytetit,por nuk i gjetën...Asaj shtëpije dhe kjo gjëmë i duhej....

Para binjakëve,kishin lindur dhe dy fëmijë të tjerë,por nuk i rritën dot. Vajza vdiq pa mbushur vitin,kurse djali,që u lind pas dy vjetësh nga vdekja e së motrës,vdiq kur i kishte jetuar vetëm tre vjetët...Të dyja vdekjet ishin pa shkak e të befasishme...

“ Perëndia na i dha,Perëndia na i morri ”,-thoshte gruaja e sytë nuk iu thanë për vite e vite...

Burri heshtëte dhe, qysh atëhere,duhanin jo vetëm e thithte me të dyja mushkëritë,por e përtypte dhe e kapërdinte...Mbas shtatë vjetësh gruaja ndjeu t'i mbinin në bark përsëri fëmijë...Lindi dy djem të bukur e të shëndetshëm. Shtëpija u mbush dhe jeta e dy bashkëshortëve nisi të merrte kuptim,kur po kapërxente mesin e saj...

*Dy binjakët* dalloheshin për zgjuarsin e guxim dhe shpejt vendosën autoritet në shtëpi e mes shokëve...Me djemtë e shkollës e të lagjes nuk para trazoheshin.U pëlqente koka e tyre dhe shoqëria mes tyre...Të dy ishin binjakë,vëllezër dhe shokë...Luanin e grindeshin. Diskutonin edhe për ato,që nuk i kishin dëgjuar asnjëherë e nuk jua kish parë syri kurrë...Miq nuk kishin.Vetëm me Hotelierin Plak bisedonin me qejf e merrnin rrugën deri tek hoteli i vjetër...” Hotelieri di fjalë librash” -thoshnin ata e kënaqeshin kur e dëgjonin.

Edhe hotelieri i donte e u vinte pas qejfit...

Për humbjen e binjakëve Hotelieri nuk morri vesh.Kur ata i kërkonin në hotelin etij,ai ishte në varreza...Hotelin dhe jetën e kishte braktisur prej ditësh...Për zhdukjen e binjakëve nisën hamendjet dhe fjalët e thëna e të pathëna...

Thuhej: se dy vëllezërit i kishin rrëmbyer,ata që ikën,turistët me çanta të zeza...

Thuhej: se i kishin vrarë...

Thuhej : se ishin futur në Pallatin e Kolerës dhe i kishte ngrenë kolera e Xherahut...

Thuhej: se duke luajtur pranë Gropës së Kolerës,kishin renë brenda dhe i kishin kollofitur gjarpërinjtë pa kokë...

Tjuhej: se ishin ngjitur nga e " e paemëra" siç i flisnin kodrës ku ishin mbjellë duart,dhe aty,ato duart e tmerrshme " merr-merr,vrit-vrit e ha-ha " kishin bërë punën e tyre;i kishin shqyer e përpirë pa u lenë nishan...

Nënës së binjakëve i iku mendja e,ashtu,mendjeikur, shkonte derë më derë e shtëpi më shtëpi duke qarë me ulërimë:" dua djemtë...dua djemtë...uuuü..."- dhe shkulte flokët e godiste me gurë...

Një mëngjes u gjet e vdekur, para portës së shqyer të pallatit, me një gur në dorë...Babai i binjakëve,shkoi në pyll,preu një gjemdrize të madh dhe e vuri tek porta e shtëpisë së tij. Pastaj iku s'dihet nga e kurrë nuk u pa...

### *Vajza e kapitenit*

Sa shpëtoi nga ajo vdekje tragjike,Djaloshi i Dashuruar,i vetëm e dashurimbytur,u gjend në bregun tjetër.

Një ditë,dy,një javë as fliste e as mendonte...Nuk fliste e nuk mendonte për ta mbajtur brenda vetes,ashtu të pa prishur,atë pamjellahtarë,ku Syzeza e tij lëshoi flokët e u rrëmbye në udhët e poshtme të detit...Gërshetat iu shpleksën nga rrymat e ujit dhe trupi i saj mbështillej e zhvishej nga flokët e gjatë...Ai donte të kapej pas tyre,të mbahej e ta mbante që të shpëtonin apo të vdisnin së bashku,por flokët i rrëshqisnin nëpër gishta e ajo i largohej e i largohej...

Atë pamje ai po e gdhendëte, brenda trurit, aty në breg të detit, pa folur e pa menduar për asgjë tjetër... Kalimtarët e shihnin, ashtu të ulur mbi një gur, me kokën në duar e të përhumbur, dhe askush nuk i fliste... Askush nuk hynte në hallin e tij... Askush nuk i hidhte sytë edhe pse e shikonin...

Nuk i jepnin asnjë fjalë të vetme...

Dhe ai shlodhej me këtë indiferencë të tmerrshme... Edhe për veten nuk mendonte. As për ushqim. As për fjetje... As se ç'do të bente në të nesërmen e jetës... Truri i tij kishte nevojë për pamendim, që të gdhendëte të pa deformuar, atë tragjedi deti... Një pakujdesi truri dhe ajo pamje do të fiksohej ndryshe: e prishur, e gënjeshtërt...

- Ej, djalosh! - foli në gjuhën e saj një vajzë.

Ai nuk u përgjigj edhe pse ato fjalë iu dukën aq të ngrohta e të embëla, si të ishin fjalë të gjuhës së tij... Vajza i vuri dorën mbi flokë dhe i foli përsëri.

- Me se mund t'ju ndihmoj zotëri?... Ndjehehi fatkeq, por nuk dukeni njeri i keq... Me se mund t'ju ndihmoj? - dhe e kapi nga krahu për ta ngritur. Ai nuk foli, por iu bind dorës së saj përkëdhelëse... U ngrit dhe i shpiu këmbët, gati i varur pas trupit të vajzës. Nëpër këmbë i lëpihej një qen i bardhë leshtor... Vajza e tërhoqi mbi një urë të varur dhe e hipi në një anije, që ishte ankoruar aty pranë... Ai, akoma nuk i ndjente gjymtyrët. As trupin. I gjithi ndjehej i mpirë e i gjymtuar. Nuk e kishte parë akoma fytyrën e vajzës dhe vendin ku e çoi ajo... Vetëm kur u gjend në një shtrat të butë dhe piu një pije të nxehtë, erdhi në vete...

- Mos u ndruaj, këtu je në anijen e babait tim... Unë jam vajza e kapitenit - foli ajo zëmbël dhe u ul pranë tij...

- Ju falem nderit - foli ai në gjuhën e saj dhe e pa në fytyrë. Kishte një fytyrë rrumbullake, ku ishin venë me kujdes dy sy ngjyrë deti e dy vetulla të trasha, që bashkoheshin mbi hundën e drejtë. Buzët i kishte të shëndetshme e gjysmë të çelura, sikur

diç prisnin. Nofulla mblidhej aty,nën buzën e poshtme,me një gropëz,që formohej e zhdukej,sa herë ajo përplaste buzët në formim fjale. Flokët i kishte të prera shkurt,në ngjyrën e hënës...

I hodhi një sy qenit,që i rrinte pranë,por nuk e lodhi mendjen për hollësitë e pamjes së tij,veç i erdhën ndër mend fjalët e hotelierit: "Qeni do njerinë,macja do shtëpinë".

-Një banjë e nxehtë do t'ju shlodhë...Ujët është gati.Sa të mbaroni unë do t'ju sjell edhe robot...Mirë?-foli vajza ëmbël dhe doli nga dhoma. Për çudi,fytyrën e kësaj vajze ai nuk e krahasoi me *Syzezën* e tij të mbytur...*Syzeza* e tij ishte gdhendur brenda trurit,brenda shpirtit,brenda gjithë qenies së tij..

Ajo ishte " *e bukura e shpirtit*" të tij,kurse kjo vajzë,me sydeti e flokëhëne,isht "*e bukuria e syve*" të tij...

Hyri në dush dhe bëri siç i tha Vajza e Kapitenit,me një kënaqësi të veçantë...Kur doli,i mbështjellë me peshqir,në dhomë e prisnin robot.Ajo,sikur i kishte marrë masën me ata sytë e bukur...Edhe veshjet e brendshme,edhe pantallonat,edhe këmisha,si të porositura. U vesh shpejt e shpejt,se mos ndodhej para vajzës,ashtu i lakuriqtë,u kreh para një pasqyre vezake..

" Sa kohë kam që nuk më ka parë pasqyra?!. Kam ndryshuar i tëri...Edhe sytë sikur s'janë të mitë...Dhe po nuk janë sytë,edhe unë nuk jam më ai,që kam qenë...Po kush jam unë?!Ndoshta ai jam,por nuk e shoh mirë veten...Apo më beri ndryshe ky kostum ngjyrë perëndimdielli ?! Se si më duket vetja?!..."- qeshi me pamjen, që i jipte pasqyra dhe dy gropëza iu formuan në faqe..." Janë të mijat këto gropëza...edhe kjo e qeshur..E qeshura tregon të vërtetën..."- Kaloi çapkençe gishtat në flokë dhe i thelloi gropëzat e faqeve tek e qeshura... Ashtu e gjeti Vajza e Kapitenit.

-Tashti duhet të hani diçka,pastaj do të rijmë bashkë- foli ajo e kënaqur me bukurinë e Djaloshit dhe e gëzuar,që ai e

kuptonte mirë gjuhën e saj.

Ai, nuk e mbante mend që kur kishte ngrënë, por edhe pse ishte barkbosh, iu dukën si të zakonshme fjalët e vajzës, që e ftoi për ushqim... Ndoshta truri i kishte bllokuar vatrat, ku trupi dërgonte kërkesat për ushqim, për fjetje, për të folur, për të qeshur, për të qarë... Ashtu kishte berë truri. Tashti, një nga një truri po i çlironte vatrat dhe ai ndjente përsëri të qenit njeri... Pas ngrenjës vajza e mori në dhomën e saj dhe ashtu zëmbël foli:

- Mua më flasin Vajza e Kapitenit. Qysh e vogël kështu më kanë folur... Po ti si e ke emërin?

Ai i tha emërin.

- Si? Djalosh i Dashuruar?! Si kuptohet Djaloshi i Dashuruar? - pyeti ajo duke i thithur sytë me sytë e saj.

- Djalosh i Dashuruar do të thotë! - foli djali i kënaqur me emërin e tij dhe me interesin që i kishte sjellë vajzës...

- Nga ky vend jeni?

- Nuk jam këtej, jam i ardhur...

- E flisni mirë gjuhën time... Nga kini ardhur dhe si u gjendët në këtë anëdeti?

- Jam nga Çmendina. E kini dëgjuar ndonjëherë?

- Nga Çmendina? - pyeti vajza, sikur diç dinte për këtë vend - sa emër i bukur Çmendinë! Babai im duhet ta dijë Ai i di gjithë vendet e botës... Po pse u gjendët këtu?

- Është histori e gjatë dhe e frikshme... Nuk është për ju.

- Mirë si të doni... Tashti do t'ju le vetëm. Kini nevojë të shlodheni. Te ky shtrat pushoni. Është dhoma ime, nuk guxon të hyjë kush - foli vajza dhe doli, duke marrë buzëqeshjen me vete...

Djaloshi i Dashuruar u shtri dhe gjithë trupi i ra në gjumë. Nuk dihet sa fjeti... Kur u zgjua, anija ishte në lundrim, në mes të detit, në udhët, që i dinte kapiteni...



Vajza e Kapitenit nuk i kishte jetuar akoma të gjashtëmbëdhjetat... Ishte fëmija e vetëm dhe e përkëdhelura e të tatit Ishte e çmendur pas detit. Më tepër kishte ecur përmbi dallgëdeti se në udhët e qytetit. Në gjithë udhëtimet rinte në kuvertë apo në Urën e Komandimit, pranë timonierit e shturmanit, që drejtonin anijen, me ato mjetet llogaritëse... Kapiteni rrallë dilte në Urën e Komandimit. Më tepër mbetej në dhomën e tij, duke dhenë ndonjë komandë, apo urdhër të rëndësishëm... Aty, kapiteni lexonte libra, nga më të ndryshmit, por më të preferuar kishte librat historikë e ata të lundrimit... Edhe vetë diç shkruante, në disa blloqe të trashë, me kapakë meshini në ngjyrë funddeti...

Kapiteni kishte mbaruar Shkollën e Detarisë dhe për shumë vjet kishte shërbyer në nënëdetëse... Pasi mbaroi njëzetë vitet e detyrueshëm të shërbimit nënëujor, e kishin transferuar në Flotën Luftarake Mbiujore, por ai nuk e kishte pranuar detyrën e re: "Ja në, ja ëndetëse në pension!" - kishte këmbëngulur kapiteni. Dhe pse i ri në moshë, kishte dalë në pension, sipas ligjeve të detit Por detin nuk e kishte braktisur... Bleu këtë anije të vogël turistike dhe së bashku me vajzën, bënë udhët nëpër dete, ku shfaqeshin e fshiheshin bukuritë...

\* \* \*

Vendi, ku u ankorua anija, ishte një ishull i bardhë si një guaskë e stërmadhe, dalë nga deti dhe mbetur ashtu mbi ujë... Edhe banesat si të lara me qumësht dukeshin.. Edhe rrugët si rruaza të bardha...

Një bardhësi e tepërt ose mbibardhësi, si të donte të fshihte të keqen apo t'i verbonte gjithë të ardhurit, për të mos parë se ç'ndodhte brenda" ishullit-guaskë"...

Emërin nuk e kishte "Ishull i largët" dhe nuk ishte në fund të botës, si mund të mendohej kur i flitej ky emër. Shumë mirë mund të quhej "Ishulli i Bardhë", se i bardhë ishte, por ja

që dikush e ka folur "Ishulli i largët" dhe ashtu i mbeti... Turistët vinin, pushonin e iknin pa e vrarë mendjen për emërin...

Banorët vendas ishin të paktë :pronarë a shërbëtorë vilash.Për çudi, nuk të shihte syri as makina e as policë...Vetëm qentë ishin me të tepërt,nga të gjitha vendet e nga të gjitha racat...

Anija u ankorua në portin e vogël të ishullit dhe bredhësit e qejfit,zbritën nga anija e nxituan për tek vilat,që i kishin porositur muaj më parë...

Ishte mbremje,në të perënduar të diellit.Qielli ishte krejt i kthjellët sikur asnjëherë të mos kishte mbajtur reshiu e gjëmime...

Djaloshi i Dashuruar mbeti në anije atë natë së bashku me Vajzën e Kapitenit,edhe pse aty lart,po të ngjitnin treqind shkallët e gurta,i priste një vilë dykatëshe,si fole dallëndysheje...

Kur e kishte parë,para pesë vjetësh,vajza i kishte thenë të jatit:"..Sa e bukur!Si fole dallëndyshe... Unë e dua për gjithmonë...". Dhe kapiteni e bleu vilën.Qysh atëhere u shtuan udhët e detit për në "Ishullin e Largët". Vajza e Kapitenit ngjitej tek "Foleja e dallëndyshe", me sytë nga deti,dhe qielli e deti ishin të sajat...Por atë mbremje nuk nxitoi t'i ngjiste shkallët e gurta si gjithmonë...E kishte një arsye që nuk i ngjiti ato shkallë...Gjatë lundrimit,kur Djaloshi flinte si i vdekur,ajo mendonte duke i zgjedhur mendimet.Asnjëherë nuk kishte menduar kështu.Mendonte,ëndëronte e fliste me vete,në një dialog të stisur. Nuk duroi dot sa të zgjohej ai e të vazhdonte bisedën...Kurrë nuk kishte takuar një njeri të tillë,që të fliste aq bukur,në gjuhën e saj e të ishte nga një vend me një emër të çuditshëm Çmendinë...E të kishte mbriritur në atë bregdet...E të rrinte kokëulur mbi atë gur...E të kishte " një histori të gjatë e të frikshme",që akoma nuk e kishte thenë...

Ajo nisi të dialogonte me veten e saj,si të fliste me Djaloshin :

Ajo: Unë do të vij tek Çmendina tënde,më pëlqen!...

Ai: Pse të pëlqen?

Ajo: Nuk e di,por do të jetë e bukur Çmendina!...

Ai: Ti nuk e ke parë ndonjëherë...

Ajo: Ja të shoh ty.Një vend i bukur ka njerëz të bukur...

Ai: He,njerëz të bukur...Ku e sheh bukurinë?

Ajo: Ja,aty brenda syve,brenda buzëve,brenda fjalëve...

Ai: Ku i ke lexuar këto ?

Ajo: Nuk i kam lexuar,janë fjalët e mija. Nuk i them kot kur s' dua t'i them...

Ai: Po tjetër?

Ajo: Nuk di tjetër...Edhe historinë tende nuk e di...Ma trego të lutem...

Ai: Eshtë histori e gjatë dhe e frikshme...

Bënte dialog e vetme,por imagjinata nuk e kapërxente dot murin e atyre fjalëve,që ai i kishte thenë nëpër dhëmbë:" Eshtë histori e gjatë dhe e frikshme...".Zilja si zë dallëndysheje e telefonit celular,ia prishi mendimet.Dikush i telefononte s'dihej nga...

### *Merimanga*

*Madama Hi-Fi*,sa kishte shkelur në Ishullin e Largët,të gjitha i donte me të tepërt e nuk ngopej me to.

Ndjehej e fuqishme për të përballuar një parregullsi jete.Netët e ditët ishin vetëm të sajat.Luante sipas qejfit me netët e ditët...Orët nuk i përfillte fare...I lodhte e i lodhte orët,i dehte e i shtrinte,i linte pa gjumë e i lëshonte bregut të detit të numëronin yjet,i fuste orët e ditëve në një dhomë pa dritare,që të mos shihnin as diell,as hënë...Edhe vizitorët e rinj,që sapo zbrisnin në ishull,ajo donte t'i fuste brenda orëve të saj e pastaj t'i shpërfillte...

Nga gjithë të zbriturit e asaj anijeje,njëri iu duk më interesante.Me një herë thurri rrjetën e merimangës,ose më mirë e zgjodhi,se ato rrjeta i kishte thurrur e stërthurrur për 101 kapje e stërkapje...Sa zbritën nga anija,ajo i qëlloi me sy,që të dy,Djaloshin e Dashuruar dhe Vajzën e Kapitenit.

Edhe të nesërmen përsëri bashkë.Si t'i ndante? Kur e shihte që "Kunadhja"siç e quajti ajo Vajzën e Kapitenit,nuk i ndahej asnjë çast " Tigrit",siç iu shkrep ta quante Djaloshin e Dashuruar,ndizej përbrenda tërë inat...Dhe inati i Zonjës me Sy të Kuq nuk shuhej as në gjumë ." Për tre ditë Tigri duhet të bëhet i imi,dita e katërt është vonë!...Ditët e tij do t'i kem unë në dorë e jo ajo Kunadhja...Ato që ka ajo i kam edhe unë,bile edhe më të mira...Unë tashti ndjehem 16 vjeçe me 26 vjet përvojë...Të gjithë meshkujt i kanë larë me lotë gjunjët e mi,pastaj i kanë lëpirë lotët e tyre.Edhe ai budallai, që kam rojë...Ia futa mustaqet ja,këtu tek bytha..." Më mirë vdes se të zhvishem lakuriq para një femre" donte të thoshte,por unë s'e lashë as të fliste e as të kishte brekët që mbante në pallat...Ia hoqa brerkët e ia hodha në zjarr...Vetëm mua nuk m'i ka hequr kush brekët. I hoqa vetë kur desh qejfi im...Edhe atë ditë nuk ia lashë atij djalit .Sa iu dhashë, tek brekët i hodhi duart...I hoqa vetë dhe nuk i veshamë...Meshkujt nuk janë tallur e nuk do mundin të tallen dot me brekët e mija...Dita e tretë duhet të jetë dita ime...Por si t'i ndaj? Ata rrijnë gjithmonë bashkë.Ajo Kunadhja ndaj ka ardhur në këtë ishull,që të bejë qejf me të,por unë do t'ja rrëmbej...Nga do të jetë ky Tigri? Që është tigër,tigër është,këtë s'e luan topi. Por tigra ka kudo e s'dihet nga ka ardhur...Për të folur përdor gjuhën e dollarit,por këtë gjuhë e përdor gjysma e botës...Gjuha e dollarit dhe gjuha e djallit është gjuha e të gjithëve.Eshtë gjuha e atyre,që duan të jetojnë..Të mos dish këtë gjuhë nuk vjen dotë në këtë ishull...Ja,pse nuk erdhi Xherahu?! Se nuk fliste dot gjuhën e dollarit e gjuhën edjallit.

“ Jo-thoshte-edhe Djalli të mësojë gjuhën time!”...Nga më erdhi në mend djalli,që djalli e marrtë!”Ndezi një cigare,ktheu një viski dhe vazhdoi të ndiqte nëpër tru udhët e merimangës...

“...Ai...Ajo...dhe qeni...ose Ajo,Ai dhe qeni...ose Qeni...dhe ata të dy...Kjo harmoni duhet prishur që Tigri të bëhet imi...Asaj i duhet varrë qeshja...I duhen njomur sytë me lotë...I duhet lidhur fjala...Si m’u kujtuan këto shprehje,nga libri,që e kam lexuar qysh vajzë?! Çudi si më erdhën në mend?! Po unë si do t’i thoshja këto fjalë po të mos i gjente truri ku ishin fshehur? Ja si do t’i thoshja:” Ditën e tretë Kunadhja nuk duhet të qeshë,por të qajë!” Po si? Duhet varrë qeni.Kur ajo të qajë qenin unë do të ul në gjunjë Tigrin!” Sa e mendoj planin e vrasjes së qenit thirri Komandantin e rojave dhe i dha detyrën: “ Urdhëri juaj,dëshira ime”-lëshoi nëpër dhëmbët e krimbur këto fjalë Kryekomandanti...Sa herë merrte ndonjë urdhër të rëndësishëm(që për të gjithë urdhërat ishin të rëndësishëm)përsëriste:”Urdhëri juaj,dëshira ime”.Pastaj e dinte ai si duheshin bërë punët.Duart e tij e dinin...Ato duar kishin zenë kallo nga “ Urdhëri juaj dëshira ime”. Xherahu ulërinte! Ai:”Urdhëri juaj dëshira ime”.Kali hingëllinte! Ai:” Urdhëri juaj ,dëshira ime”. Zonjës i ngriheshin gjinjte nga inati! Ai: “Urdhëri juaj,dëshira ime”.Dhe duart e zbatonte detyrën ,me aq lehtësi,sikur me to të hante një copë bukë,apo të ndizte një cigare...Por vrasja e qenit ndryshonte.Zonja,për herë të parë i kishte thenë:”Dhe varrin e qenit ti do e hapësh!”...Këtë ai e dinte,vrasja edhe duhej varrosur...Varrosja e vrasjes shpërblehej dyfish ...Pse ia tha Zonja ato fjalë?“Dhe varrin e qenit ti do e hapësh!”...Mos dyshonte tek aftësia e tij besnike?“ Ka ndryshuar krejt Madama,që kur ka ardhë në këtë ishull...Por ç’më duhet mua të vras mendjen? Po Po vrava mendjen nuk e vras dot qenin...Hajd mor kryej detyrën !”....

\* \* \*

Duke hapur varrin e qenit Kryekomandanti vuri dhe trurin në punë: “ Më mirë të jesh qen në këtë botë...Po unë?! Qenit i shërbente Zonjusha,unë i shërbej Hi-Fisë...Zonjusha më paguan mirë për t’i varrosur qenin...pfff...

Po mua kush do të ma hapë varrin?! Pa varr do të mbetem e do të më hanë shgabat...Po lotë kush do të derdhë? ...Lotë? As mos e folë!Ku ka lotë për mua?!

E,ç’i dua unë lotët?!Unë me lotët e njerëzve kam larë bythën...Ah ky varr këlyshi më bëri të shqvej mëndjen 100\$ më dha Zonjusha për ta çelë,pastaj do e mbuloj këlyshin,duhet prapë të paguaj.Pfff...Mirë qenka me qentë,më mirë se me njerëzit...Por unë s’kam çelë kurrë varr.Varret i çelnin të tjerët.Unë vetëm kryeja detyrën,vrisja dhe varrosja vrasjet...Ohu,janë fjalë të ngatërruara këto...Xherahu i di mirë...Unë:Një,dy tre,pesë zhashtë...dhe merrte fund ajo,që duhej të merrte...Duart e mija nuk dijnë të flasin.Ato vetëm bëjnë...Edhe varr qeni...Në këtë shkëmb buzëdetit e bëjnë...Pas këtij varrkëlyshi ç’do të bëjnë?...E di Hi-Fija...Po qenin pse e vrau?! Ç’i bënte qeni?! Qentë më dhimben...Ee,ku do i mirrja unë 100\$ po të jetonte qeni?!... Pfff...Ky varrkëlyshi më bëri të shqvej mëndjen “.

### *Varri i qenit*

Sa pa Kryekomandantin,Djaloshi i Dashuruar,u rrëqeth në gjithë trupin.Gjaku iu ngjiti i gjithi në fytyrë e në sy i rrodhën dy pika lotë të nxehtë,që nuk benë më poshtë se buzët e trasha...Asnjëherë nuk ishte ndjerë kështu.Para syve të tij,si të shihte vetë vdekjen të dalë nga dhéu...

Ai nuk e njihnte frikën,bile argëtohej me atë,që quhej frikë.Moshatarët i kishin zili trimëritë dhe guximin e tij,e jo vetëm moshatarët,por edhe burrat mustaqethinjur.

Djaloshi i Dashuruar e mbante guximin nën qerpikë...

Kur akoma s'kishte mbushur të pesëmbëdhjetat,bëri atë,që nuk kishte ndodhur kurrë në Çmendinë:

Ishte natë dimëri,në prag të Krishtlindjeve...Basti i asaj nate ishte më i vështiri. Qielli shqyhej nga vetëtimat dhe shiu s'dinte nga vinte e ku vente...Tek shtëpia e Gjahtarit të Derrave,ishin mbledhur më trimat e më të pafrikëshmit,për të marrë pjesë në bastin,që organizohej çdo vit,në pritje të lindjes së Krishtit.Gjahtari i Derrave ishte kryetari i kësaj pune.Edhe çmimin për fituesin ai e caktonte.Në atë garë trimërie më tepër kishte vlerë nami se dhurata,që do të fitohej.Pjesëmarrësit në garë,ishin djem deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeç.Më të rriturit nuk lejoheshin të merrnin pjesë në garë.

Djaloshi,në atë vit,nuk i kishte mbushur akoma të pesëmbëdhjetat,por frikën ia kishin të gjithë. Edhe një vit më parë ai e kishte fituar bastin. Kishte vajtur tek "Përroi i Xhindeve" e aty,në kamaren e kroit,kish gjetur një kalli misëri.Duhej të numëronte kokrat,duke i shkoqur një e nga një e të linte vetëm misërishten e zhveshur,në kamaren e kroit.Përroi i Xhindeve ishte i frikshëm edhe ditën e,jo më pas mesit të natës...Vetëm Djaloshi e mori guximin dhe e fitoi bastin,duke i lenë të turpëruar më të rriturit...

Por Përroi i Xhindeve ishte asgjë para asaj,që kishte zgjedhur Gjahtari i Derrave për atë natë....Sa i dëgjuan kushtet djemtë u panë sy më sy,në heshtje,pa guxuar të shpreheshin...

" Një kafkë njeriu e dua këtu mbi tavolinë! ",kishte përplasur për herë të parë buzët Gjahtari i Derrave,duke ndezur çibukun.Të shtatë djemtë u përtypën në heshtje...

-Hë,nuk jua mban?! Ja tek është edhe stilografi i florinjte-dhe nxorri nga xhepi i brendshëm i palltos,një kuti të zezë,që

mbante brenda stilografin e floringjtë.

Përsëri heshtje.

-Ëpo, me shurrancë nuk bëhet basti. Pse kini ardhur atehere?!

-Ku ka baste me kafkë të vdekurish-fole njëri, që nga trupi dukej më i madhi...

-Pse ç' do ti? Copa lakrori me thela mishi do? Ato kërkjoja satërme pasnesër. Këtu është bast trimash... Pastaj, këtë stilograf nuk e mban dot kushdo.

E nxorri stilografin nga kutia e zezë. Stilografi shkëlqeu me një dritë të lakmueshme.

-Shkoj unë! -fole Djaloshi.

-Nuk janë koqe misëri, por kafkë të vdekuri-fole me inat më i rrituri. Të tjerët donin të qeshnin, por nuk e bënë dotë qeshjen... Kishin edhe frikë edhe inat... Të hyje në dhomën plot me kocka njerëzish, në errësirë e aty të gjeje një kafkë njeriu, e kafkën ta merrje e ta sillje mbi tavolinën e Gjahtarit, ishte më e pamundura. Edhe i çmenduri do të kishte frikë...

"Po këtë mos e ka lenë mendja?" -Pyesnin veten të tjerët dhe sytë u ndizeshin nga inati e zilia... "Apo do që të mbetet i ngrirë..." Edhe tek Përroi i Xhindeve nuk ishte e lehtë, por të hysh në oborrin e varrezave e të hapësh derën e të vdekurve?! Këtë s' e ka bërë njeri ditën e jo natën..." -Kështu mendonin djemtë.

-Hë, ka të tjerë? -pyeti Gjahtari -po të ketë të tjerë do ta hedhim me short, kush fiton për të hyrë në varreza...

"Të dal dhe unë, mbase nuk më bie shorti për të vajtur" -mendonte më i rrituri... "Po sikur të më bjerë mua?! Jo, jo! Le ta hajë kokën ky trimi i përroit..."

Djaloshi sytë i kishte mbërthyer tek stilografi i floringjtë, pa menduar asgjë, se si do e bënte atë, që kishte marrë përsipër të bënte. Varrezat ishin rreth gjysmë orë larg. Për një orë duhej të vinte kafka mbi tavolinë. Shiu s' dinte nga vinte e ku shkonte...



Vetëtimat shqyenin qiellin...Djaloshi ia dha vrapit i ndjekur nga vetëtimat...I lagur i gjithi e i djersitur hyri në oborin e varrezave. Aty e ndali vrapin. U mbush me frymë dhe fshiu djersën e lagur nga fytyra...Dera e dhomës së të vdekurve ishte e pa kyçur. Një grep teli e mbante të tërhequr.Zakonisht,në dhomën e të vdekurve,ose në dhomën e të treturve,se aty kishte vetëm skelete njerëzish,nuk hynte kush. E shtyu derën prej druri,me kërcitjen e kockave,që lëvizën nga brenda.Një erë e pazakontë i bllokoi frymën...Edhe errësira ia zuri sytë...Vetëtimat,që shqyenin qiellin dhe era me shi,kishin mbetur jashtë asaj dhome të treturish...Aty brenda ishte një mal me eshtra,që ishin nxjerrë nga varret,në kushedi sa vite,për t'u zëvendësuar nga breza të tjerë të vdekurish...Një mal me kocka qindravjeçare dhe Djaloshi,në atë dhomë të errët me erë mbytëse...

Nisi të kërkojë me duar,për të gjetur ndonjë kafkë njeriu,por duart i zinin kocka të gjata këmbësh e krahësh, apo brinjë shpuese...Rrëshqiste e ngrihej prapë,duke u ngjitur me duar e gjunjë....“ Hë,e gjeta!”- i tha vetes,kur duart i kapën një gjë rrumbullake.Ishte një kafkë e vëretë,disi e madhe,por rrëshqiti përsëri dhe kafka i rrëshqiti nga dora e u rrokullis,si për të gjetur eshtrat e tjera nga e kishin rrëmbyer....” Tpu!” donte të shante ai me ndonjë fjalë sharëse,por e mblodhi veten,kur mendoi se ishte në vendin më të frikshëm e më të pa përshtatshëm për të sharë...

-Mos më merr se do të vdesësh...do vdesësh...!....

-Ikë...iikëë,sa nuk ke mbetur i ngrirë...!....

-I mallkuar!...I mallkuar!....Mos më prek...!”-...dëgjonte ai disa zëra të prishur. Zërat dukeshin sikur dilnin nga nëndhéu...Djaloshi u dridh për një çast,por pastaj e mblodhi veten...” Të bëhet ç’të bëhet!”- mendoi,” unë nuk iki pa gjetur kafkën..”. Në fund të këtij mendimi,duart i zunë një kafkë tjetër. “ E gjeta “ -foli ai me zë pa u përmbajtur.

.-Mos e merr se do të vdesësh!- u dëgjua përsëri një zë i

prishur...

-Unë një po marr,ju keni plot këtu-fole Djaloshi dhe për siguri,e futi kafkën nën bluzë.

Ishte një kafkë e vogël.Ndoshta e ndonjë ishmoshatarit të tij.Me kafkën në gjoks, doli nga dhoma e të treturve dhe ia dha vrapit për të arritur kohën e bastit...

Si këto trimëri të çmendura Djaloshi kishte bërë sa e sa,deri sa rrëmbeu dhe Syzezën...Qysh nga ajo marrëzi dashurie e folën *Djaloshi i Dashuruar*...Por pse u dridh kur i zunë sytë Kryekomandantin?!

Atë bishë me mustaqe kush nuk e njihte! Vetëm ai nuk njihte njeri,veç Xherahut e Hi-Fisë.Bile edhe rojat e pallatit nuk i njihte...Kujtesa e tij ishte fshirë për racën njerëzore...Djaloshin e Dashuruar nuk e njihte që nuk e njihte. Por pse pastaj ai u dridh sa e pa?!

Nga frika? Jo! Nga urrejtja? Mbylli sytë një çast,sa pa atë shëmtim vdekjeje. "Njeriu i 101 krimeve gjendej përballë tij,në atë ishull,ku vdekja bridhte udhëve e qeshte me jetën...Dhe tashti,qetë-qetë po hap varrin e qenit...O Zot! Akoma po hap varre ky njeri?!" - Ndjeu një goditje në tru e gjoksi iu mbush me neveri sa i erdhi për të vjellë..." Si mund të jenë duar njeriu ato duar?!

*Si mund të jetë njeri ky njeri,që kënaqet kur hap varre?!*  
*Njerëz të tillë nuk duhet të mbijnë në bark të nënës...*  
*Si ka mundur të vijë gjer këtu? Bashkë me atë Zonjen e pallatit do të ketë ardhur...Kanë ardhur të fshehin krimet e më shumë se krimet...Eh,botë e djallit!Në këtë botë jeta është pronë e kriminelit...Paraja është pronë e hajdutit..Nderi është pronë e të pandershmit...Eh,botë e djallit! Si u përplasa ,në këtë ishull,ballë përballë me këtë djall?! Këtu do t'i lajnë gjynahet! E,ku lahen gjynahet e tyre?! Gjithë lumenjtë e Çmendinës nuk i lajnë dot...*

"Do e shpie trimërinë aty ku duhet" i thashë Hotelierit kur

u ndamë...Dhe nuk më la krejt jetim fati,më hodhi në këtë ishull...”

Ceremonia e varrimit të qenit u zhvillua sipas parashikimit të Madamës Hi-Fi: me lotë,lule,heshtje.Në ceremoni,në qoftë se mund të quhet e tillë,morrën pjesë vetëm Vajza e Kapitenit dhe Djaloshi i Dashuruar.E,kush mund të ishte tjetër?! Edhe Kapiteni,që mund të ishte,kishte nisur udhë me anijen e bardhë...

Djaloshi i Dashuruar rrinte në krah të Zonjushës,i humbur,brenda vetes,pa patur mendjen tek qeni,që po varrosej...Vajza e Kapitenit kishte nevojë për praninë e tij dhe ndjehej më e qetë kur i prekte gishtat apo i ndjente frymëmarrjen e nxituar...U bënë gjithë zbukurimet e mbivarrit,sipas porosive të Zonjushës,dhe ceremonia mbaroi...Qeni i bardhë e i pafajshëm mbeti në dhé,aty,nën dritaren e vilës si fole dallëndyshe...Ai,që e vrau,që i çeli varrin dhe ,që e mbuloi, morri dollarët nga duart e dridhura të Zonjushës dhe iku...Vajza e Kapitenit,e shoqëruar nga Djaloshi i Dashuruar,hynë në dhomën e katit të sipërm,që shihte nga deti, të heshtur,por jo në mendim të përbashkët...

Mendimi i Djaloshit bashkonte e veçonte ngjarje.Shronte udhë të reja truri dhe zinte shtigje,përballë Kryekomandantit,që iu shfaq befas dhe Madamës Hi-Fi,që ishte e pa shfaqur akoma...Djaloshi donte ta shihte sa më parë atë fantazmë të bukur,që kishte marrë me vete gjithë të vërtetat dhe gënjeshtat e asaj jete, e atij vendi,ku nata e dita mallkonin njera-tjetrën...” Fati më solli në këtë ishull”- i tha vetes Djaloshi,”- tashti me mendjen tënd e me duart e tua ta gatuash fatin,që koha të mos mbetet tek ajo ditë e mallkuar...T’i jap,sadopak,nder vendit tim të përdhu-nuar...Po Zonja e pallatit ku do të jetë?!Me ç’emër?...Me ç’fytirë?...Të gjitha do t’i zgjidh si duhet dhe kur duhet!” ,siguroi ai veten pa dalë nga udha e të menduarit...

### Trutë e bletës...

Në pasditen e asaj dite,Zonja me Sy të Kuq i ra ziles të portës së vilës. Nuk u ndie kush. Ajo i ra e i ra prapë deri sa dera u çel dhe përballë saj doli ai djaloshi,që ajo e quante Tigëri.

Të dy:mashtrimin e shpirtit e nxorrën tek sytë dhe fytyrat morrën pamje të gënjeshtërtat:të qeta e mirëdashëse...

Zonjës me Sy të Kuq:iu ndezën sytë nga epshi i paramenduar dhe flaka e syve i rrëmbeu gjithë fytyrën, mollëzat e faqeve ,buzët, nënbuzët,gushën e më poshtë,andej nga s'hynte syri...

Djalioshit të Dashuruar:i pëlqeu ky takim i pa pritur dhe kur vërejti flakërimën e Hi-Fisë,mendoi:" Fati s'më ndahet,do ta kem më të lehtë"...

Madama Hi-Fi:nuk e njihte dhe nuk dinte për Tigrin,që i pëlqente dhe as nuk donte të dinte më tej se ajo bukuri mashkullore. Ajo donte ta fuste në orët e në ditët e saj,ta ulte në gjunjë e të lëpinte lotët...Ajo donte.Dhe çfar donte e bënte.

Djaloshi i Dashuruar: dinte shumë për Zonjën me Sy të Kuq,për Madamën,që qorroi pallatin...Dinte,por nuk i dinte të gjitha...Për habinë e saj,Tigri e pranoi menjëherë ftesën,vetëm me një ndryshim nga të tjerët,ai nuk pranonte askund veç shtëpisë së saj.

Në fillim ajo hezitoi,por pastaj i pëlqeu kërkesa." Tigri duket ndryshe nga të tjerët,ndaj kërkon ndryshe. Eshtë i ri,i bukur e i fu-qishëm...edhe sytë i ka të ndezur...Eshtë mësuar me atë Kunadhen,që loton për një qen...Kunadhja le të lotojë për qenushin se Tigrin do e kem unë...Do ta fus në mes të shalëve,do e djersij e do e shtrydh,e do t'ja ul hundën prej tigri mbi gjunjët e mi...Pastaj,kur t'i mbarojë djersja,le të nxjerrë

lotë dhe kur të më lëpijë 3000001 poret e trupit,që i di unë,le të lëpijë dhe lotët e tij që të shlodhet...Më mirë në dhomën time se bëj si dua e bëj sa dua...”.- Mendonte Hi-Fija dhe kënaqej që Tigri kishte rënë menjëherë në rjetën e saj...Njoftoi Kryekomandantin për ardhjen e Tigrin dhe dha urdhërat e nevojshme që të mos e shqetësonte askush...Përcakttoi kohën e sjelljes së ushqimit,ndërsa pijet e ngrohta e të ftohta ishin aty ku duheshin...Edhe ato, më të preferuarat e saj,pijet,që të ndezin gjakun e të lëvizin mishin...Për vete kishte pijen më të rrallë,ose “pijen e rinisë e të bukurisë”:**Trublete**.

“Trublete” ishte pija e saj sekrete,që e përdorte prej vitesh,qysh kur iu shfaq shëmtia e nisi t’i shuhej zjarri i nënlëkurës...Ku e gjente?E dinte vetëm ajo.Nuk e dinte as Kryekomandanti,as shërbyesja e kuzhinieri,pa le Xherahu,që nuk dinte edhe shumë gjera të tjera...

Zonja shkonte vetë në një vend dhe dikush i jepte një termues disakilësh,që mbante brenda lëngun e rrallë. Ai “Dikushi” nuk kishte as e mër e as fytyrë...Kishte vetëm duar,që jepnin e merrnin...Ai vinte, nga diku larg, së bashku me porosinë e Zonjës...Mbushte duart me dollarë dhe ikte e vinte prapë,ashtu,i pafytyrë e i paemër....

Zonja pinte çdo mëngjes troublete dhe ndjente kënaqësinë e të veçantës,të asaj që e kishte vetëm ajo dhe e përdorte vetëm ajo. Pas kësaj kënaqësie të egër, vinte rinia e bukuria,që do e mbanin “16 vjeçe me 26 vjet përvojë”,për të sunduar gjithë meshkujt e fuqishëm...

Edhe këtu,në Ishullin e Largët,ajo nuk e kishte harruar pijen e rrallë,bile e kishte më të lehtë gjetjen e tij. Vetëm ajo mund ta siguronte. Edhe mbretërit nuk mundnin. Të pije troublete duheshin arka me flori apo thasë me dollarë.

Ajo kishte dëgjuar se nga pija e saj,kishte përdorur një mbret nga një vend i largët e i largët në vite.

Çudia e trurit të bletës e bënte mbretin që të përdorte 900

gratë e tij të zgjedhura e prapë të kishte fuqi për të mbretëruar...Po ajo?! "Vetëm unë e përdor trurin e bletës,as ajo kunadhja,Vajza e Kapitenit, nuk mund ta përdorë...Ha, ha,ha...Njeriun e paemër e të pafytyrë kush mund ta paguaj veç meje?!...Ha,ha,ha,...Askush! Vetëm unë në botë.Edhe ai mbreti do e ketë dredhur se nuk ka qenë prej guri. Nuk ka më mbret,që të bëjë qejf me 900 gra...Vetëm unë!...Vetëm unë!...Të gjithë meshkujt,që shkelin në këtë ishull të mijtë janë!...Edhe ata,që do të vijnë...Të gjithë të bukurit e të fuqishmit...Ata,që më pëlqejnë do t'i fus mes shalëve dhe do të lëpijnë lotët e tyre...Ha,ha,ha...Ai vetëm të ulërinte dinte...Të ulërinte e të bridhte mbi kalë...Për ato jepte gjithçka edhe ato që s'i kishte...Hë! Unë e dua jetën!...Dua të jetoj si di unë: Të mbytem në qejf e pastaj ta mbysh qejfin...Edhe qejfin do e fus në mes të shalëve e do e bëj që të lëpijë lotët e tij...Ha,ha,ha,eee...Dhe qejfi do të lëpijë lotë . Ta shohim këtë Tigrin se ç'mall është?!...Edhe dy orë dhe do e shtrij në krevat e do t'ja zë frymën...Sa të vijë nuk do t'i le kohë as të marrë frymë, as të mendohet,as të flasë...Ta marrë vesh se ç'do të thotë trublete...Nuk më duhen mendimet e fjalët.I urrej njerëzit,që mendojnë e flasin!...Çfar dite është sot? E premtë. E premtë le të jetë...Ta mbajë mend mirë Tigri se ç'do të thotë e premtë...E premtëqejfi dhe lotësh...Ha,ha,ha...Pastaj, gjithë ditët e tij do të jenë të mijat...Ai nuk do të ketë më as ditë,as netë e as Kunadhe!

...Edhe dy orë dhe...

Të hyj dhe një herë në dush që kur të m'i lëpijë porët,ta ndjej gjuhën e tij deri nën lëkurë...Ha,ha,ha..."

\* \* \*

Tigri erdhi në orën që pritej dhe ajo bëri siç e kishte menduar.Jo tamam ashtu,por e kishte kënaqur trupin deri në përhumbe e rëndim qepallash. Për çudi,e kishte harruar aktin

e rënies në gjunjë e lëpirjen e lotëve. Kur meshkujt e qejfit arrinin në atë akt të detyruar, ajo arrinte në kulmin e kënaqësisë së saj të egër...

Por kënaqësia, që i kishte falur Tigri, e kishte bërë t'i harronte disa gjëra. E përhumbur e symbyllur, ajo vetëm lëvizte buzët në ngjyrëflake, me zgjatje e tërheqje muskujsh, pa formuar dot asnjë fjalëurdhër... Kur erdhi në vete dhe ngriti qerpikët, sytë ndjeheshin të shuar, pa atë dritën përvëluese... Buzët i lëvizi, por nuk iu bindën mendimit:

“Po lotët? Ku i ke lotët?! Gjuhën? Buzët?!”

Në vend të fjalëve të pathëna, lëshoi vetëm një “ooh!” kënaqësie a poshtërimi, e dinte vetëm ajo. Ose edhe ajo, në ato çaste, nuk mund ta dinte se ç' do të thoshte ajo “ooh”, që lëshuan buzët e saj...

-Hë, u kënaqe?!

Ajo nuk iu përgjigj, dhe as nuk e priste një pyetje të tillë.

“Qenka ndryshe nga të tjerët ky Tigri”- mendoi, me dy ndjesi brenda vetes:

Ndjesia e parë: E fitimtares që kishte zgjedhur një ndryshemashkull. Me të gjitha ndryshe: edhe fuqinë mashkulllore, edhe shpejtësinë goditëse, edhe trupin muskulvrasës, edhe qejfin vdekjesjellës, edhe...

Ndjesia e dytë: E ironisë tallëse: “Hë u kënaqe?!”, që i qe përplasur mbi fytyrë sa kishte çelur sytë.

Me këto dy ndjesi, të pa ndara nga njëra tjetra, ajo e përsëriti edhe një herë mendimin: “Qenka ndryshe ky Tigri.”, -por nuk i bëri dot fjalët të dëgjoheshin: “Ky qenka i llahtarshëm, është njeri apo ç' do të jetë?”- i përsëriti vetes, me trupin të lëshuar si të pajetë dhe ndjeu vazhdim kënaqësie kur mendonte: “Nga të jetë?... Ç' rracë është? Më mbështolli e më kollofiti si të mos isha goxha femër... Fat të tillë asnjë femër nuk besoj ta ketë! Po Kunadhja si ka bërë me këtë Tigër e shkuar Tigrit?! ...Oooh! ...Oooh!”

S'besoj ta ketë provuar,se do të qante qeni për të e jo ajo qenin...Unë jam e para ! Vetëm unë"!....

### *Frika*

Kryekomandanti ndjehej çdo ditë e më i paburrëruar, më i harruar e më i papunë...

Ai,që gjithmonë ishte në qendër të punëve të rëndësishme të pallatit,që merte urdhëra e i zbatonte siç dinte ai,që në çdo orë të ditës e në çdo orë të natës, vepronte me ato duart plot kallo e me atë trup mishngjeshur,ai më besniku,që dinte ku ta varte torbën e besës e ku ta fshihte thikën e krimin,ai kryekomandanti me mustaqe të trasha,tashti ndjehej një njeri i kotë...Qysh kur shkeli në këtë ishull sikur shkeli në trojet e Djallit. Ters e më ters po i vente e "ters e më ters saDjalli ta marrë!" ...

Egërsia,që për vite,i lëvizte gjithë nervat e trupit dhe e bënte të fortë e të qëndrueshëm,tashti i rrinte struktur diku,në pritje të diçkaje...Trupi po i qullëzohej e kallot e duarve,si kurriz breshke,i ishin çarë e ai i kafshonte e i përtypte me nervozizëm...Egërsia,që i rrinte struktur,arrinte deri në kafshim e përtypte kallosh e përsëri fshihej në folenë e saj,brenda trupit,e trembur...

Ai,që dikur i rrëmbente edhe Djallit kafshatën,tashti kishte frikë edhe nga hija e tij...Ndjehej i gjithi i trembur,sa trembja i qe shfaqur edhe në gjumë,sikur dilte nga ato baulet e rënda dhe e zinte prej fyti, sa i zihej fryma...Trembja e tij kishte vetëm gishtrinj,nuk kishte fytyrë. Kishte vetëm gishtrinj të gjatë,që zgjateshin e i lidheshin rreth qafës e ai përpëlitej i djersitur e i tmerruar,pa guxuar të mbyllte më sytë për të fjetur...

Endrra nuk kishte parë kurrë në jetën e tij dhe nuk e dinte se si ishin endrrat e gjumit.Për herë të parë i ishin shfaqur në gjumë,ato katër baulet bosh,nga ku dilnin ata gishtrinjtë e



gjatë,që donin ta mbysnin... Ai ishte i pafuqishëm të shpjegonte ato pamjegjumi dhe i pafuqishëm të shpëtonte nga mbytja e atyre gishtrinjve...Sa hapte sytë,për t'i shpëtuar të keqes,i vinin në vesh ato fjalët e Zonjës,që ia tha kur ai kishte mbetur pa brekë:" *Këtë mos e harro kurrë!*".. I ndjente si helm në vesh ato fjalë dhe helmi i hynte brenda në gjoks...Ai,që ishte i zoti të rriste, në gjoksin e tij, një tufë gjarpërinjsh të egër,tashti ndjehej i pafuqishëm para atyre fjalëve me helm në vesh...Ai përpëlitej për t'u ngritur mbi helmin e për të mos vdekur...Merrte shishen e rakisë,që e mbante gjithmonë te koka, dhe e kthente deri në pikën e fundit,sikur donte të mbyste helmin e gjarpërinjve,dhe pastaj humbiste disa orë i fshehur brenda errësirës së trurit të tij.

### *Zgjuarsia e gjarpërit*

Gjarpëri ka zgjuarsi çasti dhe vepron me shpejtësi përbalë gjahut të tij.Edhe Kryekomandanti,përballë kundërshtarëve i kishte zgjidhur me një herë situatat në favor të tij... Sa herë e kishte shpëtuar ai kokën kur i ngrinin kurthe me çarkun te këmbët e me thikën tek fyti! I shpëtonte të keqes,pa e gjykuar si qe mpleksur ajo, në formë çarku,te këmbët e si thikë e mprehtë, tek fyti...Këtë veti ,të lindur,ia kishte zbuluar Xherahu,qysh kur ishin fëmijë dhe e kishte mbajtur gjithmonë pranë vetes...Sa herë niste ekspeditat e tij mbi kalë,nuk e lëshonte dot ulërimën gjer në fund,po të mos kishte Kryekomandantin pranë.Vetëm pranë Kryekomandantit ndjehej i sigurtë dhe ulërima i bëhej më tronditëse e më shurdhuese...Dhe Kryekomandanti i kishte dhenë provat. E,si mund të harronte Xherahu atë ditë,kur ai me zgjuarsinë e veprimit të sekondave,i kishte shpëtuar jetën !...Thika s'kishte arritur dot në fytin e Xherahut e s'ia kishte prerë dotë ulërimën...Kryekomandanti,që i rrinte gjithmonë pranë,i kish

kapur thikën dhe thikësin...Xherahu,jo vetëm s'e ndërpreu ulërimën,por ulëriti dhe më fortë,duke futur brenda saj edhe heroizmin e besnikut të tij të paprekshëm...

Kështu kishte ndodhur në një ditë pranvere...Dhe Kryekomandanti i rriste mustaqet,duke i shpëtuar të keqes vetë e duke shpëtuar edhe ata,ku " kishte varur torbën e besës"... Por koha kishte rrjedhur si përrua dhe i kishte shkukur gurët,në rrokullimë,sa dhe zgjuarsia e tij prej gjarpëri,ishte fshehur ,diku,në errësirën e trurit e nuk i hynte më në punë...

...Dhe madama Hij-Fij(siç i fliste ai) rrinte e mbyllur me atë "Djalin e Detit"...Dhe katër baulet e mëdha rrinin të boshatisura në atë dhomën e boshatisur...

...Dhe ai, Djaloshi i Detit, e kishte parë si i tërbuar,kur ai hapte varrin e këlyshit...Dhe...Ai ndjente çdo ditë helmin në vesh e çdo natë gishtrinjtë mbytës...Dhe mbahej nga shishja e rakisë,që e pinte deri në kombin e fundit,pa marrë frymë fare...

### *Hoteli i gjarpërinjëve*

Ishulli i Largët ngrihej mbi një shkëmb të stërmadh,apo mbi një mal në mes të detit. I gjithi ishte i veshur me shtëpi të bardha,me dritare të mëdha,që shihnin andej nga lindëte e perëndonte dielli...Gjelbërimi mungonte.Veç luleve të ballkoneve,asnjë vend tjetër s'kishte,ku mund të mblidheshin zogjtë e të këndonin duke bërë jetë zogjsh,punë zogjsh e qejfet e tyre...

Nga ana e limanit,nga vinin e iknin anijet me pushues,zbrinsnin e ngjiteshin 300 shkallët e bardha.Gjithë të ardhurit do të ngjiteshin detyrueshëm në ato 300 shkallë,së bashku me qentë apo macet e tyre të shoqërimit...Nga e prapma e ishullit,nuk kishte udhë hypse e zbritëse për njerëzit. Vetëm zvarranikët kishin udhët e tyre...

Udhëve të kalldremit të ishullit, të zinte syri mace e qen, që lëpiheshin e shtriheshin, nën hijet e portave; por edhe minj barkalecë, ngjyrë hiri, sikur mbi lëkurën e tyre të ishte shkrire ngjyra e nëndhëut me ngjyrën e bardhë të gurëve... Macet e portave u hidhnin nga një sy minjëve, që hynin e dilnin, diku nga errësira, dhe qëndronin indiferente, pa sekretuar pështymë, sikur të mos i kishin më ato gjendra pështyme për ushqim minjsh... Edhe qentë nuk ishin më pak indiferentë. Rrinin të qetë e në paqe, me macet e mes tyre, vetëm kur u hypte qejfi në tru, lëshoheshin pas bishtit të qenushkave e ngjiteshin, për të mos u shqitur ditë me rradhë... Kështu bënin qentë e macet e rrugëve, kurse ndryshe ishin ata që i mbanin në krahë e në prehër zonjushat e zonjat. Ata ishin më të privilegjuarit e më të rrobëruarit. Ishin zotër e robër të zonjave të tyre. Dilnin nga portat me zonjat dhe kur donin ato. I shihnin me zili qentë e shtrirë anës udhëve, që nuk lëvbiznin as majën e bishtit për respekt të ishzonjave të tyre të braktisura... Dikur edhe ato mace e qen rrugësh kanë qenë rrobër të qejfeve të zonjave. Ata ose të parët e tyre. Por, të dalëqejfi e të braktisur, ata mbetën përsëri në lirinë e racës së tyre...

Në periferi, ku shkëmbinjtë nuk mbanin shtëpi mbi shpatulla, ishin zotër zhapinjtë e gjarprinjtë. Ata jetonin në botën e tyre të zvarritjes, larg syve e djersës së njerëzve. Dilnin nga të shqyerat e shkëmbinjve, ku kishin foletë, për të siguruar ushqimin e ditës dhe pse jo, edhe për të luajtur, duke u përdredhur e duke kërcyer, siç kanë luajtur qysh nga koha e Kopështit të Edenit...

Loja e tyre nuk mbetet pa vizitorë... Edhe Kryekoma-ndanti që ulur disa herë përballë gjarpërinjve, kur mezi i shtynte ditët, i papunë e i harruar... Ulej përballë gjarpërinjëve, sa hutohej dhe harronte të dridhte cigaret e trasha. (Kishte hequr dorë nga ato cigaret bythëpambukta me ata emrat "Princ" apo "President") Shihnte si hidheshin e përdridheshin gjarpërinjtë e gjarpëruset

dhe qeshte me zë, duke lëshuat copa pështyme nga dhëmbët e pa larë... Vetëm shishen e rakisë nuk e harronte. E kthente i epshuar dhe qeshte me qejfin e gjarpërinjve, pa i hedhur sytë për rreth ku rrinin, shkujdesur, zonjat e zonjushat e bukura. Ngrihej vetëm atëhere kur gjarpërinjtë zbrisnin tek foletë e tyre. Pastaj, i shtynte këmbët deri tek dhoma e tij e errët, sikur edhe ai të hynte në një fole gjarpërinjesh...

\* \* \*

Mbi gjithë ato vila të bardha, në krye, lart, ku nuk kishte më banim pushuesish, ngrihej një ngrehinë në formë kulle, me mure të gurtë e me çati drrasaguri, që ngjasonte me një kapele plazhi. Kulla kishte dy dhoma katrore me dritaret nga vallzonin gjarpërinjtë. Sejcila dhomë kishte nga një dritere dykanatëshe me xhama ngjyrëdeti, ku drita e diellit dhe e hënës, e zhvishte ngjyrën e saj, para se të hynte në gjysmëerrësirën e atyre dhomave. Dhomat brenda nuk kishin as krevatë, as karige, apo orendi të tjera si gjithë shtëpitë. Sa hyje, shkelje mbi pllakaguri të bardha, si të prera nga shkëmbi... Vetëm disa piktura me femra të lakuriqta e gjarpërinj të lakuriqtë, vareshin nëpër faqet e mureve. Ngjasonin ato femra me Gruan e Parë të Botës dhe gjarpërinjtë me të parin e gjarpërinjëve. Po të mos e dije se ç'ishin ato dhoma do të mbeteshe i habitur, por edhe kur merrje vesh se ato dydhoma quheshin "Hoteli i Gjarpërinjëve", përsëri nuk e shtyje dotë mendimin në të kuptuarit e atij emëri e të atyre pamjeve. Ky moskuptim ishte për të porsaardhurit, se Hoteli i Gjarpërinjëve bëhej tërheqës, deri në zili, për zonjat e zonjushat qejfteprta... Sa nuk merrnin vesh se ç'bëhej brenda atyre dydhomave, ato ngulmonin të hynin brenda, për të bërë edhe ato atë që nuk ua besonin veshët...

Paga ishte sa nuk thuhej dhe lista e të regjistruarave ishte sa nuk mund të numërohej...

Hoteli i Gjarpërinjëve rrinte i hapur vetëm në muajt e verës, kohë e pa mjaftueshme për të hyrë nga një natë gjithë femrat e regjistruara... Por si mund të iknin nga ishulli pa fjetur një natë në atë hotel?! Ato, që nuk e realizonin dotë endrrën, atë verë, mezi prisnin beharin tjetër, për të pushuar në Ishullin e Largët, që të flinin një natë në Hotelin e Gjarpërinjëve". Fjala ishte " *të flinin*", se ajo natë nuk mund të ishte natëgjumi... Ajo natë do të ishte ndryshe, e gjitha ndryshe nga netët e jetuara deri në atë natë...

Si do të ishte ajo natë? Askush nuk e dinte.

Ishte e pa treguar nga të gjitha ato femra që kishin hyrë në atë hotel... Dhe e paditur nga ato femra që mezi prisnin natën e hyrjes... Ajo ishte nata e misterit në jetën e tyre...

\* \* \*

*Madama Hi-Fi*, sa erdhi në ishull, u regjistrua e para për në *Hotelin e Gjarpërinjëve*. Dinte, qysh më parë, për këtë hotel, apo e mori vesh kur mbërriti në ishull, këtë nuk e dijmë. Nuk mund të themi arsyen e vërtetë të zbarkimit në Ishullin e Largët, me ato katër baulet e rënda e me Kryekomandantin e Rojave? Por Hoteli i Gjarpërinjëve u bë endrra e saj e mezipritur...

Kur u regjistrua emëri i saj ishte i 301-ti. Pas treqind e një netëve i vinte rradha për të fjetur, vetëm një natë, në atë hotel... Jo vetëm në atë verë, por as në tjetrën e tjetrën, nuk mund ta shuante endrrën e gjarpërinjëve... U hodh në një marveshje të fshehtë me drejtoreshën e hotelit, që t'i paguante njëqindfishin e çmimit, për t'i afruar numërin, por nuk i eci. Drejtorja ia kishte prerë shkurt: "I vetmi vend në botë pa korupsion është Hoteli i Gjarpërinjëve!"

Zonja ishte mërzhitur, në fillim, por pastaj sikur e kishte hedhur prapa kujtesës, apo prapa krahëve Hotelin e Gjarpërinjëve dhe

kishte vazhduar jetën e saj me qejfet e njohura, me meshkujt e ardhur nga deti...

“ Në djall dhe gjarpërinjtë! Sa të më vijë rradha e gjarpërinjëve unë plakem...Nuk do e le veten të plakem! Do mbetem 16 vjeçe me 27vjet përvojë! Do bëj jetën që dua!”  
Dhe si për inat të “ gjarpërinjëve”, nuk përmbahej me meshkujt...Me Tigrin akoma nuk po e shthurte dotë rretjen e merimangës...Ndjehej se vetë ishte në fund të asaj rjete. ...Ashtu ndjehej...Por kishte një shpresë edhe për “gjarpërinjtë”. Po sikur ndonjëra nga ato femrat e para në listë të vdiste, apo të pësonte ndonjë gjë tjetër, të ngjashme me vdekjen?! Dhe ajo, Zonja me Sy të Kuq, do ndërhynte, me agjentët e saj, tek drejtorja e hotelit dhe do t’ja arrinte qëllimit! Ç’far i qe tekur asaj e nuk e kishte bërë?!...

### *Gërhimia*

*Dera e mbyllur e dritaret e mbyllura, mbyllnin brenda errësirës, atë pasgërhimë...Askush nuk donte të dinte se sa ujëjete kishte brenda akoma ai pus i pistë. Brenda atij “pusi”, uji i jetës nuk ishte më ujë, por një qelbje erëqelbur, që merrte trajta gërhime të këputura copa-copa...Vetëm ato copa gërhime, që mezi dilnin nga plasat e derës, apo nga kanatat e dritareve, tregonin se, aty brenda, nuk qe tharë akoma ai pus i pistë...Jeta nuk e kishte emërin jetë, brenda asaj gërhime të këputur...Jeta e tij ishte e vrarë, qysh kur dora e tij kish vrarë të parën jetë të pafaj...Ishte i ri atëhere kur kishte bërë vrasjen e parë. Edhe vrasja ishte fshehur...Ai nuk mbante mend, por nuk mund ta harronte atë djaloshin njëzetë vjeçar, në atë mëngjes prilli...Pas asaj vrasje , të fshehur , u bë Kryekomandant në pallatin e Xherahut...  
Por erdhi dita që ai të ishte pa Xherahun e pa Zonjën...*

I mbetur i vetëm, vetëm me vrasjet e tij dhe i pajetë... Edhe "më i besuari", që i vinte çdo ditë në orën dhjetë të mbremjes, mallkonte veten, kur dëgjonta akoma, ato copa gërhime nga plasat e derës... Edhe macet e qentë e udhëve, nuk shkonin më nën ato dritare, deri sa në një mesnatë, ajo gërhimë nuk u dëgjua më....

### *Kënga e të vdekurve*

Duke iu afruar varrezave Hotelieri ndjente që t'i vinte në vesh një këngë... " Si është e mundur?!-mendoj -" Nga varrezat më vinin ulërime të dridhëshme, që të ngjallnin frikë... Ulërime e të vdekurve është më e llahtarshmja. Sa një milion klithma të qëna së bashku... Klithma të mbarrsura me urrejtje... Me urrejtje e jetë brenda... Ama, ç'them dhe unë?! Si mund të ketë urrejtje e jetë në klithmat e të vdekurve?! Nuk mund, por ja që ndodhi... Ajo, që ndodh është më e vërtetë nga ajo, që mendohet.... Ulërimat e varrezave ishin përmbysëse e të tmerrshme, por si u shuan e u bënë këngë?!... Mos vjen nga brenda meje kjo këngë?!

*" Xhirxhile moj Xhirxhile,  
je këtu a je atje ?!... "*

Nuk po e dalloj dotë. Nuk e ndaj dotë këtë, që ndjej brenda nga ato, që më panë sytë e më dëgjuan veshët...

Veshët më dëgjuan ulërime sa një milion klithmanjeriu bashkë... Dhe klithma është, më tepër, mallkim e hakmarrje. Edhe tërmeti klithmë e nëndhéut është. Një tërmet i të vdekurve ishte ajo ulërimë... Por kjo këngë ç'është? Nga vjen kjo këngë, që më mbushi të gjithin?! Pa ta dëgjoj mirë.."

*"...Xhirxhile, moj Xhirxhile,  
je këtu a je atje?"*

*Opopopo e o lele... Të tretëm të bëhem dhé....”.*

“Si? Të vdekurit këndojnë kështu?! Kjo është një këngë dashurie...Një këngë për jetën e për vdekjen...Dashurinë nuk e ndan dotë nga vdekja...Edhe kënga ashtu thotë: “ *Veç një natë me Mirë ty të fle / të tretëm të bëhem dhé...*”. bëjnë që e këndojnë të vdekurit këtë këngë dashurie...Më shumë ka dashuri të vdekura se njerëz të vdekur...

*“ Në mijëra luftra të njerzimit,  
milionë njerëz janë vvarë...  
por sa janë vvarë nga dashuria,  
që kur u shpik njerzimi vallë?!”...*

Po këto vargje nga më erdhën?! As i mendova e as i kërkova....Po. Edhe unë dashurivdekur jam dhe kam të drejtë të këndoj si të vdekurit e nëntokës..Sikur ta dinin dhe historinë time kushedi se ç’do të këndonin?! Gjithë ato vjershat e mia do t’i këndonin të vdekurit e do të çuditeshin të gjallët...Oh,u lodha me këto budallallëqe! Nuk rri e dëgjoj, i qetë,këtë këngë të bukur,që po më shpërthen gjoksin e më lëviz brinjët?! “ *Opopopo e o lele / veç një natë me ty të fle/ të tretëm të bëhem dhé*”. Lulet mbi varrin e tij, vallzonin harmonishëm. Hotelie-rit diç i erdhi ndër mend,që kishte të bënte me këngën e varreve,me lëvizjen e brinjëve të tij dhe atë vallëzim lulesh,por e mbajti mbërhyer në tru,për të mos dalë nga dëgjimi i këngës së Xhirxhilesë...

### **Flakët**

**Flakët** ngriheshin,zgjateshin,këputeshin e fluturonin deri në shuarje.Ishte mbrëmje pas perëndimit të diellit.Po digjej hoteli i vjetër,me kërcitje e këputje flakësh...Vetëm tymi s’dukej.Tymi fshihej, për të mos u dukur, në atë djegie të madhe...



“ Oh! Hoteli im po digjet...”-foli me zë të dridhur Hotelieri,sa pa flakët,që vallzonin në qiell...Ato fjalë i lëshoi me zë,pa i ndjerë nga i dolën,dhe pastaj heshti... Heshti në moslëshim tingujsh jashtë vetes,por brenda u mbush me gjithë flakët,që i shihte syri.Kush po digjej,hoteli apo ai vetë?! U ul mbi pllakën e varrit të tij,sikur donte të ndjehej rehat,në atë djegieflake...Flakët e hotelit nuk donte më t'i shihte. Ato nuk ishin më në qiellin e padiell..Ato flakë digjeshin, brenda tij, në një përvëlim të heshtur... Ai përvëlim flakësh i ndezi mendime të dhëmbura,që vetëm truri i tij mund t'i pranonte...

“ ...Mbaroi dhe hoteli. Dhe hoteli mbaroi.I braktisur dhe pa jetë...I brejtur nga gërr-gërra e molës,një jetë të tërë...I mashtruar e i tradhëtuar...Priste e përcillte njerëz ,që ishin njerëz dhe kafshë e insekte me dy këmbë e dy duar,që hiqeshin si njerëz...Priti e përcolli e tashti u shua.Më mirë qe " shua mes flakëve...Po kush e dogji?

Mos ndonjëra nga ato duart e mishta të futura nëpër çantat e zeza?!...Po, ato u mbollën tek Balta e Kuqe?U mbollën e u rritën me 1000 gishta e 1000 rënjë të mishta,sa desh përmbysën dhe varret...E,ç'donin duart e mbjella me hotelin tim?! Hoteli ishte imi ato e dinin...Hoteli im ishte i të gjithë njerëzve,që ishin njerëz dhe i atyre,që ishin kafshë apo insekte me dy këmbë e dy duar...I të gjithëve ishte. Po kush e dogji?! Mos i është ndezur ulërima Xherahut, mbi kalë, dhe një copë flake ka renë mbi hotelin tim?! ... Jo!...Jo!...Hingëllima e kalit dhe ulërima e Xherahut është shuar e heshtur...Po sikur ajo heshtje ta ketë djegur hotelin?!...Po!po!Edhe heshtja të djeg. Në këtë Çmendinën tonë ndodhin të pandodhu-rat...Heshtja të djeg edhe pa lëshuar flakë fare...Të djeg në heshtje-heshtja...Ulërima e mbretit bëhet e llahtarshme kur bëhet heshtje...Vetëm ky yni ulërinte,që të heshtëte tashti e heshtja e tij të shuante me flakë edhe hotelin tim.

Ai shoi një pallat të tërë e jo këtë hotelin tim të vjetër. Thonë, se e kishte trashëgim ulërimën nga babai e nga gjyshi. Edhe ata ishin mbretër, por mbretëri nuk bënë dot... Mbretërit me mbretëri heshtin, nuk ulërijnë... Veç në Çmendinën tonë ulërijnë e pastaj heshtin me djegie e vdekjeje. Eeh! Më mirë që u dogj, s'kishte më kë të priste. Mbeti i braktisur. Një hotel i braktisur nuk është më hotel...

Edhe Djaloshi i Dashuruar me Syzezën ikën me fatin me vete... "Këtu do të më gjeni! Do t'ju pres!" -iu thashë, por nuk e mbajta fjalën. Vdiqa pa e mbajtur fjalën... Edhe hoteli u shua në flakë e nuk i priti... Kështu ndodh në këtë botë, njeriu nuk e mban dotë emërin Njeri. Vdes e nuk e mban dot fjalën... Jeta është më e shkurtër se pritja, sidomos jeta e dashuruar. Jeta e dashuruar zgjat, sa një qarkullim gjaku, që mund të bejë zemëra në zemër...

Edhe vëllezërit binjakë i humba... Nuk u dihet fati... Eeh! Unë jam i vdekur dhe nuk bëj dotë si të gjallët... Edhe si të vdekurit nuk bëj dotë... Mbeta as i gjallë as i vdekur... Dëgjoj ç'bejnë të vdekurit e shoh se ç'bejnë të gjallët... Edhe ulërimën e të vdekurve, që u kthye në këngë e dëgjova... Edhe djegien e hotelit e pashë...

Po tashti, ç'do të më dëgjojnë veshët e ç'do më shohin sytë në këtë Çmendinën tonë?!...

Janë njerëzit të çmendur, s'është kjo baltë, që rrit lule të bukura... Eeh!... Kot flas me vete... kush më dëgjon këtu mbi varrin tim?!

Vetëm lulet... Vetëm lulet më duan dhe kështu siç jam as i gjallë e as i vdekur....

Vetëm lulet...

Eeh!...

## **PERMBAJTJA**

Një roman për nerva të forta – nga Robert Goro . f. 4

### **PJESA E PARE**

Atë pasdite qershori... ..	f.10
Çantat e zeza. ....	f.11
Hotelieri .....	f.12
Sëmundja e kalit .....	f.15
Hakmarrja .....	f.18
Patkonjtë .....	f.21
Qorrimi .....	f.23
Heshtje .....	f. 26
Mbjellja e duarve.....	f 27
Djaloshi i Dashuruar.....	f 29
Ç'ndodhi me duart? .....	f 32
Kolera .....	f 34
Pylli i duarve.....	f 36
Qielli i habitur .....	f 37
E gjithë jeta e Hotelierit ishte ëndërr.....	f 38
Kryekomandanti .....	f 44
Të ikurit e natës .....	f.46
Trutredhurit.....	f.47
E fshehta .....	f.49
Valixhja e rinisë .....	f.52
Oiii.....	f.56
Kurorat e vdekjes .....	f.59
Fjalëgazetash .....	f.61